Albërie Sejdiu
Fatjona Alidemaj

# LIBËR PËR MËSUESIN

## NJERIU DHE NATYRA 4




Albërie Sejdiu
Fatjona Alidemaj
LIBËR PËR MËSUESIN
NJERIU DHE NATYRA 4

Albërie Sejdiu

Fatjona Alidemaj

# LIBËR PËR MËSUESIN
# NJERIU DHE NATYRA 4

Për klasën e katërt të arsimit 9-vjeçar

BOTIME

pegi

Prishtinë, 2022

**BOTIME**

pegi

Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t: Prof. Kimete Lluga Rizani, Jehona Hysenaj, Drenushë Morina
Korrektorë letrarë: Arlon LIKO, Brunilda MENO
Paraqitja grafike dhe kopertina: Elidor KRUJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN:

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, qershor 2022
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

**Botime Pegi:** cel: +355 069 40 075 02;
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
**Sektori i shpërndarjes: cel:** +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
**e-mail:** marketing@botimepegi.al
**Shtypshkronja Pegi**: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

# Përmbajtja

Hyrja ........................................................................ 5

Plani mësimor vjetor ................................................................ 7

Plani mësimor dymujor ................................................................ 8

Aspekt të përgjithshme të planit të orës mësimore .................. 19

# Hyrje

I/e nderuar mësimdhënës/e,
Teksti "Njeriu dhe natyra" për klasën e katërt është dizajnuar sipas katër koncepteve që i përfshin kjo fushë-lëndë (Njeriu dhe natyra). Ky libër përmban bazën e njohjes dhe të të kuptuarit e botës përmes këtyre katër koncepteve. Shkenca u mëson nxënësve të mendojnë në mënyrë të strukturuar, gjë që ndihmon për të analizuar dhe zgjidhur problemet.
Lënda "Njeriu dhe natyra" kontribuon po ashtu në zhvillimin e kompetencave, të cilat i ndihmojnë nxënësit në jetën e përditshme.
Për të arritur sa më lehtë realizimin e përmbajtjes së lëndës "Njeriu dhe natyra", mësimdhënësi/ja duhet të përzgjedhë metodologjitë më adekuate, si dhe brenda saj përdor teknika dhe forma të ndryshme duke i përshtatur moshës, nevojave dhe mundësive të nxënësve.
Në bazë të përmbajtjes së temave, mësimdhënësi/ja përdor mjete, materiale dhe prova të ndryshme me qëllim të realizimit të aktiviteteve në mënyrë praktike. Përdorimi i elementeve të praktikës si dhe prezantimi nga ana e nxënësve para të tjerëve kontribuon që të arrihen në tërësi rezultatet (RNF dhe RNL) si dhe kompetencat sipas K.B.
Të nxënit efektiv kërkon zhvillimin e aftësive, të sjelljeve dhe të motivimit. Kjo mund të arrihet përmes mësimdhënies efektive dhe përdorimit të aktiviteteve të thjeshta, ku nxënësve iu japin mundësi të vendosin qëllimin e tyre personal, përkrah qëllimit të vendosur nga mësuesi/ja për përvetësimin e njësisë të caktuar\konceptit të caktuar shkencor.
Libri i mësuesit shërben si udhëzues për mësimdhënësit gjatë planifikimit të njësive mësimore.
Ky libër përmban një laramani mënyrash të të nxënit dhe të mësimdhënies, si lexime dhe shkrime individuale, diskutim pune në grupe dhe çifte, veprimtari dhe diskutime të të gjithë klasës, hulumtim shkencor, zgjidhje të problemeve, prezantime etj.
Mësimdhënësi/ja zbaton forma ndërvepruese, gjithëpërfshirëse, ekipore dhe krijuese gjatë mësimdhënies dhe mësimnxënies.
Këtu keni të paraqitura disa nga teknikat, të cilat mund të përdoren në faza të ndryshme të orës që kontribuojnë në arritjen e rezultateve (RNL dhe RNF).
Hulumtimi shkencor:
Hulumtimi shkencor fillon me një eksperiment (demonstrim) fillestar, që nuk do të përmbajë shumë elemente dhe i fton nxënësit të vëzhgojnë, krahasojnë, klasifikojnë dhe të ngrenë pyetje mbi atë që shohin dhe që dinë. Në këtë mënyrë, ata zhvillojnë hipoteza, që i testojnë nëpërmjet eksperimenteve, prezantojnë analizën e punës së tyre eksperimentale, nxjerrin njohuritë e reja dhe bëjnë vlerësimin e zbatueshmërisë e njohurive të fituara në jetën e tyre të përditshme.

Ju urojmë punë të mbarë!

# PLANI VJETOR

| Lëndët e fushës | TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE | | | | Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës |
|---|---|---|---|---|---|
| | PERIUDHA (I) | | PERIUDHA (II) | PERIUDHA (III) | |
| | Shtator-Tetor<br>14 orë | Nëntor-Dhjetor<br>14 orë | Janar-Shkurt-Mars<br>22 orë | Prill-Maj-Qershor<br>24 orë | |
| **Lënda: Njeriu dhe natyra 4** | Materialet, prejardhja, përbërja dhe vetitë e tyre<br><br>Lëndët e pastra, lëndët e përziera dhe tretësirat<br><br>Ajri dhe përbërësit e tij<br><br>Riprodhimi te qeniet e gjalla | Riprodhimi te qeniet e gjalla<br><br>Ruajtja e ushqimit dhe substancat helmuese<br><br>Jetojmë dhe rritemi<br><br>Puberteti dhe përshtatja | Bashkëveprimet dhe lëvizjet<br><br>Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik | Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik<br><br>Vendi dhe hapësira<br><br>Sistemet fizike<br><br>Bashkëveprimi njeri/natyrë | Komunikues efektiv<br>I.1, 2, 3, 4, 5, 8<br>Mendimi kreativ<br>II.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8<br>Nxënës i suksesshëm<br>III.1, 2, 3, 4, 6, 8<br>Kontribuues produktiv<br>IV.3, 4, 7, 8<br>Individ i shëndoshë<br>V.1, 3, 8<br>Qytetar i përgjegjshëm<br>VI.2 |

| PERIUDHA I (SHTATOR-TETOR/NËNTOR-DHJETOR) | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Temat mësimore** | **Rezultatet e të nxënit për tema mësimore** | **Njësitë mësimore** | **Koha mësimore (orë mësimore)** | **Metodologjia e mësimdhënies** | **Metodologjia e vlerësimit** | **Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare** | **Burimet** |
| Materialet, prejardhja, përbërja dhe vetitë e tyre | - Dallon materialet në bazë të prejardhjes natyrë e gjallë dhe natyrë jo e gjallë (materialet metalike, minerale, organike dhe kompozite).<br><br>- Krahason materialet e ndryshme sipas dendësisë, përcjellshmërisë termike e elektrike, sipas fortësisë, dhe i ndërlidh ato me përdorimin e tyre.<br><br>- Klasifikon materialet në bazë të përbërjes në: lëndë të pastra dhe lëndë të përziera.<br>- Dallon përzierjet dhe tretësirat.<br>- Demonstron ndarjen e përzierjeve me metodën e filtrimit dhe dekantimit. | 1. Hyrje në lëndën "Njeriu dhe natyra 4" (P)<br>2. Natyra dhe studimi i saj (Zh), f. 4<br>3. Trupat dhe materialet e tyre (Zh), f. 6<br>4. Vetitë e materialeve dhe përdorimi i tyre (Zh), f. 8<br>5. Klasifikimi i materialeve (Zh), f. 10<br>6. Tretja e lëndëve (Zh), f. 11,12<br>7. Përzierja dhe ndarja e lëndëve (Zh), f. 14<br>8. Punë praktike: Ndarja e lëndëve (Zh), f. 16 | **28 orë** | Mësimdhënie dhe nxënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirje<br><br>Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar<br><br>Mësimnxënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave<br><br>Mësimdhënie dhe nxënie të diferencuar | Vlerësim i vazhdueshëm VpN<br><br>Vlerësim motivues<br><br>Lista e Kontrollit<br><br>Informata kthyese<br><br>Vlerësimi i ndërsjellë<br><br>Portofol<br><br>Detyra shtëpie<br><br>Diskutime | Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Gjuhë shqipe<br><br>Matematikë<br><br>Shkathtësi për jetë<br><br>Edukatë figurative<br><br>Çështje ndërkurrikulare Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm | "Njeriu dhe natyra 4"<br><br>Fletore pune "Njeriu dhe natyra 4"<br><br>*https://www.bing.com/videos/search?q=www.earthp*<br><br>*Smoke and your health - Better Health Channel*<br><br>*What is Puberty? - Answered - Twinkl teaching Wiki* |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Lëndët e pastra, lëndët e përziera dhe tretësirat | - Krahason tretjen e substancave të ndryshme në ujë dhe varësinë e tretshmërisë nga temperatura.<br>- Shpjegon se gjendja agregate e materialit varet nga kushtet e jashtme, sidomos nga temperatura.<br><br>- Dallon përbërësit kryesorë të ajrit (azoti, oksigjeni, dioksidi i karbonit), si dhe demonstron me anë të eksperimentit ndonjërin prej tyre.<br>- Interpreton rëndësinë e oksigjenit për frymëmarrjen, si dhe rëndësinë e mbrojtjes së ajrit prej papastërtive.<br><br>- Identifikon mënyrat e riprodhimit të qenieve të gjalla si një ndër proceset jetësore.<br>- Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla. | 9. Përbërësit e ajrit (Zh), f.18<br>10. Rëndësia e oksigjenit (Zh), f. 20<br>11. Mbrojtja e ajrit (Zh), f. 22<br>12. Përforcim i njësive të mësuara (P)<br>13. Punë praktike: Oksigjeni ndihmon djegien (Zh), f. 24<br>14. Kontrolloni përparimin tuaj (P), f. 25<br><br>15. Riprodhimi i bimëve. Pjalmimi (Zh), f. 26<br><br>16. Riprodhimi vegjetativ i bimëve, (Zh) f. 28<br>17. Riprodhimi i insekteve (Zh), f. 30<br>18. Riprodhimi i amfibëve dhe shpendëve (Zh), f. 32<br>19. Riprodhimi i gjitarëve (Zh), f. 34<br><br>20. Përse ushqehemi? (Zh) f. 36<br>21. Ushqimi i shëndetshëm (Zh), f. 38<br>22. Ruajtja e ushqimit (Zh), f. 40<br>23. Substanca të dëmshme për shëndetin (Zh), f. 42<br>24. Përforcim i njësive të mësuara, (P) | | | Prezantime<br><br>Punë praktike | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ajri dhe përbërësit e tij<br><br>Riprodhimi te qeniet e gjalla | - Krahason të veçantat dhe të përbashkëtat e riprodhimit tek organizmat e grupeve të ndryshme.<br>- Shpjegon me shembuj konkretë riprodhimin e organizmave të grupeve të ndryshme.<br>- Arsyeton rëndësinë e riprodhimit për qeniet e gjalla.<br>- Vlerëson rëndësinë e riprodhimit te njeriu, si dhe rëndësinë e tij në biodiversitetin e botës së gjallë.<br><br>- Identifikon mënyra të ruajtjes së ushqimit nga faktorët mjedisorë.<br>- Analizon rëndësinë e të ushqyerit shëndetshëm.<br>- Vlerëson rolin biologjik të të ushqyerit dietal.<br>- Emërton substanca helmuese – duhani, alkooli, kafja etj.<br>- Propozon masa parandaluese për të ushqyerit e pashëndetshëm.<br>- Gjykon për efekte anësore të përdorimit të substancave helmuese. | 25. Fazat e rritjes dhe zhvillimit te njeriu (Zh), f. 44<br>26. Ndryshimet në trupin tim. Puberteti (Zh), f. 46<br>27. Kujdesem për veten (Zh), f. 48<br>28. Kontrolloni përparimin tuaj (P), f. 51 | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ruajtja e ushqimit dhe substancat helmuese<br><br>Jetojmë dhe rritemi<br><br>Puberteti dhe përshtatja | - Përshkruan zhvillimin dhe ndryshimet e trupit gjatë moshës së pubertetit. Diskuton lidhur me adoptimin e trupit gjatë pubertetit, marrëdhëniet me të tjerët.<br><br>- Përshkruan ndryshimet fizike, emocionale dhe mendore që ndodhin në trup, në fazën e pubertetit.<br><br>- Përshkruan veprime që duhet t'i bëjë për të mirëmbajtur dhe menaxhuar trupin e tij/saj në këtë fazë. | | | | | | |

| PERIUDHA II<br>(JANAR-SHKURT-MARS) | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Temat mësimore** | **Rezultatet e të nxënit për tema mësimore** | **Njësitë mësimore** | **Koha mësimore (orë mësimore)** | **Metodologjia e mësimdhënies** | **Metodologjia e vlerësimit** | **Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare** | **Burimet** |
| Bashkëveprimet dhe lëvizjet | - Përkufizon masën, vëllimin e dendësinë dhe dallon trupat e ngurtë, lëndët e lëngëta dhe lëndët e gazta sipas vetive të tyre.<br>- Dallon lloje të ndryshme të rrugëve dhe të lëvizjeve të trupave.<br>- Përshkruan mënyrat e krijimit të valëve dhe shembuj të paraqitjes së tyre në natyrë.<br>- Shpjegon shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës.<br>- Demonstron shembuj të përzierjes vetvetiu të lëndëve të lëngëta dhe të gazta në jetën e përditshme.<br>-Demonstron pluskimin, zhytjen dhe fundosjen e trupave në ujë duke u bazuar në dendësi dhe sipërfaqe të tyre.<br>-Demonstron paraqitjen e forcës shtytëse në trupin e zhytur në lëng. | 32. Trupat, masa dhe vetitë e tyre (Zh), f. 52<br>33. Lëvizja e trupave (Zh), f. 54<br>34. Valët dhe krijimi i tyre (Zh), f. 56<br>35. Shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës (Zh), f. 58<br><br>36. Punë praktike: (P)<br>37. Punë praktike: Lëndët dhe vetitë e tyre (Zh), f. 60<br>38. Zhytja, pluskimi dhe fundosja e trupave në ujë (Zh), f. 61<br>39. Punë praktike: Forca shtytëse e trupit të zhytur në lëng (P), f. 63 | **22 orë** | Mësimdhënie dhe nxënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirje<br><br>Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar<br><br>Mësimnxënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave | Vlerësim i vazhdueshëm<br>VpN<br><br>Vlerësim motivues<br><br>Lista e kontrollit<br><br>Informata kthyese<br><br>Vlerësimi i ndërsjellë<br><br>Portofol<br>Detyra shtëpie<br>Diskutime | Shoqëria dhe mjedisi<br>Gjuhë shqipe<br><br>Matematikë<br>Shkathtësi për jetë<br><br>Edukatë figurative<br>Çështje ndërkurrikulare<br>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm | “Njeriu dhe natyra 4”<br><br>“Njeriu dhe natyra 4”<br><br>Fletore pune<br><br>*https://www.bing.com/videos/search?q=energy+sources+education+video+for+kids*<br><br>*Lënda: “Dituri Natyre 4”*<br>*Tema: Fuqia e magneteve - YouTube* |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik | - Demonstron shembuj të paraqitjes së shtypjes atmosferike dhe peshës së ajrit.<br><br>Paraqet shembuj të zgjerimit të ajrit, me zmadhimin e temperaturës dhe shpjegon qarkullimin e tij, si dhe motin e klimën.<br>- Dallon burimet e energjisë së pastër nga burimet që e ndotin mjedisin.<br>- Shqyrton shembuj të avullimit, valimit dhe lëngëzimit të ujit në vartësi të temperaturës.<br><br>- Ndërton elektroskopin e thjeshtë dhe me të dallon trupat që ngarkohen dhe nuk ngarkohen me elektricitet.<br>- Shpjegon elektricitetin atmosferik dhe mbrojtjen prej tij.<br>- Demonstron me dy elektroskopë përçuesit dhe veçuesit e rrymës elektrike.<br>- Ndërton qarkun e thjeshtë elektrik, ilustron skemën e tij dhe përshkruan rolin e çdo pjese përbërëse.<br>- Dallon përcjellësit dhe veçuesit elektrik me ndihmën e qarkut elektrik.<br>- Demonstron mbylljen e qarkut elektrik me tretësirë ujore të kripës. | 40. Shtypja atmosferike dhe pesha e ajrit (Zh), f. 64<br><br>41. Përsëritje e njësive të mësuara (P)<br><br>42. Burimet e energjisë (Zh) f. 66<br><br>43. Avullimi, vlimi dhe lëngëzimi i ujit (Zh), f. 68<br>44.Përsëritje e njësive të mësuara (P)<br><br>45. Elektriciteti atmosferik (Zh), f. 72<br><br>46. Qarku elektrik. Ndërtimi i tij (Zh), f. 74<br><br>47. Përcjellësit dhe veçuesit elektrikë (Zh), f. 76<br><br>48. Punë praktike: Lëndët e tjera që përcjellin elektricitetin (P), f. 78<br><br>49. Përdorimi dhe mbrojtja nga elektriciteti (Zh), f. 80<br><br>50. Përsëritje e njësive të mësuara (P)<br><br>51. Ç'janë magnetet? (Zh), f. 82 | | Mësimdhënie dhe nxënie të diferencuar | | | *https://www.bing.com/videos/search?q=r-reziku+nga+r-ryma+elek-trike&docid* |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Identifikon pajisjet e përditshme në shtëpi që punojnë me rrymë, qarkun e shkurtër dhe rrezikun nga rryma elektrike.<br><br>- Shpjegon me demonstrim veprimin magnetik të magnetit në mjedise dhe dallon lëndët që magnetizohen nga ato që nuk magnetizohen. Ndërton elektromagnetin e thjeshtë dhe demonstron vetitë magnetike të tij. | 52. Lëndët magnetike dhe jomagnetike (Zh), f. 84<br><br>53. Punë praktike. Fuqia e magneteve. Gjilpëra magnetike (Zh), f. 86 | | | | | |

| PERIUDHA III<br>(PRILL-MAJ-QERSHOR) | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Temat mësimore** | **Rezultatet e të nxënit për tema mësimore** | **Njësitë mësimore** | **Koha mësimore (orë mësimore)** | **Metodologjia e mësimdhënies** | **Metodologjia e vlerësimit** | **Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare** | **Burimet** |
| Bashkëveprimi elektrik dhe magnetik<br><br>Vendi dhe hapësira | - Ndërton elektromagnetin e thjeshtë dhe demonstron vetitë magnetike të tij.<br><br>- Ndërton elektroskopin e thjeshtë dhe me të dallon trupat që ngarkohen dhe nuk ngarkohen me elektricitet.<br><br>- Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës, trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (nëpërmjet Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drurëve etj.). | 54. Ndërtimi i elektromagnetit. Përdorimi i tij (Zh), f. 88<br>55. Punë praktike: Ndërtimi i elektroskopit (P), f. 90<br>56. Funksioni dhe përdorimi i elektroskopit (Zh), f. 92<br>57. Kontrolloni përparimin tuaj (Zh), f. 95<br>58. Qielli dhe yjet (Zh), f. 98<br>59. Sistemi ynë diellor (Zh), f. 100<br>60. Dielli, burimi i jetës (Zh), f. 102<br>61 Planeti Tokë (Zh), f. 104<br>62. Hëna, sateliti natyror i Tokës (Zh), f. 106<br>63. Stinët, dita dhe nata (Zh), f. 108<br>64. Përsëritje e njësive të mësuara (P)<br>65. Orientimi në natyrë (Zh), f. 110 | **24 orë** | Mësimdhënie dhe nxënie me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirje<br><br>Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar<br><br>Mësimnxënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave<br><br>Mësimdhënie dhe nxënie të diferencuar | Vlerësim i vazhdueshëm VpN<br><br>Vlerësim motivues<br><br>Lista e kontrollit<br><br>Informata kthyese<br><br>Vlerësimi i ndërsjellë<br><br>Portofol<br><br>Detyra shtëpie<br><br>Diskutime | Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Gjuhë shqipe<br><br>Matematikë<br><br>Shkathtësi për jetë<br><br>Edukatë figurative<br><br>Çështje ndërkurrikulare<br><br>Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm | “Njeriu dhe natyra 4”<br><br>Fletore pune<br><br>*RELIEVI I KOSOVES - YouTube* |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sistemet fizike<br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br><br>Bashkëveprimi njeri/natyrë | - Identifikon dhe shpjegon mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan, duke treguar dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis tyre.<br><br>- Shpjegon rëndësinë e Diellit për dukuritë gjeografike, si: qarkullimi i përhershëm i ujit, ajrit, zhvillimi i botës bimore e shtazore, baticat e zbaticat.<br><br>- Shpjegon përbërjen, ndërtimin e atmosferës dhe rëndësinë e saj për proceset në natyrë dhe jetën në Tokë.<br>- Përshkruan strukturën (ndërtimin e brendshëm) e Tokës: dallon bërthamën, mantelin dhe koren e Tokës, si dhe të tregon se korja e Tokës përbëhet nga shkëmbinj të ndryshëm.<br>-Përshkruan qarkullimin e ujit në natyrë (paraqet *në mënyrë skematike qarkullimin e ujit në natyrë*) dhe tregon që pjesa më e madhe e sipërfaqes së Tokës është e mbuluar me ujë (oqeanet, detet, | 66. Harta (Zh), f. 112<br>67. Format e relievit (Zh), f. 114<br>68. Atmosfera (Zh), f. 116<br>69. Klima. Moti (Zh), f. 116<br>69. Qarkullimi i ujit në natyrë (Zh), f. 118<br>70. Zonat klimatike (Zh), f. 120<br>71. Përsëritje e njësive të mësuara (P)<br><br>72. Njeriu dhe mjedisi natyror (Zh), f. 122<br><br>73. Ndotja e tokës (Zh), f. 124<br><br>74. Kontrolloni përparimin tuaj (P) | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | lumenjtë), pjesa më e vogël është tokë (kontinentet).<br>- Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore dhe shtazore.<br><br>- Dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit dhe identifikon disa nga faktorët që ndikojnë në ndotjen e tokës apo keqmenaxhimin e saj: p.sh., shfrytëzimi i tokave-ndërtimet në tokat bujqësore, përdorimi i pesticideve, shpyllëzimet, erozioni etj.). | | | | | | |

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
|---|---|---|---|

| **Tema: Materialet dhe vetitë e tyre** | **Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon materialet në bazë të prejardhjes natyrë e gjallë dhe ajo jo e gjallë (materialet metalike, minerare, organike dhe kompozite). |
|---|---|

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1, 2, 8; III.3, 4; IV.4

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.2; 2.3; 2.6

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Natyra dhe studimi i saj

**Fjalët kyçe:** natyra, bota e gjallë, jo e gjallë, ekosistemi, burime të ripërtritëshme dhe jo të ripërtritëshme.

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- emërton elemente të botës së gjallë dhe jo të gjallë;
- diskuton për njohurit e reja;
- paraqet ciklet jetësore;

**Kriteret e suksesit:**
- Emërton së paku 3 elemente të botës së gjallë dhe 3 elemente të botës jo të gjallë.
- Diskuton për njohuritë e reja të lexuara në tekst f. 4.
- Paraqet së paku dy cikle jetësore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** natyra, bota e gjallë, jo e gjallë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Hapi I**

Mësuesi/ja merr nxënësit dhe del në oborrin e shkollës, u tregon se gjithçka që shohin me sy quhet natyrë. Në natyrë ekziston bota e gjallë dhe jo e gjallë. I udhëzon nxënësit që të shohin përreth dhe të emërojnë të gjithë trupat që janë të gjallë: emra bimësh, kafshësh, njerëzish. Më pas, duke vëzhguar gjejnë dhe emërojnë edhe trupa jo të gjallë.

**Hapi II**

Nxënësit duke i kujtuar ato që panë në natyrë, bëjnë analizën e tipareve të dy grupeve, listojnë në dy grupe botën e gjallë dhe jo të gjallë.



| |
|---|
| Nxënësit hapin tekstin dhe lexojnë disa herë. Natyra dhe studimi i saj, f. 4. Më pas, diskutojnë rreth informatave të reja. *Se çka është ekosistemi natyror? Çka quajmë burime të ripërtritëshme, Cilat janë burime jo të ripërtritëshme?*<br>Mësuesi/ja bënë pyetje në atë mënyrë që të marr përgjigjet e sakta dhe sa më shumë shembuj nga jeta e përditshme.<br>Gjithashtu nxitë nxënësit të vizatojnë dhe të shpjegojnë ciklet jetësore: të ujit, lëndëve ushqyese dhe klimës.<br>**Hapi III**<br>Nxënësit udhëzohen të plotësojnë veprimtarinë 1.1, f. 5. Nxënësit nxiten që të sjellin shembuj nga jeta e përditshme. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësimi i nxënësve bëhet në mënyrë sistematike. Vlerësohen nxënësit që listojnë sa më shumë elemente të botës së gjallë dhe jo të gjallë, si dhe ata që vizatojnë bukur dhe shpjegojnë ciklet në natyrë. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyrë shtëpie do të bëjnë Pyetje dhe detyra në f. 5, do t'i shkruajnë në fletore.<br>Plotësimi në fletoren e punës f. 4. Njësia: 1.1 Natyra dhe studimi i saj |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Materialet dhe vetitë e tyre** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Dallon materialet në bazë të prejardhjes natyrë e gjallë dhe ajo jo e gjallë (materialet metalike, minerare, organike dhe kompozite). | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II. 1; III.4; V.8; VI.2 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Trupat dhe materialet e tyre | | | |
| **Fjalët kyçe:** material, i fortë/i butë, organik, metal, mineral. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- identifikon objekte/trupa të mjedisit që e rrethon;<br>- shkruan për materialet e trupave/objekteve, përdorimin e tyre;<br>- analizon materialet përbërëse të trupave në natyrë. | | | |
| **Kriteret e suksesit:**<br>- Përmend së paku 3 trupa të mjedisit që e rrethon.<br>- Plotëson tabelën për materialet, objektet dhe përdorimin e tyre.<br>- Analizon materialet përbërëse të së paku 3 trupave të paraqitura përmes fotografive. | | | |

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, projektori, fotografitë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Nxënësit udhëzohen që të vështrojnë në ambientin e tyre përreth dhe të përmendin objektet që i shohin. Në tabelë shënohet një listë me emrat e objekteve që nxënësit i përmendin. Pastaj, mësuesi/ja pyet nxënësit se nga çfarë janë ndërtuar objektet e shkruara në tabelë, si dhe për çfarë i përdorim ato. Secili nga nxënësit jep mendimet e vet.

**Hapi II**

Në faqen 6, nxënësit njoftohen me njësinë. Lexohet paragrafi i parë dhe diskutohet shembulli i parë, (foto: tavolina, karriget), pastaj lexohen paragrafët e tjerë dhe secila fotografi e vendosur në libër lidhet me materialin/pjesën e lexuar.

Shpjegohet termat: materiale me përbërje organike dhe kompozitat duke marrë shembuj konkrete për shpjegimin e tyre.

Pas leximit dhe diskutimit të njësisë, mësuesi/ja përmes projektorit paraqet disa fotografi të objekteve të tjera të padiskutuara më parë (p.sh. gota, dritaret, çelësi, këpucë, vazo, balonat etj.), ku nxit nxënësit të mendojnë për secilën prej tyre.

Parashtron pyetjet:

*Çfarë shihni në këtë fotografi?*

*Nga çfarë materiali është i ndërtuar?*

*Ku mund ta përdorim ne atë (funksioni i tij)?*




Nxënësit japin mendimet e tyre, gjithashtu mësuesi/ja jep informacionet plotësuese rreth materialeve të objekteve dhe përdorimit të tyre.

**Hapi III**

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë tabelën e dhënë në libër në faqen 7, Veprimtaria 1.2. Pas plotësimit, disa prej nxënësve u jepet fjala për të lexuar shembujt që kanë shkruar. Nxiten nxënësit që të japin shembuj nga jeta e përditshme.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësim formativ - vlerësohet angazhimi në dhënien e mendimeve dhe saktësia e përgjigjeve të dhëna në pyetjet e parashtruara dhe në plotësimin e tabelës në libër.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

- Plotësimi në fletoren e punës, f. 5. Njësia: 1.2 Trupat dhe materialet e tyre
- Nxënësit duhet të bëjnë një shëtitje në natyrë dhe të gjejnë objekte të ndërtuara nga materiale të ndryshme. Nxënësit të ndarë në grupe do të analizojnë materialet dhe vetitë e tyre dhe ato do t`i shkruajnë *Flip chart* ose *hamer*. Secili grup do të prezantojë punën e tyre të përbashkët.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Njeriu dhe natyra | Shkalla e kurrikulës: II | Klasa: IV |
|---|---|---|---|
| **Tema: Materialet dhe vetitë e tyre** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br><br>Krahason materialet e ndryshme sipas dendësisë, përcjellshmërisë termike e elektrike, sipas fortësisë dhe i ndërlidh ato me përdorimin e tyre. | |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.4

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** I.3; II.1; III.4

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vetitë e materialeve dhe përdorimi i tyre

**Fjalët kyçe:** veti, përkulshmëri, përshkueshmëri, përthithje, përcjellës.

**Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- tregon për vetitë e trupave të sjellë në klasë;
- plotëson tabelën me vetitë dhe materialet e trupave;
- krijon fjali-kuici për vetitë e trupave.

**Kriteret e suksesit:**
- Përmend së paku 3 veti të trupave që janë sjellë si shembull në klasë.
- Plotëson të gjithë tabelën për vetitë dhe materialet e trupave.
- Krijon 2 shembuj me fjali-kuici për vetitë e trupave.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, fleta e punës, materialet konkretizuese (trupa të përbërë nga druri, metali, plastika, qelqi), fleta e punës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Hapi I**

Materialet që nxënësit i kanë sjellë nga shtëpia (që kanë pasur detyrë nga ora e kaluar) diskutohen në klasë. Mësuesi/ja merr disa nga objektet e përbëra nga materialet e ndryshme dhe u parashtron pyetje nxënësve:
- *Nga çfarë materiali përbëhet ky objekt?*
- *Çfarë forme ka?*
- *Çfarë ngjyre ka?*
- *A thyhet apo jo?*
- *A është i lakueshëm/elastik apo jo?*
- *A e përcjell nxehtësinë?*

Nga përgjigjet e nxënësve dhe diskutimi, mësuesi/ja njofton se gjithë këto emërtohen si veti të trupave, dhe se secili nga trupat ka vetitë e veta.

**Hapi II**

Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat në faqen 8 dhe të lexojnë njësinë. Fillimisht lexohet në heshtje gjithë njësia nga nxënësit, më pastaj diskutohet për secilin paragrafë, ku mësuesi/ja parashtron pyetjen:

- *Çka janë vetitë e trupave?*
- *Çfarë vetish kanë trupat e përberë nga druri?*
- *Si mund të grupohen materialet?*
- *Çfarë vetish kanë trupat e përbërë metalet?*
- *Çfarë vetish kanë veshjet?*
- *Çfarë vetish kanë trupat e përbërë nga plastika?*

Nxënësve u jepet nga një fletë plotësuese, në të cilët ata do ta plotësojnë në mënyrë individuale, duke vendosur √ në hapësirat ku duhet për vetitë e materialit dhe na anën e majtë të shkruajnë materialin përbërës të trupit.

| | | **Vetitë** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Materiali përbërës | Trupi/ Objekti | *i fortë* | *i butë* | *Përcjell nxehtësinë* | *Elastik - I lakueshëm* | *Shkrihet* | *Përcjell rrymën elektrike-elektricitetin.* |
| | Dollapi i librave | | | | | | |
| | Çelësi | | | | | | |
| | Bluza | | | | | | |
| | Vizorja | | | | | | |
| | Gota | | | | | | |

Disa nga nxënësit paraqesin mënyrën e plotësimit të tabelës.

**Hapi III**

Mësuesi/ja u paraqet dy shembuj se si luhet loja. Lexon para nxënësve tri fjali:

Metalet përcjellin elektricitetin.

Metalet mund të shkrihen.

Metalet janë të buta.

Nxënësit udhëzohen të mendojnë për të qëlluar se cila prej këtyre fjalive është gënjeshtër ose e pasaktë. Të njëjtën gjë do ta bëjmë edhe nxënësit, secili nga ata do të shkruaj nga dy shembuj. Pastaj do ta lexojnë para klasës dhe të tjerët do të mundohen ta gjejnë përgjigjen e saktë (gënjeshtrën apo fjalinë e pasaktë). Ai/ajo nxënës/e që gjen përgjigjen merr fjalën për ta lexuar shembujt e saj. Kështu vazhdohet deri në fund të lojës.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësim formativ - vlerësohet angazhimi në dhënien e përgjigjeve, saktësia e përgjigjeve, plotësimi i fletës së punës dhe aftësia e krijimit të fjalive-kuic.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit duhet të vizatojnë një objekt dhe t'i shkruajnë vetitë e tij në formën e një kllasteri, detyra 4 dhe 5 në libër.

Plotësimi në fletoren e punës, f. 6. Njësia: 1.3 Vetitë e materialeve dhe përdorimi i tyre

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| **Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës** | **Lënda: Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës: II** | **Klasa: IV** |
|---|---|---|---|
| **Tema: Materialet dhe vetitë e tyre** | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Krahason materialet e ndryshme sipas dendësisë, përcjellshmërisë termike e elektrike, sipas fortësisë dhe i ndërlidh ato me përdorimin e tyre. Klasifikon materialet në bazë të përbërjes në: lëndë të pastra dhe lëndë të përziera. | |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.4; V.8; VI.2

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.2

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Klasifikimi i materialeve

**Fjalët kyçe:** i/e fortë, i/e butë, i/e lëmuar, i/e ashpër, me/pa shkëlqim.

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore**

**Nxënësi/ja:**

- identifikon vetitë e trupave të paraqitur në fotografi;
- shkruan vetitë e trupave sipas klasifikimeve;
- klasifikon materialet sipas vetive të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:**

- Tregon të gjitha vetitë e trupave që janë paraqitur në fotografi.
- Plotëson të gjitha kërkesat për plotësim e vetive të trupit vendosur në libër në faqen 8.
- Klasifikon, sipas të gjitha kërkesave, materialet në bazë të vetive.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, fotografitë, projektori, fletëza pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:
Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Hapi I**

Para nxënësve të organizuar në dyshe paraqiten në fotografi, përmes projektorit, trupat:



Uji, gozhda, avulli i ujit dhe pasqyra

Secila dyshe e nxënësve duhet të diskutojë mes tyre materialet përbërëse dhe vetitë e këtyre trupave.

Pastaj, mësuesi/ja u parashtron pyetjet:

- *Nga cili material përbehen trupat që shihni në foto?*
- *Çfarë vetish ka secili nga trupat?*
- *Në çfarë gjendje agregate gjinden trupat?*

| |
|---|
| Diskutohet së bashku më nxënësit për të gjitha këto veçori të objekteve dhe mësuesi/ja sqaron se trupat dhe materialet në natyrë mund të klasifikohen në mënyra të ndryshme, dhe se do të mësojnë më shumë për mënyrat e klasifikimit.<br>**Hapi II**<br>Nxënësit njoftohen më njësinë mësimore në faqen 10. Ata udhëzohen që të fillojnë leximin e njësisë dhe gjatë leximit në libër me + (plus) të shënojnë gjërat që i kanë mësuar të reja, me √ gjërat që i kanë ditur edhe më parë dhe me **?** gjërat që nuk i kuptojnë.<br>Mësuesi/ja i pyet nxënësit për gjërat e reja që kanë mësuar, të cilat i diskutojnë bashkërisht. Pastaj i pyet për gjërat që nuk i kanë kuptuar dhe jep informacione plotësuese rreth tyre. Në libër, f. 11, nxënësit udhëzohen të plotësojnë pjesët përbërëse të figurës (lapsit) dhe t'u përgjigjen pyetjeve të parashtruara rreth tij.<br>**Hapi III**<br>Në një kuti, mësuesi/ja ka vendosur fletëza me emrat e disa trupave (p.sh. gota e qelqit, shishe e plastikës, çanta etj.) dhe nxënësit të organizuar në dyshe do të zgjedhin nga kutia një nga emrat e trupave. Atë do ta analizojnë duke e klasifikuar sipas vetive të ndryshme (fortësia, shkëlqimi, gjendja agregate, lëndë e pastër apo e përzier). Secila nga dyshet e nxënësve prezanton punën e tyre. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohen bashkëpunimi i nxënësve mes tyre, prezantimi i punës së përbashkët, angazhimi në diskutim, saktësia e përgjigjeve të dhëna. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Plotësimi në fletoren e punës, f. 7. Njësia: 1.4 Klasifikimi i materialeve |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës** | **Lënda: Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës: II** | **Klasa: IV** |
| **Tema: Materialet dhe vetitë e tyre** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Klasifikon materialet në bazë të përbërjes në: lëndë të pastra dhe lëndë të përziera.<br>Dallon përzierjet dhe tretësirat.<br>Krahason tretjen e substancave të ndryshme në ujë dhe varshmërinë e tretshmërisë nga temperatura. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.4, 8; VI.2 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.2; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Tretja e lëndëve | | | |
| **Fjalët kyçe:** lëndë e tretshme, lëndë e patretshme, tretës, tretësirë. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- dallon lëndët e tretshme dhe ato të patretshme;<br>- klasifikon lëndët e tretshme dhe të patretshme;<br>- shpjegon ndikimin e temperaturës në tretësira. | | | |

**Kriteret e suksesit:**
- Dallon lëndën e tretshme dhe të atë të patretshme në eksperimentin e demonstruar.
- Shkruan 5 lëndë të tretshme, 5 lëndë të patretshme.
- Interpreton ndikim e temperaturës në eksperimentin e demonstruar në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**
Teksti, fletorja, gota me ujë, sheqeri, orizi, tabela.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**:
Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**
Mësuesi/ja para nxënësve demonstron një veprimtari. Në një gotë me ujë, ai/ajo hedh një lugë sheqer, pastaj e përzien atë. I udhëzon nxënësit që të vështrojnë se çfarë po ndodh me sheqerin. Pastaj i pyet nxënësit:
- *Cilat janë lëndët që po përzihen mes tyre?*
- *Çfarë po ndodh me sheqerin?*

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve që ajo çfarë ka ndodhur me sheqerin është procesi i tretjes i cili ka ndodhur me përzierjen e dy lëndëve ujit (tretësi) dhe sheqerit (lënda e tretshme).
Në një gotë tjetër me ujë, mësuesi/ja hedh një lugë oriz. I pyet nxënësit:
- *Cilat janë lëndët që po përzihen mes vete?*
- *Çfarë po ndodh me orizin?*

Shpjegohet dallimi mes lëndëve të tretshme dhe atyre të patretshme.

**Hapi II**
Nxënësit udhëzohen që t`i hapin librat në faqen 12 dhe njihen me njësinë. Nxënësit lexojnë njësinë për pak minuta dhe pastaj, mësuesi/ja u parashtron pyetjet:
- *Çka është tretësira?*
- *Cilat janë pjesët përbërëse të një tretësire? Jep shembuj.*
- *Cili është dallimi mes lëndëve të tretshme dhe atyre të patretshme? Jep shembuj*
- *Çka janë tretësirat e ngopura dhe ato të pangopura?*

Jepen sqarime plotësuese nga mësuesi/ja rreth pyetjeve.
Mësuesi/ja në tabelë vizaton një tabelë me dy kolona. Në njërën, nxënësit do shkruajnë 5 lëndë të tretshme dhe në tjetrën 5 lëndë të patretshme.

| Lëndë të tretshme | Lëndë të patretshme |
|---|---|
| | |

**Hapi III**
Në dy gota të ndryshme, njërën me ujë të nxehtë dhe tjetrën me ujë të ftohtë, mësuesi/ja hedh nga një lugë sheqer. I udhëzon nxënësit të vështrojnë se çfarë do të ndodh me sheqerin në të dy gotat. Nxënësit japin mendimet e tyre. Mësuesi/ja jep informacionet plotësuese për ndikimin e temperaturës në tretjen e lëndëve.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësimi i angazhimit në dhënien e përgjigjeve, në plotësimin e detyrave në klasë (tabelës), argumentimi për eksperimentet.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyra 3 në libër. Plotësimi në fletoren e punës, f. 8. Njësia: 1.5 Tretja e lëndëve

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës</td><td>Lënda: Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës: II</td><td>Klasa: IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Materialet dhe vetitë e tyre</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Dallon përzierjet dhe tretësirat.<br>Demonstron ndarjen e përzierjeve me metodën e filtrimit dhe dekantimit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; III.4, 9; VI.2</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.5</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Përzierja dhe ndarja e lëndëve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: përzierje, filtrim, fundërrim, avullim, letër filtruese.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- rikujton lëndën e tretshme dhe tretësin;<br>- interpreton procesin e filtrimit, fundërrimit dhe avullimit;<br>- gjeneron shembuj për procesin e filtrimit, fundërrimit dhe avullimit.<br>Kriteret e suksesit:<br>- Dallon tretësin dhe lëndën e tretshme në eksperimentin e demonstruar.<br>- Shkruan veçantitë e procesin e filtrimit, fundërrimit dhe avullimit në fletore.<br>- Gjeneron nga 1 shembull tjetër për tri proceset e mësuara.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti, fletorja, projektori, materiale demonstruese ( gota, uji, kafeje, letra filtruese, leckë kuzhine), tabela.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><th colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Hapi I<br>Shembulli 1: Mësuesi/ja sjell dy gota qelqi në klasë, njërën nga gotat e mbudh me ujë të ftohtë dhe në të hedh dy lugë kafe dhe i përzien ato. Për t'i rikujtuar njohuritë nga ora e kaluar, mësuesi/ja i pyet nxënësit:<br>- Cilat lëndë vëreni se janë përzier së bashku?<br>- Cili është tretësi dhe cili tretësira?<br>Pastaj, në gotën tjetër të zbrazët mësuesi/ja vendos mbi sipërfaqe një leckë kuzhine apo letër filtruese dhe hedh tretësirën me kafe ngadalë, duke lënë të depërtojë ujin nga lecka e kuzhinës në gotën e zbrazët. Pasi ta derdh të gjithë tretësirën, mbi letrën e kuzhinës do të mbetet një sasi e kafesë e cila është filtruar. Kështu, mësuesi/ja shpjegon procesin e filtrimit pra ndarjen e lëndëve të ngurta nga lëngu (uji).<br>Shembulli 2: Në gotën që është përdorur për demonstrimin e procesit të filtrimit përzihen përsëri kafeja dhe uji. Tretësira lihet të qëndrojë për disa minuta ashtu. Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se kafeja do të bie poshtë në fund të gotës dhe ky paraqet procesin e fundërrimit. Kjo do të shihet edhe një herë në fund të orës, kur procesi i fundërrimit ka ndodhur plotësisht.<br>Shembulli 3: Përmes projektorit, nxënësve u paraqitet një video demonstruese për procesin e avullimit (video e ndarjes së kripës nga ujit). Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve gjithashtu shembullin si nxirret kripa e detit nga uji si rezultat i procesit të avullimit.</td></tr>
</table>

**Hapi II**

Nxënësit hapin librat dhe lexojnë njësinë në faqen 14, duke u njoftuar edhe një herë me të tri proceset e ndarjes së lëndëve. Ata lexojnë për shembuj të ngjashëm me ato të demonstruara në klasë.

Nxënësit në fletore vizatojnë një tabelë me tri kolona.

Plotësojnë veçantitë e secilit proces.

| Filtrimi | Fundërrimi | Avullimi |
|---|---|---|
| | | |

**Hapi III**

Nxënësit paraqesin punën e tyre nga fletorja. Ata nxitën që të gjejnë shembuj të tjerë nga jeta e përditshme për të tri proceset e ndarjes së lëndëve. Japin secili mendimet që kanë.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet angazhimi i nxënësve në dhënien e përgjigjeve, saktësia e plotësimit të kërkesave (plotësimi i tabelës), angazhimi në diskutim.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Përgjigjet në pyetje dhe detyra në libër.

Plotësimi në fletoren e punës, f. 9. Njësia: 1.6 Përzierja dhe ndarja e lëndëve

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës** | **Lënda: Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës: II** | **Klasa: IV** |
| **Tema: Materialet dhe vetitë e tyre** | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Dallon përzierjet dhe tretësirat. | |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.4, 9; VI.2

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.2

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Punë praktike - ndarja e lëndëve

**Fjalët kyçe:** përzierje e lëngët, përzierje e qëndrueshme, përzierje e paqëndrueshme, dekadim, thithje, magnet, sitje.

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore**

**Nxënësi/ja:**

- rikujton përzierjet/tretësirat;
- analizon metodat e ndarjes së lëndëve;
- argumenton për metodat e ndarjes së lëndëve.

**Kriteret e suksesit:**

- Përmend veçoritë e së paku 3 përzierjeve/tretësirave.
- Analizon përmes eksperimenteve metodën e ndarjes me magnet dhe atë me sitje.
- Argumenton me shembujt e metodave të ndarjes së lëndëve.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, materiale konkretizuese (gota qelqi, ujë, vaj, grimca hekuri, rërë, magnet).

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare**: Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Për rikujtimin e njësive mësimore për tretjen dhe ndarjen e lëndëve, mësuesi/ja parashtron pyetjet:

- *Çka është përzierja/tretësira?*
- *Çka janë lëndët e tretshme dhe ato të patretshme?*
- *Me çfarë metodash mund t`i ndajmë tretësirat? Jep shembuj?*

Pas përsëritjes, mësuesi/ja fillon demonstrimin e një eksperimenti. Në një gotë qelqi të mbushur me ujë hedh sasi të vajit. Për disa minuta e lë pa e përzier. I nxit nxënësit të mendojnë se çfarë do të ndodh me ujin dhe vajin. Nxënësit japin mendimet e tyre. Pastaj kur vaji të jetë ndarë nga uji mësuesi/ja shpjegon se kjo është një tretësirë e paqëndrueshme. Jep informacione dhe shembuj shtesë për tretësirat e qëndrueshme dhe të paqëndrueshme.

**Hapi II**

Nxënësit udhëzohen që t'i hapin librat në faqen 16 dhe të lexojnë paragrafin e parë, Veprimtarinë 1.7a dhe 1.7b. Diskutohet rreth tyre, duke e pasur për bazë shembullin e demonstruar nga mësuesi/ja, duke u përgjigjur pyetjeve:

- *Pse ndahet vaji nga uji?*
- *Çfarë tretësire është kjo?*

Nxënësit vazhdojnë të lexojnë pjesën tjetër të njësisë, ndërkohë mësuesi/ja përgatit eksperimentin demonstrues.

Ka marr pak rërë me grimca hekuri, dy lëndë të ngurta, të cilat i ka përzier mes vete, gjithashtu edhe një magnet. E afron magnetin afër përzierjes së rërës dhe grimcave të hekurit dhe shohin se grimcat e hekurit ngjiten për magneti. Mësuesi/ja u shpjegon se kjo formë përdoret për të ndarë lëndët e ngurta, siç janë p.sh., mbeturinat e metaleve nga të tjerat.

Lexohet shembulli i ndarjes së lëndëve përmes sitjes dhe diskutohet në mënyrë të përbashkët.

**Hapi III**

Mësuesi/ja parashtron disa pyetje në lidhje me njësinë e mësuar.

- *Çfarë përzierje është përzierja e ujit më naftën? Argumento shembullin e nxjerrjes së naftës nga fundi i detit.*
- *Me çfarë metode të ndarjes së lëndëve mund të ndajmë përzierjen e grimcave të argjendit me gurë të imët?*
- *Me çfarë metode të ndarjes së lëndëve mund të ndajmë miellin e misrit? Argumento.*

Nxënësit japin mendimet e tyre dhe mësuesi/ja jep sqarime plotësuese.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet angazhimi i nxënësve në përgjigjet e pyetjeve, saktësia e përgjigjeve.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Realizimi i Veprimtarisë 1.7b

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| **Fusha kurrikulare:** | **Lënda:** | **Shkalla e kurrikulës:** | **Klasa:** |
|---|---|---|---|
| **Shkencat e natyrës** | **Njeriu dhe natyra** | **II** | **IV** |

| | |
|---|---|
| **Tema: Materialet dhe vetitë e tyre** | **Rezultati i të nxënit të temës**: Dallon përbërësit kryesor të ajrit (azoti, oksigjeni, dioksidi i karbonit), si dhe demonstron me anë të eksperimentit ndonjërën nga to. |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.2; III.4

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.6

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Përbërësit e ajrit

**Fjalët kyçe:** ajri, oksigjeni, azoti, dioksidi i karbonit.

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- rikujton njohuritë për ajrin;
- emërton përbërësit kryesor të ajrit;
- argumenton shfrytëzimin e ajrit në jetën e përditshme.

**Kriteret e suksesit:**
- Rikujton njohuritë themelore për ajrin.
- Emërton së paku dy përbërës kryesor të ajrit.
- Argumenton së paku tri raste të shfrytëzimit të ajrit në jetën e përditshme.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletët A3, balona, shkop, spango.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm**.**

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Hapi I**

Mësuesi/ja fillon orën duke përsëritur njohuritë paraprake me nxënësit rreth ajrit. Ai/jo përdorur pyetje si: - *Cilët janë faktorët kryesorë që i duhen njeriut për të jetuar? Për çka na duhet ajri? Ku gjendet ajri? A shihet me sy? A ka formë? A ka shije? A ka peshë? Cilët janë përbërësit kryesor të ajrit? Etj.*

**Përgjigjet e sakta të nxënësve** i shkruan në tabelë




**Hapi II**

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit qe të hapin librat në faqen 18 dhe të lexojnë disa herë njësinë mësimore "Përbërësit e ajrit". Pasi nxënësit të kenë lexuar dhe kuptuar njësinë mësuesi/ja bëjnë një shpjegim së bashku rreth rëndësisë së ajrit dhe përbërësve të tij. Mësuesi/ja bënë pyetje në atë formë që të marr përgjigje të sakta nga nxënësit.

- *Cili është elementi më i rëndësishëm në tokë?*
- *Për çka shërben ajri?*
- *Çka do të kishte ndodhur po të mos kishte ajër në natyrë?*
- *Cilët janë përbërësit kryesor të ajrit?*

**Përgjigjet i shkruan në tabelë.**

- Rëndësia e ajrit:

Ajri → Elementi më i rëndësishëm i jetës në tokë.
Ajri → Shërben për frymëmarrjen e organizmave të gjallë.
Ajri → Rregullon temperaturën e sipërfaqes së tokës.

- Përbërja e ajrit:

Ajri → Azot 78%
Ajri → Oksigjen 21%
Ajri → Grimca të gazit të dioksidit të karbonit, hidrogjenit si dhe të avujve të ujit.

**Hapi III**
**Mësuesi/ja do të bëjë një eksperiment me balona.**
Materialet: 2 balona, një lavjerrës (shkop), spango.
I frynë dy balonat i lidh me litar dhe i vendosë njërin në fillim e tjetrin në fund të lavjerrësit. Pyet nxënësit: *Çka mendoni për peshën e ajrit? Po për rëndësinë e ajrit në jetën e përditshme?*



Pastaj e plas njërën balonë, lavjerrësi shkon nga ana e balonës së paplasur.
**Bën diskutime me nxënësit për eksperimentin.**

Më pas, nxënësit i ndanë në grupe, i lë 5 minuta që të shkruajnë në fleta A3 se si e shfrytëzojnë ajrin në jetën e përditshme. Pasi të kenë shkruar, fletat i ngjeshim në tabelë. Prezantojnë me radhë, duke u përpjekur që të mos i përsërisin përgjigjet e njëjta.
Përgjigjet e nxënësve i diskutojnë bashkë.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimit. Ata që argumentojnë eksperimentin dhe që japin më shumë shembuj të përdorimit të ajrit në jetën e përditshme vlerësohen më mirë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Për detyrë shtëpie do të punojnë një mulli prej ere (model nga Veprimtaria 1.8 a, f. 19).
Përgjigjen me shkrim në "Pyetje dhe detyra", f. 19.
Plotësimi në fletoren e punës, f. 10. Njësia: 1.8 Përbërësit e ajrit

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e<br>kurrikulës: II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Materialet dhe vetitë e tyre</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Interpreton rëndësinë e oksigjenit për frymëmarrjen si dhe rëndësinë e mbrojtjes së ajrit prej papastërtive.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.6; III.4</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2; 2.3</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Rëndësia e oksigjenit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: oksigjen, dioksid karbon, ndotje.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- diskuton rreth oksigjenit në natyrë;<br>- rendit rëndësinë e oksigjenit në natyrë;<br>- kryen eksperiment me bimët.<br>Kriteret e suksesit:<br>- Diskuton për rëndësinë e oksigjenit për organizmat e gjallë.<br>- Rendit së paku pesë faktorë që për ta oksigjeni është shumë i rëndësishëm.<br>- Kryen një eksperiment me lule duke ja ndalur dritën e diellit dhe dioksidin e karbonit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, projektori, video, një bimë e mbjellë, kovë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><th colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Hapi I<br>Mësuesi/ja pyet nxënësit se cilët ishin përbërësit kryesor të ajrit? Pasi merr përgjigjen nga nxënësit, paraqet dy pamje njërën me gjelbërim dhe tjetrën me shumë trafik dh pa gjelbërim. I udhëzon nxënësit të shohin pamjet dhe të mendojnë rreth tyre.<br>Nxit nxënësit të flasin sa më shumë për ajrin e pastër, oksigjenin, ndotjen e ajrit etj.<br>Hapi II<br>Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të lexojnë tekstin në faqen 20 - Rëndësia e oksigjenit.<br>Pasi ta kenë lexuar disa herë, diskutojnë bashkë me mësuesin/en e tyre për atë se çka kanë kuptuar dhe bëjnë një përmbledhje së bashku. Përgjigjet i shkruan në tabelë.<br>- Oksigjeni është i rëndësishëm për jetë.<br>- Zë 20 % e ajrit.<br>- Njerëzit dhe kafshët nuk mund të jetojnë pa oksigjen.<br>- Ata thithin oksigjenin dhe nxjerrin dioksid karboni.<br>- Bimët ditën kryjenë veprimin e kundërt me njerëzit.<br>- Thithin dioksid karboni dhe nxjerrin oksigjenin.<br>- Bimët nën ndikimin e diellit kryejnë procesin e fotosintezës.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| **Hapi III**<br>Më pas, mësuesi/ja u prezanton një video të animuar në projektor *(kids, science education Photosynthesis \| #aumsum #kids #science #education #children - YouTube)*, ku nxënësit e shohin procesin e fotosintezës.<br>Pas kësaj, plotësojnë në tekst Veprimtarinë 1.9, f. 21. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësimi përmes informatave kthyese. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyrë shtëpie do të bëjnë eksperiment me një bimë (lule të mbjellë). Lulen do ta ujitin çdo ditë, mirëpo do ta mbulojnë me një kovë për 5 ditë me radhë. Do ta vëzhgojnë dhe mbajnë shënime çdo ditë. Në fund, do të shkruajnë atë që kuptuan nga ky eksperiment.<br>Përgjigjen me shkrim në "Pyetje dhe detyra", f. 21. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Materialet dhe vetitë e tyre</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Interpreton rëndësinë e oksigjenit për frymëmarrjen si dhe rëndësinë e mbrojtjes së ajrit prej papastërtive.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.4; II.7; III.2; IV.3</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.2; 2.3; 2.4; 2.5</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Mbrojtja e ajrit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: smog, ajri i ndotur, ndotës.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- diskuton rreth eksperimentit të bërë;<br>- emëron dukuri që ndodhin si pasojë e ndotjes së ajrit;<br>- bën projekt për mbrojtësit e ajrit.<br>Kriteret e suksesit:<br>- Jep së paku një ide për eksperimentin e bërë.<br>- Emëron së paku tri dukuri për mbrojtjen e ajrit.<br>- Bën projekt me anë të fotove për mbrojtjen e ajrit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Qiri, shkrepëse, pllakë e qelqit, foto, projektori, video.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><th colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</th></tr>
</table>

| |
|---|
| **Hapi I**<br>Mësuesi/ja orën mësimore do ta fillojë me një eksperiment:<br>Merr një qiri, një shkrepëse dhe një pllakë qelqi. Ndezë qiriun e afron pllakën e qelqit mbi qiri.<br>I udhëzon nxënësit të vëzhgojnë situatën. Ata e shohin se pllaka e qelqit fillon të marr ngjyrë të zezë. E fik qiriun dhe mësuesi/ja nuhatë, që nxënësit ta kuptojnë se po vjen një aromë.<br>Nxënësit janë të ndarë në grupe, secili grup do të argumenton eksperimentin e bërë. Pastaj e prezantojnë para shokëve. Tashmë nxënësit do të jenë në gjendje të flasin për ndotjen dhe mbrojtjen e ajrit, sepse këto çështje janë diktuar edhe në njësitë paraprake. Ata kanë të drejtë të hapin librat dhe të lexojnë edhe materialin që e kanë përpara.<br><br>**Hapi II**<br>Nxënësit prezantojnë me radhë punën për mbrojtjen e ambientit. Konceptet kryesore që ata kanë nxjerrë, mësuesi/ja i shkruan në tabelë.<br>✓ Ndotësit kryesorë të ajrit<br>✓ Çka është SMOGU<br>✓ Shëndeti i njeriut dhe ajri i ndotur<br>✓ Mbrojtja e ajrit<br>**Hapi III**<br>Në pjesën e fundit, mësuesi/ja bashkë me nxënësit nxjerrin disa këshilla se si mund ta mbajnë ajrin pastër.<br>Gjithmonë duke marrë shembuj nga jeta e përditshme.<br>Do ta shohin një film te shkurtër *(earth-pollution awareness - Bing video).* |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësimi i nxënësve bëhet në mënyrë sistematike. Vlerësohen prezantime e nxënësve gjatë punës në grupe. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyrë shtëpie do të bëjnë "Pyetje dhe detyra", f. 21, do t'i shkruajnë në fletore.<br>Do të bëjnë një projekt. Mbrojtja e ajrit, foto nga interneti, apo gazeta të ndryshme ku dëshmojnë ndotjen e ajrit. Projektin mund ta prezantojnë qoftë me *Power point* apo edhe me hamer.<br>Udhëzohen nxënësit që orën e ardhshme të marrin në klasë një qiri, gotë qelqi, pjatë të sheshtë dhe një shkrepëse (nxënësit ndahen në grupe nga 5 vetë, secili grup duhet të marr këto gjera për eksperiment). |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Materialet dhe vetitë e tyre</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Interpreton rëndësinë e oksigjenit për frymëmarrjen si dhe rëndësinë e mbrojtjes së ajrit prej papastërtive.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.7; II.8; III.4</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.2; 2.3; 2.4; 2.5</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Punë praktike: Oksigjeni ndihmon djegien</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: Oksigjeni, djegia, zjarri.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- kryen eksperiment sipas udhëzimeve në libër;<br>- përshkruan dukurinë që ndodhi gjatë eksperimentit;<br>- nxjerr konkluzion nga eksperimenti i bërë.<br><br>Kriteret e suksesit:<br>- Kryen së paku një eksperiment sipas udhëzimeve në libër.<br>- Përshkruan dukurinë që ndodhi gjatë eksperimentit të bërë në klasë.<br>- Nxjerr së paku një konkluzion nga eksperimenti i bërë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Qiri, shkrepëse, gotë, pjatë e sheshtë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><th colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Hapi I<br>Mësuesi/ja pasi të ketë diskutuar me nxënësit për njohuritë paraprake për oksigjenin, paraqet eksperimentin që do të punojnë në grupe. Secili grup ka 5 nxënës, ndërsa materialet e nevojshme për eksperiment, secili grupi i ka sjellë më vete.<br><br>Hapi II<br>Nxënësit lexojnë me vëmendje procedurën se si duhet të bëjnë eksperimentin, duke e përcjellë hap pas hapit, siç është në tekstin f. 24. Secili grup punon i pavarur nga tjetri. Mësuesi/ja i vëzhgon me kujdes.<br>Nxënësit shkruajnë konkluzionin e nxjerrë nga eksperimenti i kryer.<br><br>Hapi III<br>Plotësojnë fletën në libër, në faqen 25.</td></tr>
<tr><th colspan="4">VLERËSIMI I NXËNËSVE</th></tr>
</table>

| |
|---|
| Vlerësimi i nxënësve bëhet në mënyrë sistematike. Vlerësohen nxënësit që ndjekin me korrektësi hapat e eksperimentit dhe nxjerrin konkluzionet e duhura.<br>Vlerësim me notë do të kenë edhe te testi përmbledhës për përfundim të kapitullit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyrë shtëpie do të bëjnë "Pyetje dhe detyra", f. 24, do t'i shkruajnë në fletore. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Shkencat e natyrës** | **Njeriu dhe natyra** | **II** | **IV** |

| | |
|---|---|
| **Tema: Bota e gjallë** | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Identifikon mënyrat e riprodhimit të qenieve të gjalla, si një ndër proceset jetësore.<br>Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla. |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):** II.1; III.2, 3

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** 1.2; 2.1, 3

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Riprodhimi i bimëve. Pjalmimi

**Fjalët kyçe:** Riprodhim, pjalmim, lulja, pistil, thekët, krekës, pllenim.

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- identifikon mënyrat e riprodhimit të bimëve;
- shpjegon procesin e riprodhimit të bimëve;
- demonstron mënyrën e riprodhimit të bimëve.

**Kriteret e suksesit:**
- Identifikon së paku një mënyrë të riprodhimit të lules.
- Shpjegon procesin e riprodhimit të lules.
- Demonstron mënyrën e riprodhimit të së paku dy luleve.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** projektor, lule molle, lule bore, fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Hapi I**

Mësuesi/ja fillon orën duke iu rikujtuar njësinë e parë mësimore nga libri Njeriu dhe Natyra 4, ku flitet për botën e gjallë dhe jo të gjallë. Iu bën pyetje nxënësve: *Kush bënte pjesë në botën e gjallë? Çka e dallon botën e gjallë dhe botën jo të gjallë?* Pasi merr përgjigjet e nxënësve, vjen te qëllimi i orës duke treguar se sot do të mësojmë për riprodhimin e bimëve.




**Hapi II**

Hap projektorin (ose foto të madhe në hamer) dhe shpjegon mënyrën e riprodhimit të bimët. Pastaj udhëzon nxënësit të hapin librat dhe lexojnë paragrafin e parë. Nxënësit janë të ndarë në dy grupe, (mësimi zhvillohet intereraktiv), ku grupet i bëjnë pyetje me radhë njëri-tjetrit, përgjigjet e sakta i shënojmë në tabelë.

Vazhdojnë në këtë mënyrë edhe me paragrafët e radhës, në të njëjtën mënyrë, duke i bërë pyetje njëri-tjetrit. Në fund, numërojnë pikët dhe shpallim fitues grupin qe ka dhënë sa më shumë përgjigje të sakta.

**Hapi III**

Nxënësit udhëzohen të punojnë në mënyrë individuale, atyre do t'u jepen këto fletë si ky model (ose e hapim në projektor e nxënësit vizatojnë në fletore) që t'i plotësojnë, mësuesi/ja kontrollon gjatë punës dhe i vlerëson nxënësit që punojnë më shpejt dhe pa gabime.




**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit vlerësohen sistematikisht. Ata që japin përgjigjet më të shpejta dhe të sakta, vlerësohen më mirë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit udhëzohen të marrin disa lule në kopshtin e shtëpisë apo të shkollës (lule bore, lule molle) dhe të shpjegojnë mënyrën e riprodhimit të tyre. Si dhe përgjigjen në "Pyetje dhe detyra", f. 27, përgjigjet i shkruajnë në fletore.

Plotësimi në fletoren e punës, f. 11. Njësia: 2.1 Riprodhimi i bimëve. Pjalmimi

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| **Fusha kurrikulare:** | **Lënda:** | **Shkalla e kurrikulës:** | **Klasa:** |
|---|---|---|---|
| **Shkencat e natyrës** | **Njeriu dhe natyra** | **II** | **IV** |

**Tema: Bota e gjallë**

**Rezultati i të nxënit të temës:**
Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla.
Krahason të veçantat dhe të përbashkëtat e riprodhimit tek organizmat e grupeve të ndryshme.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore** të shkallës (të synuara): II.1; III.2, 3, 4

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** 1.2; 2.1, 2

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Riprodhimi vegjetativ i bimëve

**Fjalët kyçe:** riprodhim vegjetativ, kërcej, rrënjë, gjethe, shartim, kalema.

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**

**Nxënësi/ja:**
- rendit mënyra të riprodhimit të bimëve;
- analizon mënyra të ndryshme të riprodhimit vegjetativ;
- përmbledhë atë që ka mësuar.

**Kriteret e suksesit:**
- Rendit së paku tri mënyra të riprodhimit të bimëve.
- Analizon mënyrat e riprodhimit vegjetativ te bimët.
- Bënë përmbledhjen në fletë pastaj prezanton me gojë, riprodhimin vegjetativ të bimëve.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**
Mësuesi/ja lidh njësinë e fundit me njësinë e re, duke iu rikujtuar format e riprodhimit të bimës me anë të pjalmimit me erë, pjalmimit me anë të insekteve si dhe vetëpjalmimit. Formë tjetër e riprodhimit të bimëve është ai me kërcej mbitokësor dhe nëntokësor, si dhe riprodhimi me rrënjë, gjethe dhe degë e që quhet riprodhim vegjetativ.

**Hapi II**
Mësuesi/ja hap diskutimet me nxënësit rreth riprodhimit të dredhëzës, patateve, qepëve. Pyet nxënësit: *A ka ndonjë dredhëza të mbjella në kopsht?* Pret përgjigjet e nxënësve, pastaj i pyet: *A e dini se si shumohen dredhëzat? Si mbillen patatet, qepët?* N.q.s. merr përgjigjen e saktë nga nxënësit, mësuesi/ja jep sqarime shtesë, n.q.s. nxënësit nuk kanë përgjigjet e sakta atëherë hap librin (projektorin) dhe iu sqaron se si riprodhohen këto bimë.
Mësuesi/ja merr dy lloj kërcejsh, dhe shpjegon mënyrën e shartimit te bimëve.



**Hapi III**
Nxënësit ndahen në grupe, iu jepet nga një fletë A3, secili grup duhet të shkruaj njërën nga mënyrat e riprodhimit vegjetativ. Pastaj bëjnë prezantimet para klasës. Grupet kanë të drejtë edhe t'ju bëjnë pyetje njëri-tjetrit.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit vlerësohen sistematikisht, vlerësohen më mirë nxënësit që janë aktiv në klasë, që bëjnë përmbledhjen e asaj që mësuan dhe prezantimin e asaj përmbledhje.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Punohet Veprimtaria 2.2b në shtëpi. "Pyetje dhe detyra", f. 29, i shkruajnë në fletore.
Plotësimi në fletoren e punës, f. 12. Njësia: 2.2 Riprodhimi vegjetativ i bimëve

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

# ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| **Fusha kurrikulare:** | **Lënda:** | **Shkalla e kurrikulës:** | **Klasa:** |
|---|---|---|---|
| **Shkencat e natyrës** | **Njeriu dhe natyra** | **II** | **IV** |

**Tema: Bota e gjallë**

**Rezultati i të nxënit** të temës:
Identifikon mënyrat e riprodhimit të qenieve të gjalla, si një ndër proceset jetësore.
Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):** I.3; II.1; III.4

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** 1.2.5; 2.1.4

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Riprodhimi i insekteve

**Fjalët kyçe:** insekte, vezë, larva, pupë, bleta mbretëresha.

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- diskuton rreth njohurive paraprake për qeniet e gjalla;
- identifikon mënyrat e riprodhimit të qenieve të gjalla;
- shpjegon ciklet jetësore të qenieve të gjalla.

**Kriteret e suksesit:**
- Diskuton rreth insekteve qe i njeh.
- Identifikon se paku dy mënyra të riprodhimit të qenieve të gjalla.
- Shpjegon ciklet jetësore të fluturës dhe bletës.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektor, fletë A4, fletë Hamer.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Hapi I**
Mësuesi/ja fillon orën duke biseduar me nxënësit rreth insekteve. *Cilat insekte i njohin? Ku i kanë parë? Cilat prej insekteve ju pëlqejnë? A e dinë se si shumohen (riprodhohen) ato?* Pasi merr përgjigjen nga nxënësit dhe vlerëson nivelin se ku janë me njohuritë, i udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të punojnë në çifte, klasën e ndanë në çiftin 1 dhe 2. Çifti 1 do të lexojë rreth ciklit të jetës së një fluture, ndërsa çifti 2 do të lexojë ciklin e jetës së bletës (njëra bankë është 1-shi, tjetra 2-shi).

**Hapi II**
Pasi të kenë lexuar për 5 minuta tekstin në f. 30, 1-shat dhe 2-shat bëhën bashkë.
Udhëzohen të bëjnë përmbledhjen e asaj që e lexuan dhe të shpjegojnë me gojë. Nxënësve gjithashtu u jepet nga një fletë *Hamer*, që edhe të vizatojnë ciklet jetësore të fluturës dhe bletës. Nxënësit plotësojnë njeri-tjetrin gjatë prezantimit.

**Hapi III**
Në fund të orës, mësuesi/ja lëshon një video ku shihet cikli jetësor i fluturës.
]][*www.bingo.com* *Life Cycle of a Butterfly for Kids - Bing video*

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit vlerësohen sistematikisht. Me vlerësim maksimal vlerësohen nxënësit që prezantojnë ciklin jetësorë të insekteve si dhe ata që punuan Veprimtarinë 2.3.

| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
|---|
| Nxënësit punojnë veprimtarinë 2.3 (paraprakisht janë njoftuar të sjellin materialet e nevojshme në klasë).<br>Bëjnë punë individuale. Ndërsa detyrë shtëpie do të punojnë “Pyetje dhe detyra”, f. 31. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Bota e gjallë** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Identifikon mënyrat e riprodhimit të qenieve të gjalla, si një ndër proceset jetësore.<br>Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):** I.3; II.1; III.4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** 1.2, 5; 2.1.4 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Riprodhimi i amfibëve dhe shpendëve | | | |
| **Fjalët kyçe:** pllenim, embrion, klloçkë, qeliza mashkullore. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- identifikon ujëtokësorët (amfibët) dhe shpendët;<br>- analizon mënyrën e riprodhimit të ujëtokësorët (amfibët) dhe shpendët;<br>- demonstron ciklin jetësor të shpendëve.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Identifikon së paku një ujëtokësor dhe një shpend.<br>- Analizon mënyrën e riprodhimit të një ujëtokësori dhe një shpendi.<br>- Demonstron ciklin jetësor të pulës. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** tabela, projektori. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Mësuesi/ja shkruan në tabelë dy fjalët kyçe të njësisë që do të shpjegohet.<br>ujëtokësor (amfib) → → →      shpendë → → → | | | |

| |
|---|
| Pyet nxënësit çka dinë rreth këtyre dy fjalëve. Përgjigjet e sakta të nxënësve i shkruan pranë fjalëve adekuate.<br>**Hapi II**<br>I udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të lexojnë njësinë mësimore f. 32. Pastaj bën pyetje rreth njësisë si:<br>- *Kur riprodhohen bretkosat?*<br>- *Çka kuptojmë me pllenim?*<br>- *Si bëhet cikli jetësor i bretkosës?*<br>- *Ku bëhet riprodhimi i shpendëve?*<br>- *Si formohet një pasardhës i shpendëve?*<br>- *Si bëhet cikli jetësor i shpendëve?*<br>Përgjigjet e sakta të nxënësve i shkruan pranë pyetjeve në tabelë, gjithmonë duke i plotësuar përgjigjet jo të plota të nxënësve.<br>**Hapi III**<br>Punojnë veprimtarinë 2.4.<br>Pastaj i lexojmë përgjigjet e disa nxënësve. Në fund lëshohet videoja, ku shihet cikli jetësor i bretkosës *https://www.bing.com/videos/search?q=frog+life+cycle*. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Nxënësit vlerësohen në përgjigjet e sakta që japin. Vlerësohen edhe ata që punojnë saktë dhe shpejtë veprimtarinë 2.4. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Nxënësit do të përgjigjen në "Pyetje dhe detyra", f. 23. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Bota e gjallë** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Identifikon mënyrat e riprodhimit të qenieve të gjalla, si një ndër proceset jetësore.<br>Shpjegon procesin e riprodhimit të qenieve të gjalla.<br>Krahason të veçantat dhe të përbashkëtat e riprodhimit tek organizmat e grupeve të ndryshme. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):** I.3; II.1, 8; III.1, 4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):** 1.2, 5; 2.1.4 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Riprodhimi i gjitarëve | | | |
| **Fjalët kyçe:** gjitarë, qeliza mashkullore, placentë, lind, gji. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- diskuton rreth riprodhimit të qenieve të gjalla; | | | |

- analizon mënyrën e riprodhimit te gjitarët;
- demonstron ciklin jetësor te gjitarët.

**Kriteret e suksesit:**
- Diskuton rreth riprodhimit të bimëve, insekteve, ujëtokësorëve dhe shpendëve.
- Analizon mënyrën e riprodhimit të njeriut.
- Demonstron me anë të vizatimit ciklin jetësor të njeriut.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Matematikë, Edukatë figurative, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Pasi është ora e fundit që flitet për riprodhim, mësuesi/ja bën një përmbledhje të riprodhimit te qeniet e gjalla. Në tabelë paraqet disa Kllastera, ku nxënësit duhet t'i plotësojnë me përgjigjet e tyre.

| | | | |
|---|---|---|---|
| Si riprodhohen **BIMËT?** | Si riprodhohen **INSEKTET?** | Si riprodhohen **UJËTOKËSORËT?** | Si riprodhohen **SHPENDËT?** |

**Hapi II**

Pyet nxënësit nëse dikush nga ata e ka nënë shtatzënë, apo edhe kafshët shtëpiake që kanë: mace, qenushe. Flasin për ndryshimet e dukshme që shihen në trupin e një shtatzëneje. Pastaj, mësuesi/ja iu shpjegon procesin e riprodhimit të gjitarëve kohëzgjatjen e qëndrimit të tyre në bark.

I udhëzon të hapin librat dhe të lexojnë 5 minuta. Nxënësit ndahen në tri grupe (rreshtat se si janë ulur) dhe i bëjnë pyetje njëri-tjetrit, ku mësuesi/ja i menaxhon se kush duhet të pyes e kush të përgjigjet.

**Hapi III**

Punojnë në mënyrë individuale Veprimtarinë 2.5.

E lexojnë disa nxënës ketë detyrë.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit vlerësohen për përgjigjet e sakta gjatë orës mësimore.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Për detyrë shtëpie do të flasin me prindërit rreth ciklit jetësor të njeriut dhe duhet t'i vizatojnë këto faza. Pyetjet dhe detyrat f. 35, i shkruajnë në fletore.

Plotësimi në fletoren e punës, f. 13. Njësia: 2.5 Riprodhimi i gjitarëve

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Shkencat e natyrës** | **Njeriu dhe natyra** | **II** | **IV** |

| | |
|---|---|
| **Tema: Bota e gjallë** | **Rezultati i të nxënit të temës:** Analizon rëndësinë e të ushqyerit shëndetshëm. |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës**: I.3; II.7; III.4; V.3

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.5

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pse ushqehemi?

**Fjalët kyçe:** ushqim, lëndë ushqyese.

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- tregon për rëndësinë e ushqimit;
- analizon piramidën e ushqimit;
- arsyeton për mënyrën e të ushqyerit të shëndetshëm kundrejt atij të pashëndetshëm.

**Kriteret e suksesit:**
- Jep së paku tri mendime për rëndësinë që ka ushqimi për trupin e njeriut.
- Analizon të gjitha pjesët përbërëse të piramidës së ushqimit.
- Jep tri arsye për mënyrën e të ushqyerit të shëndetshëm kundrejt atij të pashëndetshëm.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, projektori, fotografitë me ushqimet e shëndetshme/ pashëndetshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Hapi I**
Mësuesi/ja parashtron pyetjen nxënësve: *Cili është ushqimi juaj i preferuar? Tregoni pse ju pëlqen?*
Nxënësit japin përgjigjet e tyre, duke dhënë edhe arsyet se pse u pëlqen një ushqimi i caktuar.
Në tabelë, mësuesi/ja shkruan: *Rëndësia e ushqimit.* Këtë e paraqet në formë të kllasterit. I nxit nxënësit që të mendojnë se çfarë rëndësie dhe të mirash ka ushqimi për jetën tonë.
Nxënësit japin përgjigjet e tyre në lidhje me rëndësinë e ushqimit. Disa nga përgjigjet e tyre shkruhen në tabelë.




**Hapi II**
Nxënësit njoftohen se do të mësojnë për ushqimet. Udhëzohen t`i hapin librat në faqen 36. Lexohet me paragrafë. Një nga nxënësit lexon më zë paragrafin e parë. Mësuesi/ja pyet nxënësit çfarë kanë kuptuar nga leximi, pastaj jep shpjegime për termin *lëndë ushqyese* dhe për mënyrën se si ne fitojnë energji nga ushqimi.
Lexohet paragrafi i dytë, diskutohet me nxënësit se çfarë kanë kuptuar dhe shpjegohet rëndësia e ushqimit për trupin tonë.

Analizohet piramida e ushqimit. Lexojmë për mënyrën e ndërtimit të saj. Pastaj, mësuesi/ja pyet nxënësit: *Çfarë i mundësojnë trupit tonë buka dhe drithërat? Çfarë i shërbejnë trupit tonë frutat dhe perimet, qumështi dhe produktet e qumështit, mishi dhe peshku, yndyrnat?*
Diskutohet rreth këtyre pyetjeve, mësuesi/ja jep informacione plotësuese për secilën pjesë të piramidës së ushqimit.
Diskutohet se çfarë duhet të përmbajë dieta jonë dhe çfarë rëndësie ka ushqimi i shëndetshëm për trupin tonë.

**Hapi III**

Mësuesi/ja para nxënësve paraqet, përmes projektorit dy raste. Dietën e Artës dhe atë të Benit.

Arta



Beni



Mësuesi/ja pyet nxënësit:
- *Nga çfarë ushqimesh përbehet dieta e Anës dhe Benit?*
- *Cili nga ata ushqehet më shëndetshëm?*
- *Pse ushqimet e Anës janë të pashëndetshme?*

Nxënësit japin mendimet e tyre dhe diskutohet së bashku me mësuesin/en për ushqimet e shëndetshme dhe rëndësinë e tyre për trupin tonë.

| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
|---|
| Vlerësim i vazhdueshëm i angazhimit në dhënien e mendimeve, vlerësohet analiza e piramidës së ushqimit dhe arsyetimi i rasteve për ushqimin e shëndetshëm. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyra 3 - "Pyetje dhe detyra". Plotësimi në fletoren e punës, f. 14. Njësia: 2.6 Pse ushqehemi? Të sjellin tri ushqime nga shtëpia për orën e ardhshme. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Bota e gjallë** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Analizon rëndësinë e të ushqyerit shëndetshëm.<br>Vlerëson rolin biologjik të të ushqyerit dietal. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.1, 4; V.3 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Ushqimi i shëndetshëm | | | |
| **Fjalët kyçe:** karbohidrate, yndyrna, proteina, vitamina, minerale. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- argumenton si do të ishte shëndeti i njeriut nëse do të ushqehej vetëm me një lloj ushqimi;<br>- kategorizon ushqimet në grupet e ushqimeve;<br>- liston dobitë/rëndësinë e ushqimeve sipas grupeve, për organizmin e njeriut.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Jep së paku 2 argumente se si do të ishte shëndeti i njeriut nëse do të ushqehej vetëm me një lloj ushqimi.<br>- Kategorizon të gjitha ushqimet e prezantuara në grupet e ushqimeve.<br>- Liston së paku dy dobi për secilën kategori (grup) të ushqimeve, për organizmin e njeriut. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, projektori, ushqime të ndryshme. | | | |
| **Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Nxënësit kanë sjellë në klasë disa ushqime (sipas detyrës së shtëpisë nga ora e kaluar). Zhvillohet veprimtaria 2.6 nga ora e kaluar, ku disa nga nxënësve u mbyllen sytë dhe ata shijojnë ushqime dhe tregojnë se cilat janë. Pasi t'i dallojnë përmes shijes, u hapim sytë dhe flasim për rëndësinë që ato kanë për trupin tonë, për vlerat e tyre ushqyese dhe në cilën kategori të piramidës së ushqimit bëjnë pjesë. Merren edhe disa nga ushqimet e tjera që kemi në klasë dhe diskutohen së bashku me nxënësit për rëndësinë, vlerat ushqyese dhe kategorinë e tyre.<br>Mësuesi/ja i pyet nxënësit: *Si do të ishte shëndeti i njeriut nëse ai do të ushqehej vetëm me një lloj ushqimi?*<br>Nxënësit nxiten të mendojnë rreth pyetjes dhe japin përgjigjet e tyre. Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve për ushqimin e shëndetshëm.<br>**Hapi II**<br>Nxënësit hapin librat në faqen 38 dhe njihen me njësinë Ushqimi i shëndetshëm. Për 5 minuta, nxënësit lihen që ta lexojnë njësinë mësimore dhe të vendosin me √ gjërat që i kanë ditur më parë dhe me + (plus) gjërat që i kanë mësuar të reja.<br>Mësuesi/ja pyet nxënësit: *Cilat janë gjërat e reja që keni mësuar?*<br>Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Pastaj vijohet me pyetjet: *Çfarë janë karbohidratet? Çka na mundësojnë ato? Përmend disa karbohidrate?* | | | |

| |
|---|
| *Çfarë janë yndyrnat? Çka na mundësojnë ato? Përmend disa yndyrna.*<br>*Çfarë janë proteinat? Çka na mundësojnë ato? Përmend disa proteina.*<br>*Çfarë janë vitamina? Çka na mundësojnë ato? Përmend disa vitamina.*<br>*Çfarë janë mineralet? Çka na mundësojnë ato? Përmend disa minerale.*<br>Përgjigjet e nxënësve plotësohen nga informacione shtesë (shembuj) që mësuesi/ja jep rreth pyetjeve.<br>Nxënësit udhëzohen të plotësojnë tabelën në faqen 39, veprimtaria 2.6.<br>**Hapi III**<br>Mësuesi/ja përmes projektorit paraqet një ushqim (p.sh. gjalpi) dhe pyet nxënësit: *Në cilin grup të ushqimeve bën pjesë? Çfarë dobie i sjell ai trupit tonë?*<br>Kështu paraqiten edhe disa ushqime të tjera që nuk janë përmendur në libër dhe parashtron pyetje rreth tyre, të ngjashme me shembullin e parë.<br>Për pak minuta, në fund të orës, mësuesi/ja u lexon disa fjali që janë në formë të një kuizi p.sh.<br>Karbohidrat është: *a) djathi b) buka c) veza*<br>Mineral është: *a) kalciumi b) brokoli  c) gjalpi*<br>Lexohen disa fjali të tilla për secilën nga grupet e mësuara të ushqimeve. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohet argumentimi i nxënësve rreth pyetjeve të parashtruara, saktësia e kategorizimit të ushqimeve në grupe, angazhimi në dhënien e përgjigjeve në pyetjet-kuiz. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Pyetje dhe detyra f. 39, Plotësimi në fletoren e punës, f. 15. Njësia: 2.7 Ushqehemi shëndetshëm<br>**Orën e ardhshme që do të jetë përsëritje,** do të punohet në grupe ku secili grup do të analizojë ushqime të sjella nga shtëpia, duke lexuar të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskutuar në grup të dhënat (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.). |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Bota e gjallë** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Identifikon mënyra të ruajtjes së ushqimit nga faktorët mjedisor. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.1, 4; V.3 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Ruajtja e ushqimit | | | |
| **Fjalët kyçe:** ushqime të ndotura, myk, kriposje, zierje | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- identifikon ushqimet e prishura;<br>- klasifikon metodat e ruajtjes së ushqimit;<br>- krijon një listë me këshilla për ruajtjen e ushqimit të pastër dhe të shëndetshëm. | | | |

**Kriteret e suksesit:**
- Identifikon të gjitha rastet e ushqimeve të prishura të paraqitura përmes fotografive.
- Klasifikon të gjitha metodat e ruajtjes së ushqimit në fletën e punës.
- Harton një listë me pesë këshilla për ruajtjen e ushqimit të pastër dhe të shëndetshëm.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, projektori, fleta pune e përgatitur nga mësuesi/ja.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi/ Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Mësuesi/ja, përmes projektorit, paraqet disa fotografi të ushqimeve të prishura.





Pyet nxënësit: *Çfarë po shihni në fotografi?* Nxënësit identifikojnë ushqimet e prishura. Pastaj mësuesi/ja vazhdon me pyetje: *Pse mendoni që është prishur ushqimi? Trego ndonjë rast kur ti ke hasur në një ushqim të prishur? Si e ruani ju në shtëpinë tuaj ushqimin që të mos prishet?*
Nxënësit japin mendimet e tyre pas secilës pyetje. Njoftohen se do të mësojnë me shumë për mënyrën e ruajtjes së ushqimit.

**Hapi II**

Nxënësit hapin librat në faqen 40. Lexohet pjesa e parë e njësisë. Pyeten nxënësit:
- *Pse prishet ushqimi?*
- *Si duket ushqimi i prishur?*
- *Çfarë është myku?*
- *Si ndikon ushqimi i prishur në shëndetin tonë?*

Jepen përgjigje nga nxënësit dhe gjithashtu komente plotësuese nga mësuesi/ja, duke sqaruar informacionet që janë të reja për nxënësit. P.sh. myku që formohet në ushqim tregon si formohet ai duke e lidhur me shembullin e parë të paraqitur përmes projektorit.
Udhëzohen nxënësit që të lexojnë metodat që përdorën për ruajtjen e ushqimit. Pastaj, mësuesi/ja u jep nxënësve nga një fletë punuese ku do të plotësohet rreth metodave për ruajtjen e ushqimit.

| Metoda për ruajtjen e ushqimit | Shpjegimi | Shembulli |
|---|---|---|
| Kriposja | | |
| Zierja | | |
| Vendosja në firgorifer | | |
| Tharja e frutave | | |
| Shtimi i sheqerit | | |

Tabela plotësohet bashkërisht me mësuesin/en. Mësuesi/ja pyet për secilën metodë të ruajtjes së ushqimit, shkruhet shpjegimi për të duke i mbledhur mendimet e disa nxënësve në një fjali. Ajo fjali shkruhet në kolonën shpjegimi. Pastaj pyet për shembuj për secilën metodë. Zgjidhen shembujt më të mirë dhe shkruhen në kolonën shembulli, për secilën metodë.

| **Hapi III**<br>Nxënësit udhëzohen që, në fletore, të hartojnë një listë me 5 këshilla për: *Si mund ta ruajmë ushqimin tonë të pastër dhe të shëndetshëm?*<br>Nxënësit hartojnë listën dhe disa nga ata e lexojnë para klasës. |
|---|
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohet saktësia e plotësimit të fletës punuese për klasifikimin e metodave për ruajtjen e ushqimit, aftësia për krijimin e këshillave për një ushqim të pastër dhe të shëndetshëm, angazhimi në dhënien e përgjigjeve. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| "Pyetje dhe detyra", pyetjet 3 dhe 4. Plotësimi në fletoren e punës, f. 16, 17. Njësia: 2.8 Ruajtja e ushqimit |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare: Shken-cat e natyrës** | **Lënda: Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës: II** | **Klasa: IV** |
| **Tema: Bota e gjallë** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Emërton substanca helmuese – duhani, alkooli, kafja etj.<br>Gjykon për efekte anësore të përdorimit të substancave helmuese. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.5; III.4; IV.7 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Substanca të dëmshme për shëndetin | | | |
| **Fjalët kyçe:** droga, duhani, alkooli, kafeina. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- dallon veçori të drogës, duhanit dhe alkoolit;<br>- analizon ndikimin e drogës, duhanit dhe alkoolit në shëndetin e njeriut;<br>- krijon projekt për drogën, duhanin dhe alkoolin.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Identifikon së paku tri veçori dalluese të drogës, duhanit dhe alkoolit.<br>- Analizon sipas informatave në libër për ndikimin e drogës, duhanit dhe alkoolit në shëndetin e njeriut.<br>- Krijon projekt për drogën, duhanin dhe alkoolin (shpjegimi, dukja dhe ndikimi te njeriu). | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, tabela, projektori, *flipchart*, markera. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |

**Hapi I**

Mësuesi/ja pyet nxënësit: *Çfarë ju vjen ndër mend kur e dëgjojmë fjalën drogë? Çfarë dini për drogën? Si mendoni se ndikon ajo në shëndetin tonë?*
Të njëjtat pyetje parashtrohen edhe për duhanin dhe alkoolin. Nxënësit shprehin informacionet që kanë drogën, duhanin dhe alkoolin.
Para tyre, përmes projektorit, mësuesi/ja shfaq një video të shkurtër sqaruese rreth temës.
https://www.betterhealth.vic.gov.au/bushfiresmoke. Videoja shoqërohet me sqarimet plotësuese nga mësuesi/ja.

**Hapi II**

Nxënësit hapin librat në faqen 42. Lexohet në mënyrë individuale e gjithë njësia. Nxënësve u jepet nga një fletë plotësuese me tre Kllastera për secilën lëndë.




Mësuesi/ja ua parashtron këto pyetje nxënësve me radhë, jepen disa përgjigje për secilën pyetje. Nxënësit plotësojnë Kllasterin, duke përmbledhur përgjigjet e dhëna nga shokët/shoqet së bashku me mendimet e tyre.
Diskutohet edhe për kafeinën si drogë, duke sjellë shembuj nga jeta e përditshme.

**Hapi III**

*Projekt.* Nxënësit ndahen në tri grupe. Atyre u jepen fleta *Flip chart* ku do të shkruajnë disa mesazhe sensibilizuese përkundër përdorimit të drogës, duhanit dhe alkoolit. Grupi I do të punojë për drogën, grupi II për duhanin dhe grupi III për alkoolin. Përmbajtja e projektit duhet të jetë, mesazhe sensibilizuese kundër përdorimit të këtyre substancave, vizatime simbolike, disa fakte të mësuara nga njësia mësimore.
Secili grup prezanton punën që ka bërë. Jepen komente kthyese nga mësuesi/ja. Prezantime do të realizohen edhe orën e ardhshme që është përforcim i njohurive, rreth Veprimtarisë 2.9. Gjetjet e tyre, nxënësit do t`i prezantojnë para klasës.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohen njohuritë e tyre për drogën, duhanin dhe alkoolin, saktësia e plotësimit të fletës punuese, aftësia për bashkëpunim më shokët/shoqet e grupit, aftësia e prezantimit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Veprimtaria 2.9, Plotësimi në fletoren e punës, f. 18. Njësia: 2.9 Substanca të dëmshme për shëndetin

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Bota e gjallë</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Përshkruan zhvillimin dhe ndryshimet e trupit, gjatë moshës se pubertetit.<br>Përshkruan ndryshimet fizike, emocionale dhe mendore që ndodhin në trup në fazën e pubertetit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.8; III.4</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 2.5</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Fazat e rritjes dhe zhvillimit të njeriut</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: rritje, ndryshim, zhvillim, forma trupore.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- krahason ndryshimet fizike dhe psikike gjatë kohëve të ndryshme të zhvillimit;<br>- analizon veçoritë e fazave të zhvillimit njerëzor;<br>- liston veçori të fazës së fëmijërisë.<br>Kriteret e suksesit:<br>- Identifikon së paku nga dy ndryshime fizike dhe psikike (të brendshme) që kanë përjetuar nga faza e mëparshme me fazën e tanishme.<br>- Analizon disa nga veçoritë e fazave të zhvillimit sipas informacioneve në libër.<br>- Liston të gjitha veçoritë e fëmijërisë të kërkuara nga detyra e dhënë nga mësuesi/ja.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti, fletorja, tabela, metri, shënimet nga ditari i të dhënave për nxënësit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><th colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Hapi I:<br>Mësuesi/ja merr një metër me vete dhe mat gjatësinë e tre nxënësve. Gjatësinë aktuale e krahason me gjatësinë që u ka matur nxënësve në çdo vit (klasë). Nga shënimet që ka mbledhur nga klasa e parë deri në të katërtën (shënimet nga dosjet personale për nxënësit), u tregon nxënësve sa të gjatë kanë qenë në secilën klasë. Pyet nxënësit: Si mendoni pse ka ndryshuar gjatësia juaj? Mund të përmendni ndonjë ndryshim tjetër në fizikun tuaj?<br>Nxënësit japin mendimet e tyre për ndryshimet që kanë përjetuar ndër vite.<br>Mësuesi/ja paraqet situatën: Jeta është një vajzë që si fëmijë ka besuar që një tortë e ndarë në 8 pjesë është më shumë sesa po e njëjta tortë e ndarë në 4 pjesë. Çfarë ka ndryshuar te Jeta?<br>Pas përgjigjeve të nxënësve, mësuesi/ja sqaron se pos ndryshimeve fizike (të pamjes së jashtme) njerëzit ndryshojnë edhe nga ana e brendshme, me mendimeve që kanë për botën.<br>Hapi II<br>Nxënësit hapin librat në faqen 44. Njoftohen me njësinë mësimore. Lexohet me zë nga një nxënës paragrafi i parë, analizohet skema e ciklit të ndryshimeve që përjetojnë njerëzit gjatë zhvillimit të tyre. Lexohet paragrafi 2 dhe 3 dhe mësuesi/ja bën pyetjet:</td></tr>
</table>

- *Cilat janë fazat nëpër të cilat kalon zhvillimi i njeriut?*
- *Çfarë ndodh në periudhën e foshnjërisë?*
- *Çfarë ndodh në periudhën e fëmijërisë?*
- *Çfarë ndryshimesh ndodhin në periudhën e pubertetit?*

Përgjigjet e nxënësve plotësohen nga informacione që mësuesi/ja u jep duke sqaruar se periudha e foshnjërisë zgjat 2 vitet e para të jetës, fëmijëria 2-12 vjeç dhe adoleshenca 12, 13-18 vjeç. Shpjegon se çfarë i veçon secilën prej këtyre periudhave.

**Hapi III**

Mësuesi/ja në tabelë vizaton një Kllaster ku në qendër shkruan: *fëmijëria*
Nxënësit e vizatojnë këtë në fletore dhe e plotësojnë në mënyrë individuale.




Mësuesi/ja i udhëzon se Kllasteri duhet të plotësohet rreth moshës që e përfshin faza e fëmijërisë, ndryshimet që ndodhin në trupin tonë, në pamjen fizike, çfarë ndryshojmë nga ana e brendshme, çfarë mendimesh kemi, çfarë na pëlqen në këtë fazë, çfarë lojërash luajmë, çfarë librash lexojmë, çfarë programesh televizive shikojmë. Këto kërkesa i shkruan në tabelë.
Disa nga nxënësit e lexojnë punën e realizuar. Mësuesi/ja i nxit nxënësit të krahasojnë disa elemente të asaj që kanë shkruar me mënyrën si kanë ndryshuar nga klasa e parë. Komentet e tyre jepen përmes komunikimit gojor.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet angazhimi në dhënien e përgjigjeve rreth pyetjeve të parashtruara nga mësuesi/ja, saktësia e plotësimit të Kllasterit, krahasimi mes së sotmes dhe periudhës së klasës së parë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Veprimtaria: Sa jam rritur? Pyetje dhe detyra 3 dhe 4. Plotësimi në fletoren e punës, f. 19. Njësia: 2.10 Fazat e rritjes dhe zhvillimit

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
| **Tema: Bota e gjallë** | | Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan zhvillimin dhe ndryshimet e trupit, gjatë moshës se pubertetit. Përshkruan ndryshimet fizike, emocionale dhe mendore që ndodhin në trup në fazën e pubertetit. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III.4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Ndryshimet në trupin tim. Puberteti | | | |

**Fjalët kyçe:** rritje, zhvillim, pubertet, forma trupore, zë i fortë, riprodhim

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**

**Nxënësi/ja:**

- përmend veçoritë fizike dhe sjelljore/emocionale të fazës së pubertetit;
- analizon ndryshimet fizike në fazën e pubertetit;
- kategorizon ndryshimet fizike, të sjelljes dhe mendore/emocionale të fazës së pubertetit.

**Kriteret e suksesit:**

- Jep së paku dy veçori fizike dhe të sjelljes/emocionale të fazës së pubertetit të mësuara nga ora e kaluar.
- Analizon të gjitha ndryshimet fizike në fazën e pubertetit bazuar në të dhënat në libër.
- Kategorizon nga dy ndryshime fizike, të sjelljes dhe mendore/emocionale të fazës së pubertetit, në fletën e punës.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, tabela, fletorja, projektori, video sqaruese, fletë pune përgatitur nga mësuesi/ja.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Përsërisim disa nga informacionet që kemi marrë nga ora e kaluar rreth fazës së pubertetit. Mësuesi/ja pyet nxënësit se cilat ishin veçoritë e kësaj faze të zhvillimit, përkatësisht mosha, ndryshimet fizike dhe mendore/emocionale.

Mësuesi/ja, përmes projektorit, paraqet një video sqaruese për fazën e pubertetit: https://www.twinkl.co.uk/teaching-wiki/puberty. Videoja sqaron për ndryshimet që përjetojnë adoleshentët, (vajzat dhe djemtë) gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, tregohen shembuj (vëllezër, motra) nga mësuesi/ja apo nxënësit që janë në fazën e pubertetit për veçoritë që përjetojnë gjatë zhvillimit të tyre.

**Hapi II**

Nxënësit njoftohen me njësinë mësimore në faqen 46. Lexohet paragrafi i parë. Mësuesi/ja pyet nxënësit: *Cilat qenkan ndryshimet fizike që ndodhin në fazën e pubertetit?* Nxënësit japin mendimet e tyre nga ajo që kuptuan nga leximi.

Lexohet paragrafi i dytë dhe parashtrohet pyetja nga mësuesi/ja: *Cilat janë ndryshimet që ndodhin në sjelljet dhe anën e brendshme në fazën e pubertetit?*

Lexohet paragrafi i fundit dhe mësuesi/ja shpjegon se çfarë është personaliteti dhe faktorët që ndikojnë në ndërtimin e personalitetit. Këtë e shpjegon duke marrë shembuj konkretë, se si shoqëria jonë, librat që lexojmë, programet që ndjekim, trashëgimia jonë përcaktojnë personalitetin tonë.

Nxënësit udhëzohen që të plotësojnë veprimtarinë 2.9. Këtë e plotësojnë me ndihmën e mësuesit/es. Disa nga nxënësit lexojnë atë që kanë shkruar.

**Hapi III**

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve një fletë punuese të cilën ata do ta plotësojnë së bashku.

| Puberteti | | | |
|---|---|---|---|
| Ndryshimet fizike | | Ndryshimet në sjellje | Ndryshimet mendore/emocionale |
| Djemtë | | | |
| Vajzat | | | |

| |
|---|
| Përgjigjet që jepen nga nxënësit dhe sqarimet nga mësuesi/ja sintetizohen dhe plotësohet tabela për secilën kolonë. Mësuesi/ja përgjigjet e tilla i shkruan në tabelë. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohet angazhimi në dhënien e përgjigjeve, saktësia e plotësimit të veprimtarisë 2.9 dhe angazhimi në plotësimin e fletës punuese. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Pyetjet 2 dhe 3, f. 47, Plotësimi në fletoren e punës, f. 20. Njësia: 2.11 Ndryshimet në trupin tim. Puberteti |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Bota e gjallë** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Përshkruan veprimet që duhet t'i bëjë për të mirëmbajtur dhe menaxhuar trupin e tij/saj. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, 8; V.1, 8; VI.2 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Kujdesem për veten | | | |
| **Fjalët kyçe:** kujdesem, higjienë, këshillohem. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- diskuton për termin higjienë;<br>- argumenton për rëndësinë e higjienës personale;<br>- krijon projekt për mënyrat e kujdesjes për veten.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Jep mendime në grup për temin higjienë.<br>- Argumenton gojarisht për rëndësinë e secilës pjesë përbërëse të higjienës personale.<br>- Krijon projekt për mënyrat e kujdesjes për veten, duke bashkëpunuar me grupin, sipas kërkesave të projektit. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, *Flip chart*, fletat A4, markera. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Nxënësit janë të organizuar në gjashtë grupe. Secilit grup i jepet një fletë A4, në të cilën është shkruar fjala *higjiena*. Nxënësit për 3-5 minuta duhet të diskutojnë dhe të shkruajnë çdo gjë që u bie ndër mend për higjienën. | | | |

Punën e përbashkët e lexon përfaqësuesi i grupit. Kështu veprohet nga secili grup.




**Hapi II**

Mësuesi/ja njofton nxënësit se tema e diskutimit do të jetë për higjienën dhe mënyrat e kujdesjes për veten.

Hapin librat në faqen 48. Leximi i njësisë do të behët në mënyrë individuale nga secili nxënës brenda grupit. Gjatë leximit, secili duhet të shënojë në libër me √ informacionet që i ka ditur më parë, me + informacionet e reja që i ka mësuar, dhe me ? gjërat që i ka të paqarta. Pas leximit, nxënësit për 2-3 minuta diskutojnë mes tyre, ku secili nga anëtarët e grupit tregon për vete se cilat gjëra të reja i ka mësuar dhe cilat i ka të paqarta. Brenda grupit, nxënësit i sqarojnë njëri-tjetrit gjërat e paqarta, në rast se ka diçka që brenda grupit nuk ka arritur kuptohet ajo i parashtrohet si çështje mësuesit/es. Kështu veprohet në secilin grup.

Mësuesi/ja jep informacionet sqaruese për çështjet që i kanë ngritur grupet e nxënësve.

Mësuesi/ja parashtron disa pyetje:

- *Kush bën pjesë në higjienën personale?*
- *Si dhe pse duhet pastruar duart?*
- *Si duhet pastruar dhëmbët? Pse?*
- *Pse duhet pastruar fytyrën, flokët?*

Nxënësit japin përgjigjet e tyre duke u bazuar në njohuritë e tyre dhe ato të nxëna nga njësia mësimore.

**Hapi III**

*Projekt.* Nxënësve, të ndarë në gjashtë grupe u jepet nga një fletë *Flip chart*. Do të realizojnë një mini-projekt prezantimi për mënyrën e kujdesjes ndaj vetes. Përmbajtja e projektit duhet të jetë:

*Këshilla për mbajtjen pastër të trupit tonë, ilustrime domethënëse - kreative për higjienën, pjesët përbërëse të higjienës personale. Secili grup në diskutim dhe bashkëpunim realizon projektin dhe e prezanton atë para grupeve të tjera.*

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet bashkëveprimi dhe diskutimi në grup, angazhimi në realizimin e projektit, mënyra e prezantimit, kreativiteti.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Pyetja 3, faqe 49, Veprimtaria 2.12a. Plotësimi në fletoren e punës, f. 21. Njësia: 2.12 Kujdesem për veten

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Proceset fizike</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Përkufizon masën, vëllimin dhe dendësinë dhe dallon trupat e ngurtë, lëndët e lëngëta dhe lëndët e gazta sipas vetive të tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.4, 8; III.4</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 5;  2.2</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Trupi, masa dhe vetitë e tyre</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: trup, lëndë, masë, vëllim, dendësi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- identifikon vetitë e trupave/lëndëve;<br>- analizon shndërrimin e gjendjeve agregate të ujit;<br>- kategorizon trupa/lëndë sipas gjendjes agregate.<br>Kriteret e suksesit:<br>Tregon për së paku tri veti të trupave/lëndëve që sheh dhe nga shembujt (veprimtaritë) e demonstruar në klasë.<br>Analizon saktësisht gjithë ciklin e shndërrimeve të ujit në gjendje të ndryshme agregate.<br>Shkruan në kategori 5 trupa/lëndë sipas gjendjes agregate.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti, fleta punuese, gotë qelqi, shishe qelqi me ujë, 2 balona, laps.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhë shqipe/Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><th colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Hapi I<br>Nxënësit nxiten që të vështrojnë trupat që gjinden përreth në klasë. Mësuesi/ja i pyet: - Çfarë po vështroni? Nxënësit japin mendimet e tyre rreth asaj që shohin, shpjegohet që çdo gjë/trup që zë vend në hapësirë quhet lëndë.<br>Pos lëndëve që janë vështruar brenda klasës, mësuesi/ja përpara nxënësve paraqet një shishe qelqi me ujë. Pyet nxënësit: A është edhe uji lëndë? Argumento pse? Pastaj ua shpjegon që sasia e hapësirës që uji si lëndë zë vend në shishe paraqet vëllimin e ujit, gjithashtu u shpjegon për peshën dhe dendësinë si veti të trupit. Pyet nxënësit:<br>- Çfarë ndodh me ujit kur vendoset në temperature të ftohtë (– gradë)? Në çfarë gjendje është ai?<br>- Çfarë ndodh me ujin kur nga gjendja e akullt vendoset në mjedis të ngrohtë (+ gradë)? Në çfarë gjendje shndërrohet?<br>- Çfarë ndodh me ujin nëse vendoset në temperaturë të lartë? Në çfarë gjendje shndërrohet?<br>Diskutimet rreth këtyre pyetjeve shoqërohen me komente plotësuese nga mësuesi/ja.<br>Hapi II<br>Nga shembujt e marrë, nxënësit njoftohen se do të mësohet më shumë për trupat dhe vetitë e tyre. Hapin librat në faqen 52. Lexohet njësia mësimore. Nxiten nxënësit që të analizojnë skemën e shndërrimit të ujit në tri gjendjet agregate. Mësuesi/ja parashtron pyetjet:</td></tr>
</table>

- *Çfarë është ngrirja? Më tregoni shembuj për ngrirjen.*
- *Çfarë është shkrirja? Më tregoni shembuj për shkrirjen.*
- *Çfarë është avullimi? Më tregoni shembuj për avullimin.*
- *Çfarë është kondensimi? Më tregoni shembuj për kondensimin.*

Përgjigjet e nxënësve plotësohen nga komente sqaruese nga mësuesi/ja.

Nga shishja e ujit që mësuesi/ja u ka prezantuar në fillim nxënësve, atë e derdh në një gotë qelqi. I udhëzon nxënësit që të shikojnë se çfarë po ndodh me formën e ujit. Konkludohet që ujit nuk ka formë, por atë e merr nga ena që ndodhet. Pyet nxënësit: po me trupat e ngurtë, ndodh kjo? Argumento pse.

Mësuesi/ja merr dy balona dhe një laps. Njërën balonë e fryn dhe e vendos në njërin skaj të lapsit, ndërsa balonën tjetër të pafryrë në skajin tjetër. Lapsin e vendos në qendër për të krijuar baraspeshë, në formën e një peshoreje. Lapsi do të anohet nga balona e fryrë. Konkludohet që ajri është lëndë, zë peshë në natyrë dhe është në gjendje agregate të gaztë.

**Hapi III**

Nxënësve u shpërndahet nga një fletë punuese ku do të shkruajnë 5 trupa/lëndë në tri gjendje agregate.

| E ngurtë | E gaztë | E lëngët |
|---|---|---|
| **1.**<br><br>**2.**<br><br>**3.**<br><br>**4.**<br><br>**5.** | | |

Nxënësit lexojnë tabelën e plotësuar.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet angazhimi në dhënien e përgjigjeve, analizimi i shembujve të demonstruar në klasë, saktësia e plotësimit të tabelës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Pyetje dhe detyra, faqe 53. Plotësimi në fletoren e punës, f. 22. Njësia: 3.1 Trupat, masa dhe vetitë e tyre

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Dallon lloje të ndryshme të rrugëve dhe të lëvizjeve të trupave. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1, 8; III.4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Lëvizja e trupave | | | |
| **Fjalët kyçe:** lëvizje e lakuar, drejtvizore, pingul, pikë referimi. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- identifikon llojet e lëvizjeve;<br>- klasifikon lëvizjeve të trupave të paraqitur në fotografi dhe në klasë;<br>- shkruan shembuj për llojet e lëvizjes.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>Identifikon dy llojet e lëvizjeve që paraqet mësuesi/ja në klasë dhe të rrugën shkollë-shtëpi.<br>Klasifikon në tri grupe llojet e lëvizjeve të paraqitura në foto dhe shembujt në klasë.<br>Shkruan së paku nga një shembull për secilin lloj të lëvizjes në tabelë. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, letra, nxënësit, shporta e letrave. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Mësuesi/ja fton dy nxënës që të dalin para klasës. Nxënësi i parë do të përshkojë një rrugë të drejtë nga tabela deri te banka e tij ku është ulur, ndërsa nxënësi i dytë do të kalojë një rrugë të lakuar, mes dy karrigesh të vendosura në rrugë, nga tabela deri te banka ku është ulur. Mësuesi/ja i nxit nxënësit vetëm të vështrojnë rrugën që ata kalojnë, pastaj i pyet: *Cili është dallimi mes rrugës që ka kaluar nxënësi I nga ai II?* Nxënësit japin mendimet e tyre, diskutohet rreth rrugës së drejtë dhe asaj të lakuar.<br>Nxënësit udhëzohen t`i mbyllin sytë dhe të përfytyrojnë rrugën që ata bëjnë nga shtëpia në shkollë. Disa nga nxënësit tregojnë për rrugën që kalojnë, duke e emëruar si rrugë të lakuar apo të drejtë.<br>**Hapi II**<br>Nxënësit njoftohen që do të mësojnë më shumë për lëvizjet e trupave. Hapin librat në faqen 54. Gjatë leximit, nxënësit udhëzohen të identifikojnë më + gjërat e reja që kanë mësuar.<br>Pas leximit, diskutohet njësia mësimore. Analizohet figura e rrugës së paraqitur në libër. Mësuesi/ja i pyet nxënësit: *Çfarë lloj lëvizjesh bëjnë makinat dhe njerëzit që kalojnë në rrugën që shihni në fotografi?* Shpjegohet që rruga e drejtë është emëruar si drejtvizore.<br>Analizohet figura e llojeve të lëvizjes që bën trupi/topi. Mësuesi/ja e rishpjegon që fotoja e parë tregon një lëvizje të lakuar të topit, fotoja e dytë është lëvizje drejtvizore e njëtrajtshme, sepse kryhet rrafsh me tokën dhe fotoja e tretë është lëvizje pingul më tokën, sepse është poshtë lart. Parashtron pyetjen: *A mund të më jepni disa shembuj të tjerë nga jeta e përditshme për secilin lloj të lëvizjes?* Nxënësit japin përgjigjet e tyre. | | | |

| |
|---|
| Mësuesi/ja merr një letër të cilën e ka mbledhur top dhe i fton nxënësit të shohin rrugën e lëvizjes që letra do të bëjë. Shpjegon që pika e fillimit të rrugës (nga vendi dhe dora e mësuesit/es) quhet pikënisja apo pika e referimit dhe pika e mbarimit (shporta e letrave). Pastaj pyet nxënësit: *Çfarë lëvizje/rruge kaloi topi i letrës?*<br>Me një top tjetër letre e ledh nga poshtë-lart dhe i pyet nxënësit të analizojnë çfarë lloj lëvizje bëri letra, si dhe identifikojnë pikën e referimit dhe pikën e mbarimit.<br>**Hapi III**<br>Nxënësit udhëzohen që të plotësojnë tabelën e dhënë në libër në faqen 55, Veprimtaria 3.2.<br>Pas plotësimit disa nga nxënësit e lexojnë punën e tyre. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohet angazhimi në dhënien e përgjigjeve, mënyra e analizimit të llojeve të lëvizjeve, plotësimi i tabelës në libër, kreativiteti në dhënien e shembujve për llojet e lëvizjeve. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Të vështrojnë në natyrë nga një trup që bëjnë lëvizje drejtvizore, të lakuar, pingule dhe të njëtrajtshme drejtvizore, të shkruajnë për to. Plotësimi në fletoren e punës, f. 23. Njësia: 3.2 Lëvizja e trupave |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Përshkruan mënyrat e krijimit të valëve dhe shembuj të paraqitjes së tyre në natyrë. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1, 3; II.6, 8; III.4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Valët dhe krijimi i tyre | | | |
| **Fjalët kyçe:** valë, valë e zërit, valë ujore, valë e detit, valët e dritës. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- dallon mënyrat e krijimit të valëve;<br>- analizon mënyrën e përhapjes së valëve zanore;<br>- shpjegon konceptin e valëve, valëve ujore dhe zanore.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>Dallon dy mënyrat e krijimit së valëve nga shembujt e marrë në klasë dhe libër.<br>Analizon gjithë procesin e përhapjes së valëve zanore nga shembulli i marrë në klasë.<br>Shpjegon saktësisht konceptin e valëve, valëve ujore dhe zanore sipas të informacioneve të mësuara. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletë pune, vizore, mjet i fortë metalik. | | | |

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**
Mësuesi/ja fton nxënësit që të duartrokasin të gjithë së bashku, pastaj u kërkon që të tregojnë se çfarë kanë dëgjuar. Nxënësit përgjigjen në lidhje mënyrat që ata kanë arritur t'i dëgjojnë. Pastaj merr një mjet të fortë (laps, vizore etj.) dhe e godet një pjesë metalike të tabelës apo bankës. Pyet nxënësit: *Çfarë dëgjoni tani? Çfarë dallimi ka mes zërit që dëgjuat më parë me këtë tani?*
Nxënësit japin mendimet e tyre. Mësuesi/ja pyet nxënësit: *Keni qenë kureshtarë ndonjëherë për të ditur se si arrijmë të dëgjojmë zërat?* Ai/ajo shpjegon se zëri përhapet përmes valëve për të cilat do të mësojnë më shumë, dhe i fton nxënësit t'i hapin librat te njësia "Valët dhe krijimi i tyre".

**Hapi II**
Lexohet paragrafi i parë nga një nga nxënësit, mësuesi/ja pyet për format si krijohen valët, nxënësit japin komentet e tyre duke u bazuar nga informacionet në libër. Ofrohen sqarime shtesë nga mësuesi/ja; me këtë rast merr shembullin e barkës apo anijes për të shpjeguar si valët përhapën kur preket sipërfaqja e ujit dhe shembullin kur hedhin gurë në ujë. Bëhet dallimi mes valëve. Mësuesi/ja u sqaron nxënësve që pos valëve të ujit, në të njëjtën formë përhapen edhe valët e zërit në ajër. Kur dëgjojmë ndonjë zë siç ishte rasti nga shembulli në fillim të orës me duartrokitje apo goditje e metalit, valë përhapen në ajër dhe kështu arrijnë deri te veshi ynë. Pra, u shpjegon që ka edhe valë zanore. Lexohet paragrafi i dytë nga një nga nxënësit. Dikush nga nxënësit përsërit se çfarë janë valët zanore dhe si vijnë ato deri veshi ynë.
Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të marrin një vizore plastike dhe atë ta përplasin për bankë. Analizojnë si u përhap zëri dhe si ka arrin te veshi ynë.
Diskutohet edhe për formën tjetër të përhapjes së valëve atë të rrezeve të diellit.
Lexohet dhe diskutohet për fenomenin e jehonës. Mësuesi/ja pyet nxënësit të tregojnë raste nga jeta e përditshme kur ju ka ndodhur të dëgjojnë jehonën e zërit.

**Hapi III**
Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve nga një fletë punuese ku do të plotësojnë për valët, valët ujore dhe valët zanore.

| Koncepti | Shpjegimi |
|---|---|
| Valë | |
| Valët ujore | |
| Valët zanore | |

Disa nga nxënësit e lexojnë përgjigjet e tyre të shkruara.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet angazhimi në dhënien e përgjigjeve në pyetjet e parashtruara nga mësuesi/ja, saktësia e plotësimit të tabelës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Plotësimi në fletoren e punës, f. 24. Njësia: 3.3 Valët dhe krijimi i tyre

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Shpjegon shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1, 3; II.6, 8; III.4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5 | | | |

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës

**Fjalët kyçe:** shndërrim i kthyeshëm, shndërrim i pakthyeshëm.

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- jep mendim për shembujt e paraqitur në klasë për shndërrimet e lëndëve.
- arsyeton shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndëve;
- shkruan shembuj të lëndëve të kthyeshme dhe të pakthyeshme.

**Kriteret e suksesit:**
Jep së paku një mendim për shembujt e paraqitur nga mësuesi/ja në klasë.
Arsyeton të gjitha rastet e shndërrimeve të lëndëve në të kthyeshme dhe të pakthyeshme sipas fotografive të paraqitura.
Liston pesë shembuj të lëndëve të kthyeshme dhe të pakthyeshme në tabelë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, tabela, fije shkrepëse, projektori, fotografitë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Hapi I**
Mësuesi/ja paraqet një situatë para nxënësve: Paramendoni sikur jemi në stinën e verës dhe sapo keni blerë një akullore. *Çfarë do të ndodh me akulloren, nëse e lëmë për disa minuta në temperaturën e ngrohtë të ambientit që ndodhet?* Nxënësit japin mendimet e tyre. Pastaj mësuesi/ja i pyet prapë: *Po nëse akulloren që është pothuajse e shkrirë e fusim prapë në frigorifer, çfarë ndodh?*
Mësuesi/ja shpjegon që nga një gjendje (e ngurtë) akullorja po e shndërrohet në gjendjen e lëngët e pastaj prapë në gjendje të ngurtë. Pra, kemi të bëjmë me shndërrim të gjendjes. Nga kjo nxënësit njoftohen se do të mësojnë më shumë për shndërrimet e lëndëve në njëra-tjetrën.

**Hapi II**
Nxënësit hapin librat në faqen 58 dhe lexohet paragrafi i parë nga teksti. Shpjegohet nga mësuesi/ja shembulli i ujit dhe shndërrimit të tij nga gjendja e akullt në ujë dhe anasjelltas. Shpjegohet që në këtë rast kemi të bëjmë me shndërrim të kthyeshëm.
Pastaj mësuesi/ja i fton nxënësit të shikojnë një shembull demonstrues. Merr një fije shkrepëseje dhe e ndez. Pasi ajo të digjet, i pyet nxënësit: *A mund të kthehet në gjendjen e mëparshme fija e shkrepëses?* Nxënësit japin përgjigje. Shpjegohet që disa shndërrime të lëndëve janë të pakthyeshme. Lexohet paragrafi i dytë për informacione të tjera për shndërrimet e pakthyeshme. Diskutohen së bashku me nxënësit fotoja e hekurit, arsyetohet pse është shndërrim i kthyeshëm.

Diskutohet edhe fotoja e ndryshkjes së hekurit dhe arsyetohet pse është shndërrim i pakthyeshëm. Mësuesi/ja përmes projektorit paraqet disa fotografi të tjera dhe i fton nxënësit të mendojnë dhe arsyetojnë se çfarë shndërrimesh ndodhin.






Mësuesi/ja pyet nxënësit për fotot e prezantuara me radhë: *Çfarë shndërrimi ndodh me vezën në fotografi? Argumento pse? Çfarë shndërrimi paraqet mprehja e lapsit në fotografi? Argumento pse. Çfarë shndërrimi paraqet palosja e letrës në fotografi? Argumento pse. Çfarë shndërrimi paraqet balona në fotografi? Argumento pse.*
Nxënësit japin mendimet dhe argumentet e tyre.

**Hapi III**

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë tabelën, Veprimtarinë 3.4. Disa nga nxënësit lexojnë përgjigjet e tyre pasi të kenë përfunduar.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet angazhimi në argumentimin rreth shembujve të paraqitur në klasë, dallimi i dy llojeve të shndërrimeve të lëndëve, argumentimi i fotografive, saktësia e plotësimit të tabelës. Plotësimi i fletores së punës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Veprimtari: Merr një gotë lëng portokalli, vendose atë në një enë plastike, fute në frigorifer për ngrirje, pastaj ngritjes vendose në temperaturë dhome. Përshkruaj procesin dhe llojin e shndërrimit të lëndës. Plotësimi në fletoren e punës, f. 25. Njësia: 3.4 Shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Shpjegon shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1, 4, 8; III.2, 4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 5; 2.4, 5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Punë praktike: Lëndët dhe vetitë e tyre | | | |
| **Fjalët kyçe:** shndërrim i kthyeshëm, shndërrim i pakthyeshëm. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- shpjegon shndërrimet e kthyeshme dhe të pakthyeshme të lëndës; | | | |

- analizon këto shndërrime;
- eksperimenton shndërrimet e lëndës.

**Kriteret e suksesit:**
Shpjegon së paku dy shndërrime të kthyeshme dhe dy të pakthyeshme të lëndës.
Analizon së paku dy shndërrime të lëndës.
Eksperimenton së paku dy shndërrime të lëndës.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** sheqer, llambë alkooli, tigan hekuri, lugë enë me kapak, shkrepëse, ujë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**
Orë praktike: Mësuesi/ja fillon eksperimentin në klasë (në qoftë se nuk ka mundësi, ta zhvillojë eksperimentin në klasë, atëherë e incizon dhe iu lëshon nxënësve në video përmes projektorit).
Në një tigan, hedh një lugë sheqer dhe vendosë në zjarr. Sheqeri fillon të shkrijë e të marrë ngjyrë të errët. E largon nga zjarri dhe iu jep nxënësve ta provojnë shijen e tij pasi është ftohur.

**Hapi II**
Pastaj ju bën pyetje: *A ju ngjason me karamelen*? Pra, shija ndryshon, por dhe pamja ka ndryshuar. Tani kemi një lëndë tjetër, të ndryshme nga e para. *Pyet nxënësit se a mund të kthehet tani karamelja në gjendjen e sheqerit fillestar, me kokrra të bardha. • Çfarë ka ndodhur me sheqerin? • Çfarë lloj shndërrimi është ky?*
Gjetjet e sakta të nxënësve nga eksperimenti i shkruan në tabelë.
Vazhdon me eksperimentin e dytë.
Në një llambë alkooli të ndezur, mësuesi/ja vendosë një enë me ujë. Enën mbulon me kapak dhe pret derisa uji të fillojë të ziejë. Pas vlimit të ujit, largon kapakun nga ena.
Pyet nxënësit: *Çfarë vini re?* Në momentin që largon kapakun, prapë pyet nxënësit *Çfarë vini re?*
Gjetjet e sakta të nxënësve i shkruan në tabelë.

**Hapi III**
Bëjnë përmbledhjen e gjetjeve duke përforcuar ato që mësuan, si dhe nxit nxënësit të japin sa më shumë shembuj të ngjashëm nga jeta e përditshme.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit do të vlerësohen në bazë të përgjigjeve të sakta që do të japin rreth eksperimenteve.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyrë shtëpie do të përsërisin eksperimente të njëjta apo të ngjashme në shtëpi, si dhe do të mbajnë shënime rreth gjetjeve nga eksperimentet.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceseset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Demonstron pluskimin, zhytjen dhe fundosjen e trupave në ujë duke u bazuar në dendësi dhe sipërfaqe të tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.8; III.2 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Zhytja, pluskimi dhe fundosja e trupave në ujë | | | |
| **Fjalët kyçe:** zhytje, pluskim, fundosje, notim, lëng | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- shpjegon pluskimin, zhytjen dhe fundosjen e trupave në ujë;<br>- demonstron pluskimin, zhytjen dhe fundosjen e trupave në ujë.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Shpjegon së paku nga një shembull të pluskimit, zhytjes dhe fundosjes së trupave në ujë.<br>- Demonstron me anë të vizatimit së paku nga një shembull të pluskimit, zhytjes dhe fundosjes së trupave në ujë, duke u bazuar në dendësinë dhe sipërfaqen e tyre. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Gotë, ujë, mprehëse metalike, letër, fleta A4. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Mësuesi/ja orën e fillon me një eksperiment ku i nxit nxënësit të mendojnë.<br>Merr një gotë të mbushur me ujë e hedh brenda një mprehëse metalike. Pastaj merr një letër e hedh edhe atë në ujë. Merr mendime nga nxënësit se pse ndodh kjo gjë.<br>Pastaj bënë përmbledhjen e mendimeve të nxënësve, duke shkruar në tabelë:<br>Kur një trup pluskon mbi sipërfaqen e ujit, themi se dendësia e tij është më e vogël se dendësia e lëngut mbi të cilin pluskon. Kur dendësia e trupit është më e madhe se dendësia e lëngut, atëherë trupi zhytet si në rastin e mprehëses së metaltë.<br><br>**Hapi II**<br>I udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të lexojnë për 5 minuta njësinë në faqen 61.<br>Pastaj, ndahen në 3 grupe. Grupi i parë: *Pse një trup noton në ujë?* Grupi i dytë: *Pse një trup pluskon në ujë?* dhe Grupi i tretë: *Pse një trup fundoset në ujë?*<br>Përgjigjet e tyre duhet t'i arsyetojnë edhe me vizatime.<br><br>**Hapi III**<br>Një anëtar nga secili grup bënë prezantimin e gjetjeve, ndërsa nxënësit e tjerë kanë të drejtë t'ju bëjnë pyetje lidhur me atë që shpjegojnë. | | | |

| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
|---|
| Vlerësohen nxënësit që prezantojnë më mirë, si edhe ata që janë aktorë në pyetje dhe përgjigje brenda orës mësimore. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyrë e pavarur do të jetë Veprimtaria 3.6. Detyrë shtëpie "Pyetje dhe detyra", f. 62. Përgjigjet duhet t'i shkruajnë në fletore.<br>Plotësimi në fletoren e punës, f. 26. Njësia: 3.6 Pluskimi, zhytja dhe fundosja e trupave në ujë |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Demonstron paraqitjen e forcës shtytëse në trupin e zhytur në lëng. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.8; III.2 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Eksperiment: Forca shtytëse e trupit të zhytur në lëng | | | |
| **Fjalët kyçe:** zhytje, pluskim, fundosje, notim, lëng. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- demonstron paraqitjen e forcës shtytëse në trupin e zhytur në ujë;<br>- argumenton eksperimentin e bërë.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- demonstron paraqitjen e forcës shtytëse në një trupi të zhytur në ujë.<br>- argumenton njërin eksperiment të bërë. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** enë me ujë, gomë, laps, fletë, peshore, top pingpongu. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Punë praktike: Mësuesi/ja ka përgatitur dy eksperimente për këtë orë.<br>Në fillim, mbush enën përbuzë me ujë dhe nën të vendos një enë tjetër më të madhe se sipërfaqja e enës së mbushur. Në enë vendos fillimisht një letër.<br>Pyet nxënësit: *Çfarë mendoni që do të ndodhë*? Merr përgjigjet e nxënësve.<br>Përgjigjet e sakta i shkruan në tabelë. Më pas, mbi enën e mbushur përbuzë me ujë hedhë një gomë. Prapë pyet nxënësit: *Çfarë mendoni se do të ndodhë*? Përgjigjet e sakta i shkruan përsëri në tabelë. | | | |

| |
|---|
| *Si mendoni? Si do të jetë sasia e ujit që do të derdhet në krahasim me masën e gomës? E peshoni atë.*<br>Dhe në tekst, f. 62, nxënësit shkruajnë përgjigjet rreth eksperimentit të parë.<br>**Hapi II**<br>Vendos në një enë me ujë një top pingpongu.<br>*Pyet nxënësit se çka do të ndodhë me topin*? Topi nuk do të fundoset në fund të enës. Provon të shty me gisht topin e pingpongut për ta fundosur. Çfarë do të ndodhë? Topi i pingpongut do të dalë sërish mbi sipërfaqe, sepse forca shtytëse e ujit është më e madhe se forca e rëndesës së topit të pingpongut.<br>**Hapi III**<br>Nxënësit do të argumentojnë për eksperimentet e bëra. Në fund duhet të vinë te konkluzioni se: *Pluskimi i një trupi varet nga forma dhe dendësia e tij.* |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësimi nxënësve bëhet sistematikisht, pavarësisht prej angazhimit të tyre në orën mësimore. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Demonstron shembuj të paraqitjes së shtypjes atmosferike dhe peshës së ajrit. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.8; III.2 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Shtypja atmosferike dhe pesha e ajrit | | | |
| **Fjalët kyçe:** atmosferë, shtypje, barometër, ngrohja e ajrit. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- përsërit njohuritë paraprake për ajrin;<br>- jep shembuj të ndryshëm për shtypjen e ajrit;<br>- argumenton eksperimentin e bërë.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- përsërit njohuritë për ajrin nga njësia e mësuar më herët.<br>- jep së paku tre shembuj konkret lidhur me shtypjen e ajrit.<br>- argumenton nëpër faza eksperimentin e bërë në klasë. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Foto e barometrit, zhivës, gotë me ujë letër apo karton. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Mësuesi/ja iu rikujton nxënësve njësinë mësimore **Përbërësit e ajrit**; nxënësit përgjigjen në atë se çka kanë mbajtur mend. Ai/jo përdorur pyetje si; *Për çka na duhet ajri? Ku gjendet ajri? A shihet me sy? A ka formë? A ka shije? A ka peshë? Cilët janë përbërësit kryesor të ajrit? Etj.*

Përgjigjet e sakta të nxënësve i shkruan në tabelë në formë Kllasteri.




**Hapi II**

Mësuesi/ja ju shpjegon nxënësve se ajri është i padukshëm, ai përbëhet nga molekula gazesh dhe ka peshën e vet. Kur dëgjoni në TV për motin se si do të jetë moti nesër, duhet të keni dëgjuar edhe për shtypjen e ajrit, lëvizjen e ajrit. Në saje të peshës së ajrit, atmosfera ushtron shtypje (trysni) mbi të gjitha sendet dhe gjallesat. Kjo shtypje (dukuri) quhet trysni apo shtypje atmosferike. Arsyeja që ne nuk e ndiejmë këtë trysni, është se ajo ushtrohet njëkohësisht në të gjitha drejtimet. Trysnia atmosferike matet me një pajisje që quhet barometër. Ndërkohë paraqet foton e barometrit që është në libër 3.8.1. Barometrin e parë e shpiku fizikani italian Evanxhelista Torriçeli. Ai ishte i pari që mati trysninë atmosferike. Në një enë të mbushur me zhivë, ai vendosi një tub qelqi të mbyllur me kapak. Për shkak të trysnisë së ajrit, zhiva u ngjit lart. Kështu, vërtetoi se ajri ka peshë dhe, në të njëjtën kohë, ndërtoi edhe barometrin e parë.

Pastaj pyet nxënësit se kush mund të tregoj raste se kur e kanë ndier presionin apo shtypjen e ajrit. Nxit nxënësit që të japin sa më shumë shembuj konkret nga jeta e përditshme.

**Hapi III**

Kalohet te Veprimtaria 3.8. Mësuesi/ja bënë eksperimentin me gotë.

Merr një gotë dhe mbushë plot me ujë. E mbulon atë me një letër ose karton. Duke e mbajtur mirë letrën ose kartonin të puthitur me gotën, e kthen atë përmbys. Largon dorën nga letra. Pyet nxënësit: *Çfarë mendoni se do të ndodhë?*

Nxënësit duhet të argumentojnë eksperimentin.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet angazhimi sistematik i nxënësve në orën mësimore. Vlerësohen më mirë ata/ato nxënës/e që argumentojnë eksperimentin si duhet.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësit do të bëjnë një eksperiment (hulumtojnë) ku të tregojnë shtypjen e ajrit, si dhe “Pyetje dhe detyra”, f. 65.

Plotësimi në fletoren e punës, f. 27. Njësia: 3.8 Shtypja atmosferike dhe forca e ajrit

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

<table>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Proceset fizike</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br><br>Dallon burimet e energjisë së pastër nga burimet që e ndotin mjedisin.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, 6, 8</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.5, 6</td></tr>
<tr><td colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Burimet e energjisë</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: burim, energji e pastër, ndotje</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br><br>Nxënësi/ja:<br>- jep shembuj të burimeve të energjisë;<br>- shpjegon/ilustron burimet e energjisë;<br>- prezanton burimet e energjisë.<br>Kriteret e suksesit:<br>- Jep së paku nga dy shembuj për burimet e përtëritshme dhe jo të përtëritshme të energjisë.<br>- Shpjegon/ilustron se paku nga dy shembuj të burimeve të energjisë.<br>- Prezanton së paku një burim të energjisë, rëndësinë dhe funksionin e saj në jetën e përditshme.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: laptop, projektor, foto, fletë A4.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</td></tr>
<tr><td colspan="4">Hapi I<br>Mësuesi/ja shkruan në tabelë (ose hap në projektor foto të diellit, ujit dhe ajrit):<br><br>DIELLI UJI AJRI = burime të ripërtëritshme<br>Pyet nxënësit: A mund të jetojmë pa këto tri elemente? Përgjigjet e nxënësve kërkon t'i argumentojnë.<br>Pastaj shkruan sërish:<br><br>QYMYRI NAFTA BENZINA DHE GAZI NATYROR = burime të jo të ripërtëritshme.<br><br>Pyet nxënësit: Çfarë dini për këto burime? Çka na duhen? Ku gjenden? A shpenzohen apo janë të përhershme?<br><br>Hapi II<br>Pasi teston njohuritë e nxënësve me pyetjet sipër, i udhëzon të hapin librat dhe të lexojnë tekstin në f. 68, 69.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| Nxënësit i ndan në tri grupe, pasi të kenë lexuar për 5-7 min. Grupi i parë shkruan dhe vizaton burimet e ripërtëritshme, grupi i dytë burimet jo të ripërtëritshme dhe grupi i tretë do të shkruan për burimet e energjisë që e ndotin ajrin.<br>**Hapi III:**<br>Nxënësit prezantojnë me grupe, si dhe shfaqin vizatime rreth gjetjeve që prezantojnë. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Nxënësit vlerësohen gjatë prezantimit të gjetjeve. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyrë shtëpie do ta punojnë Veprimtarinë 3.9, të shkruajnë “Pyetjet dhe detyrat”.<br>Ta shohin videon për burimet e pashtershme dhe të shtershme të energjisë. Të mbajnë shënime për videon, që orën e ardhshme të diskutojnë së bashku. (linku: *Types of Energy for Kids - Renewable and Non-Renewable Energies - Bing video)*<br>Plotësimi i fletores së punës f. 28. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Proceset fizike</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Shqyrton shembuj të avullimit, valimit dhe lëngëzimit të ujit në vartësi të temperaturës.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.6, 8</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5; II.1, 2, 4, 5</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Avullimi, vlimi dhe lëngëzimi i ujit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: avullim, lëngëzim, vlim, bulëza, flluska, temperaturë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- shqyrton shembuj të qarkullimit të ujit në natyrë;<br>- jep shembuj nga jeta e përditshme rreth qarkullimit të ujit në natyrë;<br>- demonstron me shembuj qarkullimin e ujit në natyrë<br>Kriteret e suksesit:<br>- Shqyrton së paku dy shembuj të qarkullimit të ujit në natyrë.<br>- Jep së paku dy shembuj konkret se si bëhet qarkullimi i ujit në natyrë.<br>- Demonstron me anë të eksperimentit me ujin e vluar (në tenxhere) qarkullimin e ujit në natyrë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë hameri, tenxhere, ujë.</td></tr>
</table>

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**
Mësuesi/ja paraqet para nxënësve një pamje të qarkullimit të ujit në natyrë. I udhëzon nxënësit të shikojnë për 2 minuta. I pyet se çfarë po shikojnë. Merr përgjigjet e nxënësve.




**Hapi II**
I udhëzon të hapin librat dhe të lexojnë për 5 minuta te faqja 70.
Pasi të kenë lexuar pjesën dhe të kenë shtuar njohuritë lidhur me qarkullimin e ujit në natyrë, mësuesi/ja i udhëzon të dalin dhe të komentojnë para fotos, të thonë atë që se kishin përmendur, para se të lexonin pjesën.
Mësuesi/ja bënë pyetje që nxënësit të japin shembuj praktik rreth qarkullimit të ujit në natyrë.
**Hapi III**
I udhëzon të shikojnë Veprimtarinë 3.11 dhe të plotësojnë atë që kërkohet aty.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit vlerësohen me detyrën **Kontrolloni përparimin tuaj**, f. 72, 73.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyrë shtëpie do të bëjnë eksperimentin me tenxhere dhe ujë të valuar, si dhe pyetjet dhe detyrat f. 71.
Plotësimi i fletores së punës, f. 29

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Shpjegon elektricitetin atmosferik dhe mbrojtjen prej tij. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1 6, 8 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6; 2.6 | | | |

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Elektriciteti atmosferik

**Fjalët kyçe:** elektricitet, ngarkesë elektrike pozitive, ngarkesë elektrike negative, elektrizim, rrufe, vetëtimë, bubullimë, rrufepritës.

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- diskuton rreth njohurive paraprake;
- demonstron elektricitetin;
- nxjerr konkluzione për elektricitetin.

**Kriteret e suksesit:**
- Diskuton rreth njohurive paraprake për elektricitetin.
- Demonstron elektricitetin me vizore dhe grimca letre.
- Nxjerr konkluzione se si veprojnë trupat e elektrizuar.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shufër plastike, një copë rrobë të leshtë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**
Mësuesi/ja hap orën duke diskutuar me nxënësit: Ju ka ndodhur ndonjëherë që kur zhvishni ndonjë bluzë shpejt e që ka përbërje leshi, flokët të elektrizohen? Apo kur fërkohemi më njëri-tjetrin të na duket se rryma na përçon trupin?
Nxënësit diskutojnë të lirë, duke marrë sa më shumë shembuj për elektricitetin…
Atëherë, mësuesi/ja shkruan në tabelë:
**Elektriciteti gjendet në trupa të ndryshëm. Këta trupa përbëhen nga grimca të vogla, të cilat kanë ngarkesa elektrike.**
**Ngarkesat janë dy llojesh: pozitive dhe negative.**

**Hapi II**
Udhëzohen nxënësit të demonstrojnë shembullin në libër 3.12a. Marrin një vizore plastike, grimcojnë ca letër mbi bankë. Vizoren e fërkojnë shumë për një copë materiali prej leshi, po mund ta fërkojnë edhe në kokën e tyre. E shohin se grimcat e vogla të letrës do të ngjitën për vizore.

**Hapi III**
Hapin librat lexojnë dhe e shohin Veprimtarinë 3.12b.
Konkluzionin nga këto veprimtari e nxjerrim nga nxënësit, pastaj e shkruajmë në tabelë.
**Trupat e elektrizuar e tërheqin ose e shtyjnë njëri-tjetrin. Kur dy trupa janë me ngarkesë të njëjtë, ata shtyhen; ndërsa kur janë me ngarkesë të ndryshme, tërhiqen.**

| |
|---|
| Nxënësit vazhdojnë dhe e lexojnë tekstin f. 75.<br>Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët:<br>- **Rrufe –**<br>- **Vetëtimë –**<br>- **Bubullimë –**<br>- **Rrufepritës –**<br><br>Pastaj diskutojnë rreth asaj që e lexuan, mësuesi/ja plotëson shprehjet në tabelë me përgjigjet e nxënësve. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësim i vazhdueshëm. Vlerësohen nxënësit që japin përgjigjet sa më të plota rreth fjalëve të shkruara në tabelë. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyrë shtëpie “Pyetjet dhe detyrat”, f. 75. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Ndërton qarkun e thjeshtë elektrik, ilustron skemën e tij dhe përshkruan rolin e çdo pjese përbërëse. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.6, 8 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.3 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Qarku elektrik. Ndërtimi i tij | | | |
| **Fjalët kyçe:** qark elektrik, bateri, tela përçues | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- ndërton qarkun elektrik;<br>- ilustron qarkun elektrik;<br>- përshkruan rolin e çdo pjese përbërëse të tij.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Ndërton qarkun elektrik (punë në grup) në klasë.<br>- Ilustron çdo pjesë se si duket qarku elektrik.<br>- Përshkruan rolin e secilës pjesë të qarkut elektrik. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Bateri, dy tela përçues të veshur, llambë e vendosur në një mbajtëse, çelës, shirit ngjitës. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| **Hapi I**<br>Mësuesi/ja bënë përsëritje nga njësia e kaluar, lidhur me elektricitetin, iu bën pyetje nxënësve për të ardhur te qëllimi i orës.<br>**Rryma elektrike është rrjedha e elektricitetit në një drejtim të caktuar. Gjatë përdorimit të saj gjithmonë formohet një qark elektrik. Në qark, rryma elektrike rrjedh nga poli pozitiv në polin negativ.**<br>**Hapi II**<br>Mësuesi/ja paraprakisht kishte njoftuar nxënësit (të ndarë në 3 grupe) që të sjellin në klasë një bateri, dy tela përçues të veshur, një llambë e vendosur në një mbajtëse, çelës.<br>Së pari, vet demonstron se si krijohet një qark elektrik, mandej i udhëzon nxënësit të punojnë në grupe, secili grup duhet të punoj një qark elektrik.<br>**Hapi III**<br>Grupet e nxënësve prezantojnë punën e tyre me radhë. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohen nxënësit që prezantuan qarkun elektrik. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyrë shtëpie, “Pyetje dhe detyra” në f. 73.<br>Plotësimi i fletores së punës f. 30. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Dallon përcjellësit dhe veçuesit elektrik me ndihmën e qarkut elektrik. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1, 6, 8 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Përcjellësit dhe veçuesit elektrikë | | | |
| **Fjalët kyçe:** përcjellës elektrik, veçues elektrik, metal, plastikë, hidrocentral, qarku elektrik që ndërtuat, kapëse letra prej alumini, gozhdë, copë tel prej çeliku. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- liston të dhënat që ka për energjinë elektrike;<br>- dallon përcjellësit dhe veçuesit elektrikë më ndihmën e qarkut elektrik;<br>- përshkruan përcjellësit dhe veçuesit elektrikë. | | | |

**Kriteret e suksesit:**
- Liston së paku tri të dhëna që ka për energjinë elektrike.
- Dallon përcjellësit dhe veçuesit elektrikë me ndihmën e qarkut elektrik.
- Përshkruan së paku nga tre përcjellës dhe veçues elektrikë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Qarku elektrik që ndërtuan orën e fundit, kapëse letra prej alumini, gozhdë, copë tel prej çeliku.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**
Mësuesi/ja orën e fillon duke pyetur nxënësit sa kanë njohuri për energjinë elektrike. *Pse na shërben energjia elektrike? A keni parë ndonjëherë duke u instaluar nëpër shtëpi apo në ndonjë vend tjetër? Si përcillet energjia elektrike deri në shtëpitë tona?* etj.
Nxënësit listojnë njohuritë që kanë për energjinë elektrike.

**Hapi II**
I udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të lexojnë tekstin në f. 74, 75.
Pasi të kenë marrë njohuritë e reja lidhur me përcjellësit dhe veçuesit elektrikë, i diskutojnë bashkë në klasë, nxisim sa më shumë pyetje-përgjigje mes nxënësve.
Pastaj orën e vazhdon me veprimtarinë 3.14a dhe 3.14 b. Me qarkun elektrik që kanë punuar në orën e mëparshme, tani do të shohin se si përcillet elektriciteti përmes kapëses së letrave.
Nxënësit do të demonstrojnë para shokëve eksperimentin e bërë.

**Hapi III**
Bëhet përmbledhja e orës përmes figurave të paraqitura. Nxënësit do të shkruajnë te rrethi i parë trupat përcjellës të elektricitetit, ndërsa te rrethi i dytë trupat jopërcjellës të elektricitetit.




**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit vlerësohen përgjatë punës me qarkun elektrik, si dhe për ushtrimin e fundit.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyrë shtëpie "Pyetje dhe detyra" në f. 75.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Identifikon pajisjet e përditshme në shtëpi që punojnë me rrymë, qarkun e shkurtër dhe rrezikun nga rryma elektrike. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës**: II.1, 2, 6, 7, 8 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.3, 4 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Punë praktike: Lëndët e tjera që përcjellin elektricitetin | | | |
| **Fjalët kyçe:** tretësirë e kripës, ujë i pastër. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- diskuton për njohuritë paraprake;<br>- analizon eksperimentet e bëra;<br>- nxjerr konkluzione prej eksperimenteve të bëra**.**<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Diskuton për përçuesit dhe jopërçuesit elektrikë.<br>- Analizon eksperimentet e bëra në klasë nga mësuesi/ja.<br>- Nxjerr konkluzione nga këto eksperimente. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** një enë me ujë të pastër prej qelqi, tela përcjellës 15-20 cm të gjatë, një bateri, llambë e vogël me mbajtëse. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Mësuesi/ja paraprakisht ka njoftuar nxënësit që këtë orë do të kenë veç punë praktike. Së pari, bëjnë përsëritjen nga njësia e fundit, duke pyetur nxënësit për përçuesit dhe jopërçuesit e energjisë elektrike. **Mandej iu shpjegon se përcjellës dhe veçues të elektricitetit nuk janë vetëm trupat e ngurtë, por edhe lëngjet.**<br>**Hapi II**<br>Mësuesi/ja bënë eksperimentin sikurse në veprimtarinë 3.15a dhe 3.15b.<br>Nxënësit e përcjellin me vëmendje dhe do të mbajnë shënime gjatë punës së mësuesit/es.<br>**Hapi III**<br>Nxjerrin konkluzionet nga vëzhgimi i eksperimenteve të bëra.<br>***Uji i papastër është përcjellës i elektricitetit*** | | | |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** | | | |
| Nxënësit vlerësohen sipas konkluzioneve të nxjerra nga eksperimentet e vëzhguara. | | | |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** | | | |
| Pyetjet dhe detyrat, f. 77. | | | |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** | | | |
| | | | |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>Shkencat e natyrës | **Lënda:**<br>Njeriu dhe natyra | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>IV |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Identifikon pajisjet e përditshme në shtëpi që punojnë me rrymë, qarkun e shkurtër dhe rrezikun nga rryma elektrike. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2, 4; II.6 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.3 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Përdorimi dhe mbrojtja nga elektriciteti | | | |
| **Fjalët kyçe:** rrezik, goditje elektrike, spinë, prizë. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- identifikon nevojat dhe rreziqet nga elektriciteti;<br>- analizon nevojat dhe rreziqet nga elektriciteti.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Identifikon së paku tri nevoja dhe tri rreziqe nga energjia elektrike.<br>- Analizon nevojat dhe rreziqet e energjisë elektrike përmes një ese-je. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** laptop, projektor, fletë A4. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Mësuesi/ja iu rikujton nxënësve njohuritë që kishin marrë në njësitë e mëparshme, lidhur me elektricitetin, rëndësinë e rrymës elektrike si dhe rreziqet nga ajo. I nxit nxënësit që të marrin pjesë në bisedë.<br>**Hapi II**<br>Pastaj hap projektorin dhe lëshon videon që është në linkun e mëposhtëm:<br>Rreziku nga elektriciteti dhe masat mbrojtese Art Uka dhe Penda Halimi IX6 Prof Kimete Dida - Bing video<br>Nxënësit duhet të përcjellin me vëmendje, sepse do të shkruajnë një ese për videon e parë (n.q.s. ka nevojë e lëshon videon dy herë).<br>**Hapi III**<br>Nxënësve iu shpërndahen nga një fletë A4 ku do të shkruajnë një ese për videon që e kanë parë. Ese-në e titullojnë ata vet.<br>Fokusi i esesë do të jetë rëndësia e rrymës elektrike, si dhe rreziqet e saj.<br>Mësuesi/ja merr esetë, i kontrollon dhe i sjellë orën e ardhshme. | | | |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** | | | |
| Vlerësohet eseja, punë individuale e nxënësve. | | | |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** | | | |
| "Pyetjet dhe detyra", f. 79. | | | |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** | | | |
| | | | |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Shpjegon me demonstrim veprimin magnetik të magnetit në mjedise dhe dallon lëndët që magnetizohen nga ato që nuk magnetizohen. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1, 6, 7, 8 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.3, 4 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Ç'janë magnetet? | | | |
| **Fjalët kyçe:** magnet shufër, magnet patkua, tërheq, poli i veriut dhe poli i jugut. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- shkruan njohuritë që ka për magnetet;<br>- tregon ato që do të di për magnetet;<br>- nxjerr konkluzione për njohuritë e marra.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Shkruan së paku tri njohuri që ka për magnetet.<br>- Tregon së paku dy gjëra që do të di për magnetet.<br>- Nxjerr konkluzione për dy eksperimentet e bëra në klasë me magnete. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** magnete. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm | | | |

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Hapi I**

Mësuesi/ja mbanë dy magnete në dorë dhe i pyet nxënësit: *A e dini ç'janë këto? Ku i përdorim?* Njohuritë që kanë për magnetet i shkruan në rubrikën **Di**.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

Mandej i pyet prapë se çka duan të dinë më shumë për magnetet. Ato pyetje i shkruan te rubrika **Dua të di**. Pastaj i udhëzon të hapin librat dhe të lexojnë njësinë mësimore f. 84.

**Hapi II**

Pasi të kenë lexuar, plotësojnë edhe rubrikën *Mësova* në tabelën e vizatuar.

**Hapi III**

Zhvillohet veprimtaria 3.17 me magnetet e sjella në klasë. Këtë eksperiment e provojnë nxënësit me radhë.

Në fund diskutohet ajo që u pa në eksperiment dhe nxirret konfuzioni nga ky eksperiment.

Magnetet kanë dy pole. Polet e kundërta tërheqin njëri-tjetrin, ndërsa polet e njëjta shtyhen.

| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
|---|
| Nxënësit vlerësohen sistematikisht. Vlerësohen ata që japin më shumë mendime që të plotësohet tabela Di, dua të di dhe mësova. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Detyrë shtëpie të bëjnë një eksperiment ku duhet të përdorin magnete, si dhe të sqarojnë me fjalë tërë veprimtarinë gjatë eksperimenti. "Pyetje dhe detyra" f. 81. Plotësimi i fletores së punës f. 31. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Shpjegon me demonstrim veprimin magnetik të magnetit në mjedise dhe dallon lëndët që magnetizohen nga ato që nuk magnetizohen**.** | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1, 2, 6, 7 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.3, 4 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Lëndët magnetike dhe jomagnetike | | | |
| **Fjalët kyçe:** lëndë magnetike, hekur, çelik, argjend, lëndë jomagnetike. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- shpjegon me demonstrim veprimin magnetik të magnetit në mjedise;<br>- dallon lëndët që magnetizohen nga ato që nuk magnetizohen;<br>- nxjerr konkluzione nga eksperimentet e bëra<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Shpjegon me demonstrim së paku dy veprime magnetike në mjedise.<br>- Dallon se paku 3 lëndë që magnetizohen dhe që nuk magnetizohen.<br>- Nxjerr konkluzione nga dy eksperimentet e bëra në klasë. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** magnet, materiale të ndryshme si: gozhdë, stilolaps, vizore, kapës letrash. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Duke bërë përsëritje nga njësitë e kaluara për magnetet, rëndësinë e tyre, përdorëshmërinë e tyre në jetën e përditshme etj., magnetet përdoren për ndarjen e lëndëve magnetike nga ato jomagnetike.<br>Mësuesi/ja pyet po cilat janë disa lëndë magnetike dhe jomagnetike?<br>Pret përgjigjet e nxënësve. | | | |

**Hapi II**
I udhëzon të hapin librat dhe të lexojnë tekstin f. 82.
Pasi të kenë lexuar, ndahen nxënësit ndahen në tri grupe. Grupi i parë do të zhvillojë Veprimtarinë 3.18a.
Grupi i dytë, 3.18b, ndërsa grupi i tretë 3.18c.
Të gjitha grupet prezantojnë bashkë e nxjerrin konkluzionet rreth eksperimenteve:

1. **Lëndët jomagnetike janë ato lëndë që nuk tërhiqen nga magneti. Këto lëndë janë: plastika, letra, druri etj.**
2. **Një trup prej lënde magnetike mund të kthehet në një magnet të përkohshëm.**
3. **Edhe hekuri nën ndikimin e pluhurit magnetikë mund të magnetizohet.**

**Hapi III**
Nxënësit shkruajnë në fletore "Pyetjet dhe detyra", f. 83. Disa nga nxënësit edhe i lexojnë.

| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
|---|
| Vlerësohen nxënësit që japin konkluzione të drejta për eksperimentet. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Ndërton elektromagnetin e thjeshtë dhe demonstron vetitë magnetike të tij. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4; II.2, 6, 7 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.3, 5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Punë praktike. Fuqia e magneteve. Gjilpëra magnetike | | | |
| **Fjalët kyçe:** fuqia e magnetit, gjilpërë magnetike, busull. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- shpjegon fuqinë e magneteve;<br>- demonstron vetitë e magneteve.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Shpjegon fuqinë e magneteve, që i ka parë në video në klasë.<br>- Demonstron vetitë e së paku dy magneteve | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** dy magnete të ndryshme, kapëse letre, vizore. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| **Hapi I**<br>Mësuesi/ja orën e fillon duke e lëshuar një video me projektor apo TV, ku tregon për magnetet.<br>*Lenda :Dituri Natyre 4 Tema : Fuqia e magneteve - YouTube*<br><br>**Hapi II**<br>Pasi nxënësit panë shumë shembuj dhe eksperimente me magnete në videon e lëshuar më lart. Në klasë do të zhvillojnë disa eksperimente që mund t'i bëjnë në kushte klase. Nxënësit lexojnë Veprimtarinë 3.19a dhe 3.19b. Pastaj disa nxënës demonstrojnë eksperimentet e lexuara lart.<br><br>**Hapi III**<br>Pas demonstrimit të eksperimenteve nga disa nxënës, nxjerrin përfundimet:<br>**Magnetet të ndryshme kanë forca të ndryshme tërheqëse.**<br>**Gjilpëra magnetike e busullës tregon drejtimin veri-jug.** |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësim të vazhdueshëm për angazhim në orën mësimore. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Nxënësit do ta shikojnë në shtëpi edhe njëherë videon në *You tube*, mësuesi/ja iu tregon linkun, pastaj ata provojnë e bëjnë vet ndonjë eksperiment. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Ndërton elektromagnetin e thjeshtë dhe demonstron vetitë magnetike të tij. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Ndërtimi i elektromagnetit. Përdorimi i tij | | | |
| **Fjalët kyçe:** elektromagnet, bateri, përçues, përdorim. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- identifikon pjesët përbërëse ndërtuese të elektromagnetit;<br>- shpjegon përdorimin e elektromagnetit;<br>- shkruan për pjesët përbërëse dhe përdorimin e elektromagnetit.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>Identifikon të gjitha pjesët përbërëse të elektromagnetit sipas shembullit demonstrues.<br>Shpjegon saktësisht përdorimin e elektromagnetit në jetën e përditshme.<br>Plotëson sipas kërkesave tabelën për pjesët përbërëse dhe përdorimin e elektromagnetit. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** teksti, tabela, bateria, telat përçues, kapëse letrash, gozhda. | | | |

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Shoqëria dhe mjedisi, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**
Mësuesi/ja me qëllim të përsëritjes së njohurive rreth magneteve, pyet nxënësit: *Ku mund të gjej përdorim fuqia magnetike e trupave? Përmendni disa shembuj.* Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Njoftohen që do të mësojnë se si mund të ndërtohet një elektromagnet. I pyet paraprakisht nxënësit se çfarë mendojnë se mund të jetë një elektromagnet, duke u nisur nga zbërthimi i fjalës. Mësuesi/ja plotëson përgjigjet e nxënësve në rast nevoje dhe shpjegon që elektromagneti fuqinë magnetike e krijon nga fuqia elektrike.

**Hapi II**
Mësuesi/ja demonstron ndërtimin e elektromagnetit. Merr një bateri, një gozhdë, dy tela përçues elektrik, disa kapëse letre. Gozhdën e mbështjell me telat elektrikë dhe të dyja skajet e telave elektrikë i lidh me dy polet e baterisë. Kështu ndërton elektromagnetin dhe për ta provuar, e afron atë më kapëset e letrave dhe demonstron se si ato ngjiten për gozhde. U shpjegon nxënësve që këtë forcë magnetike e ka mundësuar energjia elektrike që vjen nga bateria. Për ta ridëshmuar që çdo gjë varet nga energjia elektrike që vjen nga bateria, shkëput njërin tel nga skaji i baterisë dhe e afron te kapëset e letrave. Shpjegon që nuk ka fuqi magnetike, sepse është ndërprerë energjia elektrike nga bateria.
Udhëzon nxënësit që t'i hapin librat në faqe 90 dhe të lexojnë për përdorimin elektromagnetit në jetën e përditshme.
Pastaj pyet nxënësit: *Tregoni disa raste ku përdoret elektromagneti në përditshmërinë tonë.*

**Hapi III**
Mësuesi/ja në tabelë vizaton një tabelë me dy kolona. Në njërën shkruan: Ndërtimi i elektromagnetit dhe në tjetrën: Përdorimi i elektromagnetit. Të njëjtën tabelë, nxënësit e vizatojnë në fletore.

| Ndërtimi i elektromagnetit | Përdorimi i elektromagnetit |
|---|---|
| | |

Në kolonën e parë, nxënësit do të shkruajnë për pajisjet që nevojiten për ndërtimin e elektromagnetit dhe mënyrës se si ndërtohet ai, ndërsa në kolonën e dytë për përdorimin e elektromagnetit në jetën e përditshme.
Disa nga nxënësit lexojnë përgjigjet e tyre.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet angazhimi i nxënësve për dhënien e përgjigjeve, reflektimi i tyre për atë që kanë lexuar dhe saktësia e plotësimit të tabelës.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Ndërtimi i një elektromagneti sipas shembujve të klasës. Plotësimi i fletores së punës, f. 32.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
| **Tema: Proceset fizike** | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Ndërton elektroskopin e thjeshtë dhe me të dallon trupat që ngarkohen dhe nuk ngarkohen me elektricitet. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Punë praktike: Ndërtimi i elektroskopit | | | |
| **Fjalët kyçe:** elektroskopi, fletë metalike, sfera e elektroskopit. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- identifikon pjesët ndërtuese të elektroskopit;<br>- shpjegon përdorimin e elektroskopit;<br>- shkruan për ndërtimin dhe përdorimin e elektroskopit.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Identifikon të gjitha pjesët ndërtuese të elektroskopit nga shembulli demonstrues.<br>- Shpjegon qartë përdorimin e elektroskopit.<br>- Shkruan të gjithë përbërësit e elektroskopit dhe përdorimin e tij sipas të dhënave të librit. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fleta punuese, shishe qelqi, letër metalike, tel bakri, tapë për mbylljen e shishes, pincë**.** | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Mësuesi/ja paraqet një fotografi të elektroskopit dhe i pyet nxënësit: *Çfarë mendoni që është pajisje në foto? A e keni parë ndonjëherë?*<br>Varësisht nga përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja u tregon që pajisja në foto quhet elektroskop dhe që do ta punojnë në klasë ndërtimin e një elektroskopi dhe do të mësojnë për përdorimin e tij.<br>**Hapi II**<br>Merret një shishe qelqi, një fije e telit të bakrit, tapë për të mbyllur hermetikisht shishen, një pincë, letër alumini. Mësuesi/ja ndërton elektroskopin sipas hapave të paraqitur në libër në faqen 93. U shpjegon nxënësve se elektroskopi përbëhet nga një shufër metali e mbyllur brenda një shisheje qelqi, e cila ka dy pjesë metalike shumë të holla (alumini ose ari) të lidhura në pjesën e poshtme të saj. Në skajin e sipërm, elektroskopi ka një sferë të vogël që shërben për marrjen e ngarkesës elektrike të objektit që duam të studiojmë.<br>Nxënësit lexojnë njësinë mësimore në faqen 92 rreth përdorimit të elektroskopit dhe e shpjegojnë atë me ndihmën e mësuesit/es. | | | |

**Hapi III**

Mësuesi/ja u shpërndan nxënësve nga një fletë pune, të cilën nxënësit do ta plotësojnë.




Do të shkruajnë të gjithë përbërësit ndërtues të elektroskopit dhe përdorimit të tij. Disa nga nxënësit lexojnë punën e tyre.

| |
|---|
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohet pjesëmarrja në ndërtimin e elektroskopit dhe saktësia e plotësimit të fletës punuese. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| "Pyetje dhe detyra", f. 89 |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Proceset fizike</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Ndërton elektroskopin e thjeshtë dhe me të dallon trupat që ngarkohen dhe nuk ngarkohen me elektricitet.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4; III.4</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.5</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Funksioni dhe përdorimi i elektroskopit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: ngarkesë elektrike e njëjtë, ngarkesë elektrike e kundërt.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- rikujton pjesët ndërtuese të elektroskopit;<br>- analizon funksionin/përdorimin e elektroskopit;<br>- shkruan përgjigje në pyetjet e parashkruara.<br>Kriteret e suksesit:<br>- Rikujton të gjitha pjesët përbërëse të elektroskopit të ndërtuar nga ora e kaluar.<br>- Analizon saktë funksionin e elektroskopit sipas shembujve demonstrues.<br>- Shkruan saktë përgjigjet e pyetjeve të parashtruara në libër.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** teksti, fletorja, elektroskopi, balona, krehri. |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** |
| **Hapi I**<br>Elektroskopin e ndërtuar orën e kaluar e vëmë përsëri në përdorim. Me qëllim të rikujtimit të njësisë, mësuesi/ja i pyet nxënësit për pjesët përbërëse të elektroskopit. Pasi i rikujtojnë ato, nxënësit udhëzohen të hapin librat në faqe 90.<br>**Hapi II**<br>Për të ndërtuar një kuptim më të mirë, nxënësit fillimisht lexojnë njësinë: Funksioni dhe përdorimi i elektroskopit.<br>Mësuesi/ja merr një balonë dhe atë e ngarkon me elektricitet (duke e fërkuar për rroba) dhe e afron drejt majës së spirales së telit të bakrit. I nxit nxënësit që të vështrojnë se si trekëndëshat e fletëve të aluminit do të largohen mes tyre. I pyet nxënësit: *Nga ajo që lexuat dhe patë, pse mendoni se janë larguar/hapur fletët e aluminit?* Mësuesi/ja sqaron se kur një trup ka ngarkesë elektrike të njëjtë, atëherë këtë e konstatojmë përmes elektroskopin ngaqë pllakëzat (fletët e aluminit) hapen/largohen.<br>Një nga nxënësit e klasës ftohet nga mësuesi/ja që të realizojë eksperimentin e radhës. Me një krehër (të cilin e ka sjellë mësuesi/ja në klasë) e ngarkojmë me elektricitet (krehja e flokëve të nxënësit) dhe atë e afrojmë afër elektroskopit. Analizohen pozita e pllakëzave metalike dhe lloji i elektricitetit që ka krehri. Nxënësit japin mendimet e tyre për këtë shembull. Plotësohet me komente nga mësuesi/ja.<br>**Hapi III**<br>Nxënësit udhëzohen që të përgjigjen me shkrim në fletore në dy pyetjet në faqe 91. Kontrollohen përgjigjet e tyre dhe disa nga nxënësit lexojnë atë që kanë shkruar. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohet përkushtimi në nxënien e informacioneve të reja, pjesëmarrja aktive, përgjigjja me shkrim në pyetje. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës, trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drunjtëve etj.). | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1, 8; III.3, 4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Qielli dhe yjet | | | |
| **Fjalët kyçe:** yjësi, astronomi, teleskop. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- shpjegon konceptet yjësi, teleskop dhe astronomi;<br>- diskuton për formën e yjësive dhe ngjyrën e yjeve;<br>- konkludon për konceptin duke lidhur fjalët.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Shkruan saktësisht shpjegimet për konceptet yjësi, teleskop dhe astronomi.<br>- Jep së paku dy mendime për formën e yjësive dhe ngjyrën e yjeve.<br>- Konkludon saktësisht për konceptin, duke lidhur fjalët e asociacionit. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** teksti, fleta e punës përgatitur nga mësuesi, tabela, projektori. | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Hapi I**<br>Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që të sjellin në mendje qiellin e një nate të kthjellët, pa re. Parashtron pyetjet nxënësve: *Çfarë vëreni natën? Çfarë yjesh shihni? Sa larg mendoni që janë yjet nga toka? A duken të gjithë yjet njësoj?*<br>Nxënësit japin përgjigje në lidhje me pyetjet. Mësuesi/ja i njofton që do të mësojnë rreth yjeve dhe qiellit?<br>**Hapi II**<br>Nxënësit hapin librat në faqen 96 dhe udhëzohen që të lexojnë njësinë në mënyrë individuale, në heshtje. Gjatë leximit, ata do të identifikojnë më + gjërat e reja që kanë mësuar dhe me – gjërat që nuk i kuptojnë dhe me ? informacionet që duan të dinë më shumë.<br>Pas leximit, nxënësit përgjigjen për gjërat e reja që i kanë mësuar, secili nga nxënësit tregon të paktën një informacion të ri që e ka përvetësuar. Diskutohen informacionet që kanë qenë të paqarta, të cilat shpjegohen nga mësuesi/ja. | | | |

Nxënësve u jepet një fletë pune ku do të plotësojnë një tabelë që ka të bëjë me plotësim fjalorthi.

| Fjalorthi | Shpjegimi |
|---|---|
| **Yjësi** | |
| **Teleskop** | |
| **Astronomi** | |

Pasi nxënësit plotësojnë tabelën, disa nga ata lexojnë përgjigjet që kanë shkruar.
Mësuesi/ja hap diskutimin rreth disa pyetjeve të shkruara në tabelë.

- *Si kanë shërbyer yjësitë në të kaluarën dhe si i kanë emëruar ato?*
- *Çfarë ngjyrash kanë yjet dhe nga çka varet ngjyra e tyre?*
- *A e shohim të gjithë njerëzit qiellin njësoj? Arsyetoni?*

Diskutohet së bashku me nxënësit në lidhje me pyetjet e parashtruara.

**Hapi III**

Mësuesi/ja me ndihmën e projektorit shfaq para nxënësve një asociacion. Asociacioni ka të bëjë me qiellin dhe yjësinë. P.sh.:

| | |
|---|---|
| Yll | mjet |
| Me ngjyrë të verdhë | studion yjet |
| Ngroh tokën | thjerrëza |
| Më i afërti me tokën | afron pamjen |
| DIELLI | TELESKOPI |

Forma të tjera të asociacioneve që kanë të bëjnë me njësinë i krijon mësuesi/ja dhe ato i realizojnë bashkë me nxënësit.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet pjesëmarrja në diskutim, saktësia e plotësimit të fletës së punës, përgjigjeve në pyetjet për diskutim dhe përgjigjet në asociacione.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Veprimtaria 4.1, fletorja e punës, f.33

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës, trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drunjtëve etj.). | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1, 8; III.3, 4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6 | | | |

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Sistemi ynë diellor

**Fjalët kyçe:** planet, orbitë, satelit, asteroide, kometa, meteorë

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- tregon për sistemin diellor;
- dallon veçoritë e trupave të sistemit diellor;
- gjen përgjigjet e sakta rreth veçorive të trupave të sistemit diellor.

**Kriteret e suksesit:**
- Tregon saktësisht për përbërësit e sistemit diellor dhe karakteristikat e tij.
- Shkruan saktësisht veçoritë e trupave të sistemit diellor në fletë të punës.
- Gjen përgjigjen e saktë duke rikujtuar veçoritë e secilit trup qiellor të sistemit diellor.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, tabela, fletë pune përgatitur na mësuesi/ja, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Mësuesi/ja në qendër të tabelës shkruan fjalën *planetë*.




I pyet nxënësit: *Cilat planetë njihni? Çfarë janë planetët? Çfarë dini për ta?* Disa nga përgjigjet, i shkruan në tabelë. Mësuesi/ja shpjegon që planetët janë trupa qiellorë, të cilët rrotullohen rreth një sistemi që është sistemi diellor dhe që do të mësojnë më shumë rreth tij.

**Hapi II**

Nxënësit hapin librat në faqen 98 dhe lexohet njësia me zë nga disa nxënës. Mësuesi/ja pyet nxënësit për informacionet e reja që kanë mësuar, pastaj hap diskutimet rreth disa pyetjeve, të cilat i ka shkruar në tabelë apo edhe paraqitur përmes projektorit.
- *Çka është sistemi diellor? Përmend cilët trupa qiellor rrotullohen rreth tij?*
- *Çka janë planetët? Përmend disa karakteristika të planetëve? Cilat janë planetët e sistemit diellor?*

- *Ç'është orbita?*
- *Cilët janë planetët e brendshëm dhe nga çka përbëhen ata?*
- *Cilët janë planetët e jashtme dhe nga çka përbëhen ata?*

Nxënësit japin përgjigjet e tyre duke u bazuar në informacionet që kanë marrë në libër. Përgjigjet e tyre plotësohen nga informacione shtesë nga mësuesi/ja.

Nxënësve u jepet një fletë pune ku do të plotësojnë rreth trupave qiellorë.

Trupi qiellor

| Trupi qiellor | Shpjegimi |
|---|---|
| **Sateliti** | |
| **Planeti** | |
| **Meteori** | |
| **Asteroidi** | |
| **Kometa** | |

Pasi nxënësit të plotësojnë tabelën, disa nga ata lexojnë mënyrën se si kanë bërë shpjegimin për secilin trup qiellor.

**Hapi III**

Luajmë një lojë: "Dy të vërteta, një gënjeshtër". Shembujt të cilët i ka përgatitur më parë i paraqet mësuesi/ja përmes projektorit. P.sh.:

*1. Meteorët janë copa të vogla që shkëputen nga asteroidet apo nga kometat dhe, kur hyjnë në atmosferën e Tokës, fillojnë të digjen.*

*2. Asteroidi është një trup qiellor, që rrotullohet rreth Diellit. Ajo përbëhet prej akulli dhe gazi.*

*3. Asteroidet janë copa të vogla shkëmbi ose metali që vërtiten në hapësirë.*

Nxënësit do të analizojnë fjalitë dhe gjejnë se cila nga fjalitë është gënjeshtra. Përgjigjen e tyre e arsyetojnë. Shembujt të tjerë, mësuesi/ja vazhdon t'i paraqesë deri në përfundim të orës.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet angazhimi i nxënësve në dhënien e përgjigjeve, përfshirja në diskutim, saktësia e plotësimit të fletës së punës, saktësia e arsyetimeve të dhëna për lojën "Dy të vërteta, një gënjeshtër".

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Veprimtaria 4.2, f. 100 dhe fletorja e punës.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
|---|---|---|---|
| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Shpjegon rëndësinë e Diellit për dukuritë gjeografike, si: qarkullimi i përhershëm i ujit, ajrit, zhvillimi i botës bimore e shtazore, baticat e zbaticat. | |

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1, 3; II.6 III.4

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Dielli burimi i jetës

**Fjalët kyçe:** njollat e diellit, fotosintezë

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**

**Nxënësi/ja:**

- tregon njohuritë që ka për diellin;
- përgjigjet në pyetje e diskutimit rreth njësisë;
- analizon ndikimin e Diellit në Tokë.

**Kriteret e suksesit:**

- Jep së paku dy mendime rreth diellit dhe veçorive të tij.
- Përgjigjet saktësisht në të gjitha pyetjet e parashtruara për diskutim nga mësuesi/ja.
- Analizon saktësisht ndikimin e Diellit në Tokë sipas skemës së paraqitur.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, tabela, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe/Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Hapi I**

Mësuesi/ja vizaton në tabelë një diell dhe në qendër e shkruan fjalën dielli. Kërkon nga nxënësit që të tregojnë se çfarë dinë paraprakisht për diellin.




Përgjigjet e nxënësve i shkruan në tabelë në vijat-rreze të diellit. I informon nxënësit se do të mësojnë më shumë rreth diellit dhe ndikimit të tij në jetën në tokë.

**Hapi II**

Nxënësit hapin librat në faqen 102 dhe fillojnë leximin e njësisë mësimore. Për 3 minuta, nxënësit lexojnë në heshtje njësinë mësimore pastaj njësia lexohet me zë nga disa nxënës. Fillimisht lexohet paragrafi i parë dhe mësuesi/ja parashtron pyetjet: *Çfarë është dielli? Sa larg gjendet ai nga Toka? Si e krijon dritën dhe nxehtësinë Dielli? Planetët e kanë dritën e vet apo atë e reflektojnë nga Dielli?* Nxënësit u përgjigjen pyetjeve.

Lexohet paragrafi i dytë me zë nga një nxënës. Mësuesi/ja parashtron pyetjet: *Çfarë vërejnë nëse e shikojmë me teleskop Diellin? Pse disa njolla janë më të errëta? Çfarë ndodh me energjinë e Diellit deri sa të arrijë në sipërfaqen e Tokës?* Nxënësit u japin përgjigje pyetjeve.

Lexohet paragrafi i fundit nga një nxënës dhe mësuesi/ja parashtron pyetjen: *Si varet jeta në Tokë nga Dielli?* Nxënësit japin përgjigje të zgjeruar.

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit që edhe njëherë të bëjnë një përmbledhje për gjithë informacionet e mësuara për Diellin. Reflektimin e përgjithshëm e bëjnë disa nga nxënësit.

**Hapi III**

Përmes projektorit, mësuesi/ja paraqet një skemë të ciklit të jetës në Tokë si rrethojë e ndikimit të Diellit. I nxit nxënësit që të analizojnë skemën.




Nxënësit shkruajnë përgjigjet e tyre në fletore, ku përshkruajnë gjithë procesin e jetës në Tokë nga ndikimi i Diellit. Këtë e bëjnë duke shkruar në një skemë të ngjashme.

Dielli
↓
Njerëzit ⟷ Bimët ⟷ Kafshët

Disa nga nxënësit lexojnë përgjigjet e shkruara. Plotësohen me komente shtesë në rast nevojë nga mësuesi/ja.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet pjesëmarrja në diskutim rreth pyetjeve të parashtruara nga mësuesi/ja, saktësia e analizimit dhe përshkrimit të skemës së ndikimit të Diellit në Tokë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Veprimtaria 4.3 dhe fletorja e punës

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
|---|---|---|---|

**Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia**

**Rezultati i të nxënit të temës:** Përshkruan strukturën (ndërtimin e brendshëm) e Tokës: dallon bërthamën, mantelin dhe koren e Tokës, si dhe të tregon se korja e Tokës përbëhet nga shkëmbinj të ndryshëm.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1, 3; II.1; III.4

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Planeti Tokë

**Fjalët kyçe:** korja e tokës, manteli, bërthama e tokës

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**

**Nxënësi/ja:**

- tregon veçoritë e planetit Tokë;
- shpjegon pjesët përbërëse të ndërtimit të Tokës;
- plotëson pesëvargësh për Tokën.

**Kriteret e suksesit:**
- Tregon së paku tri veçori të planetit Tokë.
- Shpjegon karakteristikat e pjesëve përbërës të ndërtimit të Tokës në fletën e punës.
- Plotëson saktësisht pesëvargëshin për Tokën.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fleta e punës e përgatitur nga mësuesi/ja, tabela, fletorja.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Mësuesi/ja u lexon nxënësve një gjëegjëzë: *Është një top blu, pa fillim dhe pa mbarim, shtëpia e të gjithë njerëzve?* Nxënësit qëllojnë përgjigjen që është toka. Në tabelë, mësuesi/ja vizaton një elipsë dhe në mes e shkruan toka. I nxit nxënësit që t`i rikujtojnë të informacionet që i dinë për tokën. Disa prej tyre shkruhen në tabelë.




**Hapi II**

Nxënësit hapin librat në faqen 104. Lexojnë njësinë mësimore në mënyrë individuale. Ndërkohë, mësuesi/ja shkruan në tabelë disa pyetje rreth njësisë. *Sa është e vjetër Toka? Pse në Tokë ka jetë? Kush është sateliti i Tokës? Cilat janë shtresat e Tokës? Çfarë gjendet në kore të Tokës? Sa lloje kore të Tokës kemi? Çka janë manteli dhe bërthama?*

Pasi kanë lexuar njësinë, mësuesi e hap diskutimin rreth pyetjeve. Nxënësit japin përgjigjet në pyetje dhe natyrisht, mësuesi/ja i plotëson me komente dhe shpjegime shtesë për secilën pyetje.

Nxënësve u jepet një fletë pune ku do të plotësojnë për shtresat e tokës. Për secilën shtresë, ata do të shkruajnë informacionet që kanë marrë.




Në fletën e punës, nxënësit në drejtkëdëshit e vegjël do të shkruajnë emrin e secilës pjesë të Tokës, ndërsa në drejtkëndëshin e madh, informacionet që kanë mësuar rreth tyre. Pastaj e ngjyrosin secilën pjesë me ngjyrat që duhet.

| |
|---|
| **Hapi III**<br>Mësuesi/ja shkruan në tabelë një pesëvargësh.<br><br>Toka<br><br>__________ __________<br><br>__________ __________ __________<br><br>______________________________<br><br>__________<br><br>Nxënësit plotësojnë pesëvargëshin dhe disa nga ata lexojnë mënyrën se si e kanë plotësuar atë. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohet angazhimi në dhënien e përgjigjeve në pyetjet e diskutimit, saktësia e plotësimit të fletës së punës, saktësia e plotësimit të pesëvargëshit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Veprimtaria 4.4 dhe fletorja e punës, f. 36 |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës, trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drunjtëve etj.). | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1, 3; II.6; III.3, 4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Hëna, sateliti natyror i Tokës | | | |
| **Fjalët kyçe:** satelit natyror, çerek hëne, hënë e re, cikli hënor. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- rikujton informacione për Hënën;<br>- përgjigjet në pyetjet e parashtruara për veçoritë e Hënës;<br>- shpjegon ciklin hënor. | | | |

**Kriteret e suksesit:**
- Rikujton së paku tri informacione për hënën nga diskutimet e kaluara.
- Përgjigjet saktë në të gjitha përgjigjet e parashtruara nga mësuesi/ja për veçantitë e Hënës.
- Shpjegon saktësisht gjithë ciklin hënor në fletën e punës.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, fletorja, fleta e punës përgatitur nga mësuesi/ja, dritë (telefoni, baterie), nxënësit, tabela.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Matematikë, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Mësuesi/ja lexon para nxënësve një gjëegjëzë:



*Si xixëllonja*
*Natën ndrijnë*
*Kur lindë dielli*
*Vallë ku rrinë.*

Nxënësit qëllojnë përgjigjen që bëhet fjalë për hënën dhe në tabelë mësuesi/ja vizaton një hënë. I nxit nxënësit të mendojnë rreth njohurive që dinë për hënën dhe disa nga mendimet e tyre i shkruan në tabelë.



Shpjegimi________________

**Hapi II**

Nxënësit hapin librat në faqen 104 dhe lexojnë njësinë në mënyrë individuale. Secili nga nxënësit identifikon me + në libër informacionet e reja që ka nxjerr nga njësia. Pas leximit, secili nxënës shpreh para të tjerëve një informacion të ri që ka marrë nga njësia. Mësuesi/ja hap diskutimin rreth pyetjeve që ka shënuar ndërkohë në tabelë. *Çfarë është Hëna? Çfarë forme ka ajo? Sa është sipërfaqja e saj? Pse në Hënë nuk ka jetë? Pse e shohin Hënën në forma të ndryshme? Sa zgjat një cikël i Hënës?*

Nxënësit japin përgjigje në lidhje me pyetjet dhe mësuesi/ja jep informacione plotësuese rreth pyetjeve të diskutimit.

Nxënësve u jepet një fletë punuese ku është paraqitur cikli i hënës. Ata do të shpjegojnë ciklin e hënës në fletën punuese. Secila fazë duhet të emërohet dhe më poshtë të shpjegohet si ndodh si cikël dhe sa zgjat ai.

Pasi të përfundojnë plotësimin e fletës, disa nga nxënësit e lexojnë përgjigjet e tyre.

**Hapi III**

Luajmë lojë për të demonstruar ciklin e hënës. 9 nxënës dalin para klasës duke formuar një rreth. Një nga nxënësit vendoset në mes të rrethit (në pozitën e Tokë), 8 nxënësit e tjerë vendosen në pozita të ndryshme (pozitat e hënës gjatë ciklit të saj). Mësuesi/ja merr një dritë (telefoni apo baterie/llambe) duke e simbolizuar dritën e diellit. Shpjegon se nxënësi që gjendet përballë me dritën simbolizon që Dielli, Hëna dhe Toka janë në një pozitë andaj drita e hënës nuk mund të shihet, sepse pjesa e errët e Hënës është në drejtim të Tokës. Pastaj pozitën e nxënësit të dytë e shpjegon që hëna ka vazhduar rrotullimin e saj dhe e shohim çerekun e saj pas 7 ditësh.

| |
|---|
| Pasi të ketë përfunduar 14 ditë rrotullim, shohim hënën e plotë dhe Toka gjendet në mes të Diellit dhe Hënës, andaj ne mund ta shohim të plotë hënën. Pastaj vazhdon me shpjegimin e fazave të tjera deri në përfundim të ciklit, duke përdorur pozitat e nxënësve që simbolizojnë pozitat/fazat e hënës. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohet angazhimi në dhënien e përgjigjeve në lidhje me veçoritë e hënës, analizimi dhe shpjegimi i ciklit hënor, pjesëmarrja aktive në diskutim. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Veprimtaria 4.5 |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës, trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drunjtëve etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, 3; II.6; III.3, 4</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Stinët, dita e nata</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: boshti i tokës, orbitë, vit i brishtë, ekuinoksi, solstici.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon dukurinë e ndërrimit të stinëve nga e ndërrimit të ditës dhe natës;<br>- shpjegon dukurinë e ndërrimit të stinëve dhe ditës dhe natës;<br>- plotëson tabelën rreth dukurive në fletën plotësuese.<br>Kriteret e suksesit:<br>- Dallon sipas veçorive dukurinë e ndërrimit të stinëve nga ajo e ndërrimit të ditës dhe natës.<br>- Shpjegon saktësisht dukurinë e ndërrimit të stinëve dhe ditës dhe natës sipas pozitave të Tokës.<br>- Plotëson saktë tabelën rreth 4 dukurive në fletën plotësuese.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabela, fletorja, teksti, projektori, fleta plotësuese e përgatitur nga mësuesi/ja.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.</td></tr>
</table>

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Mësuesi/ja parashtron pyetjet nxënësve: *Keni menduar ndonjëherë pse në disa vende të botës është ditë kur në vendin tonë është natë? Apo pse në disa vende të botës është dimër kur tek ne është verë?* Nxënësit paraqesin disa supozimet e tyre, megjithatë mësuesi/ja i njofton që përmes njësisë do të mësojnë më shumë rreth mënyrës se si ndërrohen stinët dhe dita e nata.

**Hapi II**

Nxënësit hapin librat në faqen 106. Lexohet me paragrafë. Njëri nga nxënësit lexon paragrafin e parë dhe mësuesi parashtron pyetjet për këtë pjesë: *Çka është orbita? Për sa kohë Toka e kryen rrotullimin rreth Diellit? Çka është viti i brishtë? Pse ndryshojnë stinët?* Nxënësit japin përgjigjet e tyre por plotësohen edhe nga shpjegimet e mësuesit/es.

Lexohet paragrafi i dytë dhe tretë nga një nxënës tjetër. Parashtrohen pyetjet: *Si dallojnë stinët në polin e veriut nga ai i jugut? Çka është boshti i Tokës? Për sa kohë e kryen Toka rrotullimin rreth boshtit të vet? Çka ndodh si pasojë e rrotullimit të saj rreth boshtit?* Diskutohet rreth këtyre pyetjeve.

Lexohet paragrafi i tretë dhe katërt dhe diskutohet rreth pyetjeve: *Si krijohet dita dhe nata? Çka janë ekuinokset dhe kur ndodhin ato? Çka janë solsticet dhe kur ndodhin ato?*

Për të sqaruar më praktikisht ndryshimin e stinëve dhe ditës dhe natës, mësuesi/ja shfaqet dy video përmes projektorit

*https://www.youtube.com/watch?v=WgHmqv_-UbQ*

*https://www.youtube.com/watch?v=Wr-CRKsTYGs*

Diskutohet edhe njëherë për ndryshimin e stinëve dhe ditës dhe natës. Nxënësit paraqesin mendimet e tyre se si i kanë kuptuar këto dy procese. Shpjegohet që dallimi thelbësor është se ndërrimi i stinëve ndodh si rezultat i rrotullimit të tokës ndaj diellit dhe ndërrimi i ditës dhe natës si rezultat i rrotullimit ndaj boshtit të vet.

**Hapi III**

Nxënësve u jepet një fletë pune ku ata do të plotësojnë tabelën me katër kolonat, ku do të shkruajnë informacionet e përmbledhura për secilën dukuri.

| Ndryshimi i stinëve | Ndryshimi i ditës dhe natës | Ekuinokset | Solsticet |
|---|---|---|---|
| | | | |

Pasi ta përfundojnë, secili nxënës lexon përgjigjet nga një kolonë që i kërkon mësuesi/ja.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohet pjesëmarrja aktive në dhënien e përgjigjeve për pyetjet e parashtruara nga mësuesi/ja, saktësia e përgjigjeve, saktësia e plotësimit të tabelës në fletën plotësuese.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Veprimtaria 4.6 dhe fletorja e punës

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:** **Shkencat e natyrës** | **Lënda:** **Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:** **II** | **Klasa:** **IV** |
| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | | **Rezultati i të nxënit të temës:** Identifikon dhe shpjegon mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan, duke treguar dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1, 3; III.3, 4; VI.2 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Orientimi në natyrë | | | |
| **Fjalët kyçe:** ylli polar, skica, shkalla e zvogëlimit, plani, legjenda | | | |

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**

**Nxënësi/ja:**
- dallon mundësitë/mjetet për orientim në natyrë;
- shpjegon mënyrat e orientimit në natyrë;
- krijon një skicë dhe plan dhe situatë për orientim në natyrë sipas Diellit dhe Yllit Polar.

**Kriteret e suksesit:**
- Dallon në bazë të veçorive mënyrat e orientimit në natyrë.
- Shpjegon saktësisht secilën mënyrë të orientimit në natyrë.
- Krijon, në bashkëpunim, një skicë dhe plan dhe situatë për orientim në natyrë sipas Diellit dhe Yllit Polar sipas kërkesave të detyrës

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teksti, tabela, fleta A4, skica, plani.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë kuptojnë më orientim në natyrë, të kujtojnë një rast kur u është dashur të orientohen në natyrë. Rikujtojnë anët e horizontit, të mësuara në klasat e mëparshme, veri, jug, lindje dhe perëndim. Mësuesi/ja parashtron pyetjen nxënësve: *Me ndihmën e cilave pajisjeve orientohemi në natyrë?* Nxënësit japin përgjigjet në bazë të njohurive që kanë. Ata njoftohen që do të mësojnë më shumë për orientimin në natyrë.

**Hapi II**

Udhëzohen t'i hapin librat në faqen 108 dhe fillojnë të lexojnë njësinë mësimore. Pasi të lexojnë njësinë, mësuesi/ja parashtron pyetjen: *Si janë orientuar më parë njerëzit?* Dy nxënës japin përgjigjet rreth pyetjes. Pastaj mësuesi/ja fton një nxënës që të dalë para klasës dhe t`i paraqes orientimet në natyrë. Nxënësi/ja kthehet me fytyrë kah lindja dhe tregon se pas tij gjendet perëndimi, në të djathtë të tij gjendet jugu dhe në të majtë veriu. Kjo përsëritet edhe nga disa nxënës të tjerë.

| |
|---|
| Mësuesi/ja vazhdon me pyetje: *Çfarë është Ylli Polar? Për çfarë shërben ai? Si mund të orientohemi në bazë të trungut të drurëve?* Nxënësit përgjigjen në pyetje të cilat plotësohen edhe nga informacione shtesë nga mësuesi/ja.<br>Mësuesi/ja në klasë ka sjellë një skicë të rrugës së tij nga shtëpia në shkollë. E shpjegon shkallën e zvogëlimit dhe mënyrën e orientimit në anë të skicës.<br>Mësuesi/ja ka sjellë planin e një shkollë në një letër. I shpjegon shenjat dhe simbolet apo legjendat dhe domethënien e tyre.<br>**Hapi III**<br>Nxënësit ndahen në tri grupe sipas rreshtit ku janë ulur. Grupi/rreshti i parë do të përshkruaj si mund të orientohemi në natyrë përmes Diellit dhe Yllit Polar. Grupi/rreshti i dytë do të vizatojë një skicë të ndonjë lagjeje apo objekteve orientuese në natyrë (shembuj të objekteve nga lagjja e tyre). Grupi i tretë do të punojë një plan të ndonjë shtëpie, shkolle apo dyqani duke i bërë edhe legjendat. Nxënësve paraprakisht u është dhënë fleta të bardha A4 ku do të shkruajnë punën e tyre. Kjo punë realizohet në dyshe të nxënësve (dyshja e ulur në një bankë) brenda grupit/rreshtit. Pra, secila dyshe vjen me ide të ndryshme. Skicat dhe planet do të jenë të thjeshta duke u bazuar në aftësitë e vizatimit të një nxënësi të klasës së katërt.<br>Secila nga dyshet e nxënësve e paraqet punën e tyre të përbashkët. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohet pjesëmarrja në diskutim, saktësia e përgjigjeve të dhëna, aftësitë e bashkëpunimit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Veprimtaria 4.7 dhe fletorja e punës, f. 38 |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Identifikon dhe shpjegon mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan, duke treguar dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.3; III.4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6; 2.5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Harta | | | |
| **Fjalët kyçe:** harta, harta tematike. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- gjen vende të ndryshme në hartë;<br>- shpjegon njohuritë e marra nga njësia mësimore;<br>- përcakton, meridianet, paralelet dhe ekuatorin. | | | |

**Kriteret e suksesit:**
- gjen së paku dy qytete në hartën e Kosovës.
- shpjegon së paku tri të dhëna nga njësia e lexuar.
- përcakton meridianët, paralelet dhe ekuatorin në fletën e dhënë nga mësuesi/ja.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** hartë, glob, fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**
Mësuesi/ja orën e fillon duke e shpalosur një hartë të Kosovës. Pyet nxënësit se çfarë është kjo. Pastaj me dy-tre nxënës gjen emrat disa qyteteve të Kosovës, i qarkon me laps dhe i pyet nxënësit*: Si mendoni, pse duken aq të vogla qytetet këtu?*
Merr përgjigjet e nxënësve dhe i shkruan disa në tabelë.

**Hapi II**
I udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të marrin informacionet e reja lidhur me njësinë mësimore. Pasi të kenë lexuar disa herë, mësuesi/ja shkruan në tabelë:
- *Çka është harta?*
- *Sa është shkalla e zvogëlimit në hartë?*
- *Si bëhet orientimi në hartë?*
- *Çfarë lloje hartash kemi?*
- *Çka është globi?*

Mësuesi/ja merr dy-tri përgjigje nga një pyetje dhe përgjigjen më të saktë e shkruan në tabelë, gjithmonë duke bërë pyetje që t'í nxisë nxënësit ta plotësojnë përgjigjen e njëri-tjetrit.



Pastaj i shpërndan secilit nxënës nga një fletë A4, si në foto. Ata duhet të shkruajnë cilat janë meridianët, paralelet dhe të gjejnë ekuatorin. E bashkë me mësuesin/en e gjejnë Meridianin e Grinuiçit.

**Hapi III**
Vazhdojnë të punojnë veprimtarinë 4.8 në tekst, si dhe pyetjet dhe detyrat i shkruajnë në fletore. Disa nxënës i lexojnë me radhë përgjigjet.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit vlerësohen gjatë punës sistematike në klasë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Shpjegon pozitën e Tokës në Sistemin diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës, trupave të tjerë të këtij sistemi dhe përshkruan mënyrat kryesore të orientimit në natyrë (Diellit, busullës, Yllit Polar, Hënës, orës së dorës, hijes së mesditës, objekteve, drunjtëve etj.).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.4; II.7</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.4</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Format e relievit</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: male, fusha, kodra, reliev</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon gjetjet nga video;<br>- analizon gjetjet nga video.<br>Kriteret e suksesit:<br>- Shpjegon së paku disa forma të relievit të para në video.<br>- Analizon llojet e relievit në disa territore te vendit tonë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: laptop, projektor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><th colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Hapi I<br>Mësuesi/ja bën përshkrimin me fjalë të një destinacioni p.sh., Prishtinë–Pejë. Gjatë përshkrimit të rrugës, tregon ku ka fusha, male, kodrina, lumenjtë etj.<br>Pra, të gjitha këto me një fjalë i quajmë reliev.<br>Hapi II<br>Lëshon një video ku shihet relievi i Kosovës.<br>Nxënësit duhet të mbajnë shënime. Ata duhet t'i shënojnë regjionet e njohura me emra (p.sh. malet e Rugovës, lumi Drini i Bardhë etj.).<br>RELIEVI I KOSOSVES - YouTube<br>Pastaj hapin librat dhe lexojnë njësinë e radhës, f. 112. Në fund do t'i përmbledhin në një fletë ato që mësuan. Nxënësve që iu pëlqen të vizatojnë. Ata do të vizatojnë format e relievit (do t'i paraqesin vetëm me vizatim).<br>Hapi III<br>Lexojnë disa nxënës atë përmbledhjen që do ta bëjnë për format e relievit. Ndërsa ata që i kanë vizatuar do t'i vendosin në tabelë format e relievit të vizatuara.</td></tr>
<tr><th colspan="4">VLERËSIMI I NXËNËSVE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Nxënësit vlerësohen për përmbledhjen dhe vizatimet më të mira të formave të relievit.</td></tr>
</table>

| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
|---|
| Detyrë shtëpie Veprimtaria 4.9 dhe Pyetje dhe detyra, f. 113. |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Shpjegon përbërjen, ndërtimin e atmosferës dhe rëndësinë e saj për proceset në natyrë dhe jetën në Tokë. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2. 6; III.4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Atmosfera | | | |
| **Fjalët kyçe:** atmosfera, mbulesa e gazrave, troposfera, stratosfera. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- identifikon shtresat e atmosferës;<br>- shkruan shtresat e atmosferës;<br>- përcakton anët e erës.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Identifikon së paku tri shtresa të atmosferës.<br>- Shkruan të gjitha shtresat e atmosferës të cekura në tekst.<br>- Përcakton më anë të shqisës së prekjes anën se nga lëvizë era. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** laptop, projektor, fletë hameri, shami apo shall. | | | |
| **Lidhja me lëndëte tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |

**Hapi I**

Mësuesi/ja hap në projektor (apo fletë të madhe të hamerit) shtresat e atmosferës. Paraqet foton para nxënësve.



**Hapi II**
I udhëzon nxënësit të hapin librin në f. 114, të lexojnë njësinë për atmosferën. Mbyllin librat dhe testojnë njohuritë e marra.
Faktet që i kanë mbajtur mend, i plotësojnë në listën që do shkruajnë në fletore për secilën shtresë të atmosferës.

1. Troposfera ______________________________

2. Stratosfera ______________________________

3. Mezosfera ______________________________

4. Jonosfera ______________________________

5. Ekzosfera ______________________________

**Hapi III**
Nxënësit punojnë Veprimtarinë 4.10, të ndarë në grupe. Secili grup përbëhet nga 5 nxënës.
Në fund, luhet loja "Era". Një nxënës ulet në karrige dhe i mbyll sytë me një shall. Dy nxënës të tjerë afër tij, lëvizin ajrin me fletore. Nxënësi që është ulur, duhet ta gjejë se në cilin drejtim lëvizë ajri. Ai qe fiton ndërron rolin me tjetrin.

| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
|---|
| Vlerësohen nxënësit që plotësojnë sa më saktë shtresat e atmosferës në fletore. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Fletorja e punës, f. 39 |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Paraqet shembuj të zgjerimit të ajrit, me zmadhimin e temperaturës dhe shpjegon qarkullimin e tij, si dhe motin e klimën. | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1, 3, 6 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6; 2.1, 3, 5 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Klima. Moti | | | |
| **Fjalët kyçe:** klima, moti, temperatura, gjerësi, lartësi, ftohtë, nxehtë. | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- diskuton për klimën dhe motin;<br>- kategorizon ndarjen e klimave;<br>- vlerëson rëndësinë e klimës në vendin tonë. | | | |

**Kriteret e suksesit:**
- Diskuton me njohuritë paraprake për motin dhe klimën.
- Kategorizon ndarjen e klimave siç është në tekst.
- Vlerëson rëndësinë e klimës që është në vendin tonë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Foto, fletë A4

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**

Mësuesi/ja fillon orën duke pyetur nxënësit me pyetje të përgjithshme: *Sa njohuri keni për motin? Ku dëgjojmë që flitet për motin? Çka është moti? Cilat janë elementet e motit? Çka është klima? etj.*
Pasi merr përgjigjet e nxënësve (përgjigjet e sakta që na orientojnë në njësinë mësimore të caktuar), i shkruan në tabelë, duke i plotësuar aty ku ka nevojë.
- Moti paraqet gjendjen fizike brenda një territori të caktuar në një çast të dhënë.
- Elementet e motit janë: temperatura e ajrit, shtypja atmosferike, shpejtësia e erës, vranësirat, reshjet etj.
- Klima është tërësia e kushteve meteorologjike mesatare dhe dukurive atmosferike gjatë një periudhe kohe të caktuar (javë, muaj, vite, dekada, shekuj, mijëvjeçar etj.), në një zonë të caktuar.

**Hapi II**

Mësuesi/ja jep sqarime rreth klimës:
**Klima e tokës përcaktohet nga gjerësia, domethënë largësia nga ekuatori dhe lartësia, pra, nga lartësia mbi nivelin e detit.**
Udhëzohen nxënësit të hapin librat; lexojnë për 5 minuta; pastaj diskutojnë rreth njohurive të reja.
Mësuesi/ja hap në projektor foton nga teksti (f. 66, fig. 3.9.1).
Flet më nxënësit rreth pamjes dhe ndarjes së klimave. Për çdo zonë, nxënësit duhet të flasin njohuri të përgjithshme për atë zonë.
- Zonë e ftohtë polare
- Zona e butë
- Zona e nxehtë ekuatoriale
- Zona e butë
- Zona e ftohtë polare

Klima ndahet në: e ftohtë, e butë, e nxehtë.
Për secilën klimë marrim përgjigjet e nxënësve dhe e plotësojmë tabelën.

**Hapi III**

Udhëzohen nxënësit të punojnë veprimtarinë 4.11.
Përgjigjet i lexojnë disa nxënës.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës mësimore. Ata që janë më aktiv në klasë vlerësohen më mirë.

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyrë shtëpie do të mbajnë shënime për ndryshimet e motit për një javë (e përcjellin në TV) nga e hëna deri të dielën, pastaj i argumentojnë në klasë në orën vijuese dhe fletore pune faqe 40

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

## ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| **Shkencat e natyrës** | **Njeriu dhe natyra** | **II** | **IV** |

| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | **Rezultati i të nxënit të temës:** Përshkruan qarkullimin e ujit në natyrë (paraqesin në mënyrë skematike qarkullimin e ujit në natyrë) dhe tregon që pjesa më e madhe e sipërfaqes së Tokës është e mbuluar me ujë (oqeanet, detet, lumenjtë), pjesa më e vogël është tokë (kontinentet). |
|---|---|

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** II.6; III.4; IV.8

**Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6; 2.5

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Qarkullimi i ujit në natyrë

**Fjalët kyçe:** cikël i ujit, qarkullim i ujit, avulli, kondensim.

**Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**
**Nxënësi/ja:**
- përsërit njohuritë e fituara më herët;
- paraqet qarkullimin e ujit në natyrë;
- nxjerr konkluzione nga eksperimenti i bërë.

**Kriteret e suksesit:**
- Paraqet njohuritë për qarkullimin e ujit të mësuara më herët.
- Paraqet në fletë qarkullimin e ujit në natyrë.
- Nxjerr një konkluzion nga eksperimenti i bërë në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** një enë plastike me kapak të tejdukshëm, një gur dhe një vazo e vogël me bimë, një copë e vogël letre alumini, fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

### Hapi I

Mësuesi/ja iu rikujton njësinë mësimore kur kanë folur për ajrin, kanë përmendur edhe qarkullimin e ujit në natyrë.

### Hapi II

Nxënësit hapin librat dhe lexojnë njësinë mësimore, f. 118.

Pasi të kenë lexuar, mësuesi/ja u shpërndanë nga një fletë pune ku duket qarkullimi i ujit në natyrë. Ata duhet të shkruajnë poshtë fotos së secilës figurë se si ndodhë procesi i qarkullimit të ujit.



| **Hapi III**<br>Nxënësit, të ndarë në grupe, zhvillojnë Veprimtarinë 4.11, si në libër.<br>Pastaj shkruajnë konkluzionet e nxjerra nga eksperimenti i bërë. Në fund, i lexojnë disa prej tyre. |
|---|
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Nxënësit vlerësohen sistematikisht gjatë orës së mësimit. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Pyetje dhe detyra, f. 119. Fletorja e punës, f. 41 |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

<table>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td>Fusha kurrikulare:<br>Shkencat e natyrës</td><td>Lënda:<br>Njeriu dhe natyra</td><td>Shkalla e kurrikulës:<br>II</td><td>Klasa:<br>IV</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia</td><td colspan="2">Rezultati i të nxënit të temës:<br>Paraqet shembuj të zgjerimit të ajrit, me zmadhimin e temperaturës dhe shpjegon qarkullimin e tij, si dhe motin e klimën.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 8; II.1, 2, 6, 7</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.4.5</td></tr>
<tr><th colspan="4">ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Njësia mësimore: Zonat klimatike</td></tr>
<tr><td colspan="4">Fjalët kyçe: zona klimatike, klimë e nxehtë, klimë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- organizon material për një temë të caktuar;<br>- klasifikon materialin/të dhënat;<br>- prezanton gjetjet.<br>Kriteret e suksesit:<br>- Organizon materialin për hulumtim për zonat klimatike.<br>- Klasifikon materialin për zona klimatike.<br>- Prezanton gjetjet nga hulumtimi i bërë për zonat klimatike.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:<br>Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm</td></tr>
<tr><th colspan="4">PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE</th></tr>
<tr><td colspan="4">Hapi I<br>Mësuesi/ja i ka udhëzuar nxënësit prej orës së kaluar që të hulumtojnë për zonat klimatike.<br>Nxënësit i ka ndarë në grupe ku secili grup do të hulumtojë për një zonë të caktuar.<br><br>Hapi II<br>Nxënësit hapin librat dhe lexojnë tekstin në f. 120.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| Pastaj punojnë në grupe me materialet e grumbulluara më herët.<br>Secili grup ka një fletë hameri ku do të vendosin materialet e grumbulluara dhe do të shkruajnë për një zonë të caktuar. (30 min.)<br>- **Zonë me klimë të ftohtë -** *rrethi polar jugor*<br>- **Zonë me klimë mesatare -** *tropiku i jugut*<br>- **Zonë me klimë të nxehtë -** *ekuatori*<br>- **Zonë me klimë mesatare -** *tropiku i veriut*<br>- **Zonë me klimë të ftohtë** - *rrethi polar i veriu*<br><br>**Hapi III**<br>Mësuesi/ja vëzhgon punë e nxënësve gjatë orës mësimore, iu ndihmon dhe jep sugjerime aty ku ka nevojë.<br>Prezantimet vazhdojnë edhe në orën e ardhshme që është orë përsëritje. |
| **VLERËSIMI I NXËNËSVE** |
| Vlerësohen nxënësit që bëjnë prezantime dhe që bëjnë pyetje-përgjigje me njëri-tjetrin. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Veprimtarinë 4.12 dhe Pyetje dhe detyra, f.121, detyrë shtëpie |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit dhe identifikon disa nga faktorët që ndikojnë në ndotjen e tokës apo keq menaxhimin e saj: p.sh., shfrytëzimi i tokave-ndërtimet në tokat bujqësore, përdorimi i pesticideve, shpyllëzimet, erozioni etj.). | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.4, 5; II.1, 6; III.4 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6; 2.2 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Njeriu dhe mjedisi natyror | | | |
| **Fjalët kyçe:** shtëpia jonë e përbashkët, mjedise natyrore, prerja e pyjeve | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- shpjegon relacionet njeri-natyrë;<br>- identifikon disa faktor që ndikojnë në ndotjen e tokës;<br>- interpreton rol në paraqitjen skenike.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Shpjegon dy relacione mes njeriut dhe natyrës (të mirat e njeriut për natyrën dhe anasjelltas).<br>- Identifikon së paku katër faktor që ndikojnë në ndotjen e tokës.<br>- Interpreton së paku një rol në paraqitjen skenike "Toka e hidhëruar me njeriun". | | | |

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë të ndryshme me ngjyra me pamje të natyrës, njeriu, lumit, koshit të plehrave, luleve, lisave, fabrikës, makinave.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**
Gjuhë shqipe, Arsim për zhvillim të qëndrueshëm.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

**Hapi I**
Mësuesi/ja shkruan në tabelë:




Pyet nxënësit: *Çfarë dini për njeriun? Çfarë dini për natyrën? Si bashkëveprojnë këta mes tyre*?

**Hapi II**
Lexojnë tekstin në faqen 122.
Mësuesi/ja ka përgatitur fotografi të ndryshme për nxënësit si foto të natyrës, njeriut, mbeturinave, kosh të plehrave, lumit, lisave, fabrikave, makina, luleve etj. Ndahen nxënësit në grupe. Secili nxënës duhet të ketë një foto të varur në trup. Mësuesi/ja i udhëzon të shkruajnë vet një skenar, të ndajnë rolet dhe të paraqesin para nxënësve një pjesë skenike me tematikë: "TOKA E HIDHËRUAR ME NJERIUN". Nxënësit lihen të lirë të mendojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për paraqitjen, ndarjen e roleve dhe prezantimin e pjesës.

**Hapi III**
Prezantojnë pjesën skenike, me radhë secili grup. Vlerësimin dhe vetëvlerësimin e bëjnë vet nxënësit me poena. Ai grup që fiton poena më shumë, shpallet grupi më i mirë.

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Vlerësohen për paraqitjen skenike më të mirë

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Veprimtaria 4.13

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha kurrikulare:**<br>**Shkencat e natyrës** | **Lënda:**<br>**Njeriu dhe natyra** | **Shkalla e kurrikulës:**<br>**II** | **Klasa:**<br>**IV** |
| **Tema: Toka, mjedisi dhe gjithësia** | | **Rezultati i të nxënit të temës:**<br>Dallon disa nga llojet e ndotjes së mjedisit dhe identifikon disa nga faktorët që ndikojnë në ndotjen e tokës apo keq menaxhimin e saj: p.sh., shfrytëzimi i tokave-ndërtimet në tokat bujqësore, përdorimi i pesticideve, shpyllëzimet, erozioni etj.). | |
| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2; II.2, 6 | | | |
| **Rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.6 | | | |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE** | | | |
| **Njësia mësimore:** Ndotja e tokës | | | |
| **Fjalët kyçe:** krijimi i dheut, pjellori | | | |
| **Rezultati/et e të nxënit të orës mësimore**<br>**Nxënësi/ja:**<br>- diskuton për njohuritë paraprake;<br>- shkruan ese për Tokën.<br>**Kriteret e suksesit:**<br>- Diskuton për njohuritë për tokën.<br>- Shkruan një ese për Tokën. | | | |
| **Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** | | | |
| **Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**<br>Gjuhë shqipe/Arsim për zhvillim të qëndrueshëm. | | | |
| **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE** | | | |

**Hapi I**

Bëjnë përsëritje nga ora e kaluar, sepse lidhen njësitë mësimore njëra me tjetrën.

**Hapi II**

Mësuesi/ja i udhëzon të hapin librat në f. 124 dhe të lexojnë njësinë mësimore.

Mandej iu shpërndanë të gjithëve nga një fletë A4, ku i udhëzon të shkruajnë një ese për tokën. Titullin do t'ia vendosin vetë sipas dëshirës. Do të kenë kohë 20 minuta.

**Hapi III**

Lexojnë esetë me radhë. Prej tyre nxjerrin konkluzione dhe i shkruajmë në tabelë. Në fund bashkë me mësuesin/en shkruajnë një pesëvargësh për tokën, duke zgjedhur fjalët më të mira.

Toka

________________ ________________ (dy mbiemra)

________________ ________________ ________________ (tri folje)

____________________________________________________ (një fjali)

________________ (sinonim)

Veprimtaria 4.14 punohet orën e ardhshme.

| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
|---|
| Nxënësit do të vlerësohen ne esenë e shkruar. |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| Fletorja e punës, f. 42 |
| **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore** |
| |

# Test përmbledhës për periudhën e parë

***Shënim:*** *Testi përmbledhës përfshin njohuritë nga njësitë e mësuara gjatë periudhës së parë (shtator- tetor-nëntor-dhjetor) të vitit shkollor.*

**1. Qarko elementet e botës së gjallë.** **(1 pikë)**

a) uji b) dheu
c) njeriu d) kafshët
e) bimët f) shkëmbinjtë

**2. Klasifiko në burime të ripërtëritshme dhe burime të paripërtëritshme këto elemente:**
energjia e diellit, nafta, mineralet, energjia e erës, **thëngjilli,** energjia e ujit. **(1 pikë)**

| Burime të ripërtëritshme | Burime të paripërtëritshme |
|---|---|
| - | - |
| - | - |
| - | - |
| | - |

**3. Plotëso tabelën.** **(3 pikë)**

| Objekti | Materiali | Vetitë |
|---|---|---|
| | letra | |
| | plastika | |
| | qelqi | |
| | druri | |

**4. Lidh me shigjetë.** **(1 pikë)**

Kafeja
Lëngu i portokallit — Lëndë e pastër
Supa
Shkumësi — Lëndë e përzier
Tabela

**5. Shkruaj metodat për ndarjen e lëndëve që nuk treten në lëngje.** **(2 pikë)**

_______________ _______________ _______________

**6. Kur lënda e lëngët ndahet nga lënda e ngurtë që nuk mund të shkrihet në ujë, kemi:**

a) filtrim. **(1 pikë)**
b) avullim;
c) sitje.

**7. Shkruaj emrat e dy përzierjeve të qëndrueshme dhe dy të paqëndrueshme:** **(2 pikë)**

- Përzierje të qëndrueshme: _______________
- Përzierje të paqëndrueshme: _______________

**8. Cilët janë disa nga përbërësit e ajrit? (1 pikë)**

_______________ _______________ _______________

**9. Ajri ndotet më shumë nga: (1 pikë)**

a) ujërat e zeza; b) tymi i fabrikave; c) plehrat kimike; d) tymi i makinave.

**10. Argumento rëndësinë e ajrit të pastër për jetën e njeriut. (3 pikë)**

_______________________________________________

_______________________________________________

**11. Shkruaj pjesët e lules. (2 pikë)**



**12. Cilat janë mënyrat e përhapjes së grimcave të pjalmit? (3 pikë)**

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

**13. Kur në një lule, kokrrizat e pjalmit bashkohen me pistilin, ndodh procesi: (1 pikë)**

a) i pjalmimit; b) i vetëpjalmimit; c) i riprodhimit vegjetativ.

**14. Shkruaj emrat e disa bimëve sipas mënyrës së tyre të riprodhimit. (3 pikë)**

| Mënyra e riprodhimit të bimës | Emri i bimës |
|---|---|
| Riprodhimi me kërcej mbitokësorë dhe nëntokësorë | |
| Riprodhimi me rrënjë, gjethe ose degë | |
| Shartimi | |

**15. Përshkruaj ciklin jetësor të bletës. (3 pikë)**



_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

_______________________________________________

**16. Ku ndryshon pllenimi i vezës së pulës nga ai i bretkosës? (2 pikë)**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**17. Kur brenda trupit të nënës, një vezë femërore bashkohet me qeliza mashkullore, kemi të bëjmë me pllenim të: (1 pikë)**

a) bimëve; b) gjitarëve; c) insekteve.

**18. Argumento pse është i rëndësishëm riprodhimi i gjallesave. (3 pikë)**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**19. Shkruaj në grupin përkatës emrat e këtyre ushqimeve: buka, vez*ë*t, patate, mishi, arrat, sheqeri, vaji, qumështi, djathi. (2 pikë)**

*Karbohidrate* *Yndyrat* *Proteina*

**20. Shkruaj disa mënyra për ruajtjen e ushqimit. (2 pikë)**

______________ ______________ ______________

______________ ______________

**21. E vërtetë (V) apo e gabuar (G)? (1 pikë)**

- Alkooli dhe duhani janë substanca që e dëmtojnë organizmin e njeriut. V G
- Kafeina nuk bën pjesë në grupin e substancave të dëmshme. V G
- Duhani dhe alkooli janë substanca që shkaktojnë varësi. V G
- Duhani dhe alkooli kanë veti shëruese. V G

**22. Rendit nga 1 deri në 5, sipas radhës, fazat e zhvillimit të njeriut. (1 pikë)**

☐ fëmijëri ☐ bebe (foshnjë) ☐ i rritur ☐ mosha e pleqërisë ☐ adoleshencë

| Kriteri | **0-16** | **16-23** | **24-31** | **32-35** | **36-40** |
|---|---|---|---|---|---|
| Pikët e arritura | | | | | |
| Vlerësimi/Nota | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

# Test përmbledhës për periudhën e dytë

**Shënim:** *Testi përmbledhës përfshin njohuritë nga njësitë e mësuara gjatë periudhës së dytë (janar-shkurt-mars) të vitit shkollor.*

**1. Shkruaj dy emra për secilin nga llojet e trupave. (3 pikë)**

| Trup në gjendje të lëngët | Trup në gjendje të gaztë | Trup në gjendje të ngurtë |
|---|---|---|
| | | |
| | | |

**2. Lëvizja që bëjnë akrepat e orës është lëvizje: (1 pikë)**

a) drejtvizore; b) e lakuar; c) pingul me Tokën.

**3. E vërtetë (V) apo e gabuar (G)? (2 pikë)**

- Valët përhapen vetëm në ujë dhe ajër. V G
- Valët që përhapen në ujë, quhen valë zanore. V G
- Valët që përhapen në ujë, janë valë ujore. V G
- Zëri i përsëritur, që duket sikur kthehet mbrapsht, quhet jehonë. V G

**4. Djegia e qiririt është një shndërrim i ________________, ndërsa shkrirja e metaleve është një shndërrim i _____________________. (2 pikë)**

**5. Shpjegoni si arrijnë anijet të lundrojnë në oqean. (4 pikë)**

_______________________________________________________________

_______________________________________________________________

_______________________________________________________________

**6. Qarko alternativat e sakta për shtypjen atmosferike. (2 pikë)**

a) *shtypja atmosferike ndodh:*
- në drejtimin veri-jug;
- në drejtimin lindje-perëndim;
- në të gjitha drejtimet.

b) *shtypja atmosferike është:*
- pesha e masës së ajrit;
- temperatura e ajrit;
- lagështia e ajrit.

**7. Energjia që përftohet nga burimet ujore (uji i rrjedhshëm) quhet: __________________. (1 pikë)**

**8. Lidh me shigjetë secilën dukuri me emërtimin përkatës. (3 pikë)**

| | |
|---|---|
| Shndërrimi i lëngut në gjendje të gaztë. | LËNGËZIMI |
| Nxehja e madhe e ujit, që shfaqet në formën e flluskave të mëdha. | AVULLIMI |
| Shndërrimi nga gjendja e gaztë (avujt e ujit) në gjendje të lëngët. | VLIMI |

**9. Shkruaj shpjegimin për secilën fjalë.** **(4 pikë)**

*Vetëtimë* - ____________________________________________

*Bubullimë* - ____________________________________________

*Rrufe* - ____________________________________________

*Rrufepritës* - ____________________________________________

**10. Vizato një qark të thjeshtë elektrik dhe emërto pjesët e tij.** **(3 pikë)**

**11. Shkruaj tre:** **(2 pikë)**

- Trupa përçues të elektricitetit ______________,______________,______________.
- Trupa jopërçues (veçues) të elektricitetit ___________,____________,__________.

**12. Shkruaj dy këshilla si mund të mbrohemi nga rreziku i energjisë elektrike.** **(2 pikë)**

________________________________________________________________________

____________________________________________________________

**13. Plotëso tabelën.** **(2 pikë)**

| Lëndë magnetike | Lëndë jomagnetike |
|---|---|
| | |
| | |

**14. Plotëso** **(1 pikë)**

Polet e njëjta të dy magneteve------------------------- njëri-tjetrin.

Polet e kundërta të dy magneteve---------------------njëri-tjetrin.

**15. Vizato një busull dhe përshkruaje atë.** **(3 pikë)**

Busulla është

________________________________

________________________________

________________________________

________________________________

________________________________

________________________________

________________________________

________________________________

________________________________

**16. Ku përdoren elektromagnetet në jetën e përditshme?** **(3 pikë)**

________________________________

________________________________

**17. Elektroskopi është një mjet që përdoret:** **(1 pikë)**

a) për t'u orientuar në natyrë;
b) të dalluar ngarkesën elektrike të trupave;
c) për të shuar elektricitetin e trupave.

**18. Si janë fletët e elektroskopit, kur i afrojmë një trup me ngarkesë të njëjtë?** **(1 pikë)**

a) Të ndara nga njëra-tjetra.
b) Të bashkuara.

| Kriteri | **0-16** | **16-23** | **24-31** | **32-35** | **36-40** |
|---|---|---|---|---|---|
| Pikët e arritura | | | | | |
| Vlerësimi/Nota | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

# Test përmbledhës për periudhën e tretë

**Shënim:** *Testi përmbledhës përfshin njohuritë nga njësitë e mësuara gjatë periudhës së tretë (prill-maj-qershor) të vitit shkollor.*

**1. Plotëso pohimet e mëposhtme.** **(3 pikë)**

a) Shkenca që merret me studimin e yjeve quhet ________________.

b) Mjeti që përdoret për të vrojtuar dhe studiuar yjet quhet ______________________.

c) Grupet e yjeve që formojnë figura të dukshme në kupën qiellore, quhen ___________.

**2.** Planetët e sistemit tonë diellor, sipas largësisë së tyre nga Dielli, janë _________ _________ _______ _________ __________ ________ _________ ________ __________. **(2 pikë)**

**3. Cili është ai trup qiellor, që kur i afrohet Diellit, formon një bisht të shndritshëm?**

a) Asteroidi. b) Meteori. c) Kometa. **(1 pikë)**

**4. Argumento si do të ishte jeta në Tokë, pa diellin si burim të dritës.** **(4 pikë)**

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

______________________________________________________________________

**5. Shkruaj tri shtresat e Tokës.** **(1 pikë)**



**6. Gjatë rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet formohet:** **(1 pikë)**

a) dita dhe nata; b) stinët e vitit; c) eklipsi i Hënës.

**7. Gjatë rrotullimit të Tokës rreth Diellit formohet:** **(1 pikë)**

a) dita dhe nata; b) stinët e vitit; c) eklipsi i Hënës.

**8. Shkruaj 4 karakteristika për Hënën si satelit.** **(4 pikë)**

______________________________________________

______________________________________________

________________________________

**9. E vërtetë (V) apo e gabuar (G)?** **(1 pikë)**

- Boshti i Tokës është një bosht imagjinar, që lidh Polin e Veriut me atë të Jugut. **V G**
- Në 21 mars dhe 23 shtator, dita me natën janë të barabarta në të gjithë globin. Kjo dukuri quhet solstic**.** **V G**
- Në Hemisferën Veriore, 21 qershori shënon ditën më të gjatë të vitit. Në Hemisferën Jugore, 21 dhjetori shënon natën më të gjatë. Këto dy data quhen ekuinoks. **V G**

**10. Përshkruani disa mënyra orientimi në natyrë.** **(2 pikë)**

______________________________________________

______________________________________________

**11. Shkruaj përkufizimin për secilin koncept.** **(4 pikë)**

| | |
|---|---|
| *Harta* | |
| *Globi* | |
| *Meridiane* | |
| *Paralele* | |

**12. Cilat janë disa nga format e relievit të Tokës?** **(1 pikë)**

______________ ______________ ______________

**13. Plotëso diagramin e Venit.** **(2 pikë)**

kodra të përbashkëtat fusha



**14. Rendit me numra 1-5, sipas radhës, shtresat e atmosferës.** **(1 pikë)**

☐ Ekzosfera
☐ Mezosfera
☐ Troposfera
☐ Stratosfera
☐ Jonosfera

**15. Ku ndryshon klima nga moti? Renditni tiparet dalluese.** **(3 pikë)**

______________________________________________

______________________________________________

**16. Shkruaj nga një karakteristikë për klimën:** **(3 pikë)**

- e ftohtë ______________________________
- e butë______________________________
- e nxehtë______________________________

**17. Paraqit nëpërmjet një skeme qarkullimin e ujit në natyrë.** **(3 pikë)**

**18. Argumento si ndikon mjedisi në jetën e njeriut.** **(3 pikë)**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

| Kriteri | **0-16** | **16-23** | **24-31** | **32-35** | **36-40** |
|---|---|---|---|---|---|
| Pikët e arritura | | | | | |
| Vlerësimi/Nota | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

# REFERENCA

- Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (klasat 0, I, II, III, IV dhe V), e rishikuar, gusht 2016

- Kurrikulat lëndore/programet mësimore, klasa e katërt, 2020.

- Teknikat e mësimdhënies, edukimi.webs.com.

- Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies.